

BAROMETRI KOMBËTAR



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

2022
BAROMETRI
KOMBËTAR

**NDIKIMI I
PANDEMISË COVID-19
NË TË DREJTAT
DHE LIRITË THEMELORE
TË NJERIUT NË VENDIN TONË**

Metodologjia dhe analiza e të dhënave të sondazhit:

Znj. Eralda Gjika, Eksperte statisticiene

Analiza e kuadrit ligjor dhe Monitorimi i Institucioneve:

Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive

Znj. Servete Çeka, Koordinatorë Projekti, KShH

Përgatitja e raportit:

Znj. Servete Çeka,

Koordinatorë Projekti, KShH

Rishikoi:

Z. Njazi Jaho,

Këshilltar Ligjor, KShH

Publikuar nga:

Autor: © Komiteti Shqiptar i Helsinkit (Shtator, 2022). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Nëse jeni të interesuar për këtë raport, mund të kontaktoni Komitetin Shqiptar të Helsinkit në adresën e mëposhtme:

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati "Tekno Projekt" Shk 2 Ap 10,
Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752;

Tel: 04 2233671; Cel: 0694075732;

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

Ky raport u hartua në kuadër të projektit "Monitorimi i të drejtave dhe lirive themelore gjatë pandemisë globale Covid-19 dhe forcimi i shoqërisë civile në Shqipëri", zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit", mbështetur financiarisht nga the Balkan Trust for Democracy dhe USAID,

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e the Balkan Trust for Democracy, Fondit Marshall Gjerman të SHBA-së, USAID apo Qeverisë së SHBA-së.



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	3
Hyrje	4
KREU 1	26
ANALIZË E KUADRIT LIGJOR NË FUQI	26
KREU 2	35
REZULTATET E BAROMETRIT KOMBËTAR TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, GJATË PERIUdhës SË PANDEMISË COVID-19	36
2.1. Të dhëna të përgjithshme të anketimit	36
2.2. E drejta për informim	43
2.3. Liria e lëvizjes	48
2.4. Liria për tubim	53
2.5. E drejta për kujdes shëndetësor	57
2.6. Liritë ekonomiko-sociale	64
KREU 3	68
MONITORIMI TEMATIK I INSTITUCIONEVE TË NGARKUARA ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT ANTI-COVID	68
3.1. Monitorimi i Strukturave Vendore të Policisë së Shtetit	68
3.1.1 Drejtoritë Vendore të Policisë	68
3.1.2 Monitorimi i Komisariateve të Policisë	71
3.2 Monitorimi i Strukturave Vendore të Shëndetit Publik	79
KREU 4:	91
E DREJTA PËR ARSIM GJATË COVID-19	91
4.1. Të dhëna të anketimit	92

SHKURTIME

DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
ISHSH	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
KShH	Komiteti Shqiptar i Helsinkit
GJK	Gjykata Kushtetuese
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJVKSH	Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor
QSH	Qendrat Shëndetësore
SMSI	Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit
SISI	Sistem të Informacionit të Sëmundjeve Infektive

Hyrje

Pandemia Covid-19, e përballi botën me një situatë të jashtëzakonshme. Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) shpalli situatën e krijuar nga Covid-19 një gjendje pandemie globale¹. Në fjalimin e mbajtur nga Drejtori i Përgjithshëm i OBSH, ai i këshilloi shtetet që të ruajnë ekuilibrin midis mbrojtjes së shëndetit, pasojave ekonomike dhe sociale dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Më 22 prill 2020, Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale², reagoi me deklaratë ku theksoi rëndësinë e të drejtës për mbrojtjen e shëndetit dhe lidhjen e saj me të drejtat tjera të parashikuara në Kartën Sociale Evropiane, si e drejta për ndihmë sociale dhe mjekësore, e drejta për liri nga varfëria dhe përjashtimi social dhe e drejta për kushte të sigurt dhe të shëndetshme pune³.

Në Shqipëri, në përgjigje të rasteve të para të raportuara të COVID-19 gjatë muajit Mars 2020, Këshilli i Ministrave filloi të marrë masa për të mbajtur nën kontroll pandeminë. Data 10 mars 2020 shënon datën e akteve të para të cilat kanë parashikuar kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut⁴.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, në dt.24 Mars të vitit 2020, Këshilli i Ministrave shpalli në vendin tonë gjendjen e fatkeqësisë natyrore.⁵ Një muaj më vonë, kjo gjendje u zgjat me VKM nr.342, datë 25.4.2020, deri më dt. 23.6.2020, duke e bërë Shqipërinë një ndër shtetet ku gjendja e fatkeqësisë natyrore ka zgjatur më shumë në

¹ Fjala hapëse e Drejtorit të Përgjithshëm të OBSH-së në konferencën për media për COVID-19-11mars 2020, e aksesueshme në: <https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19-11-march-2020>

² Organi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të Kartës Sociale Evropiane

³ Komiteti Evropian i të Drejtave Sociale "Deklaratë interpretimi mbi të drejtën e mbrojtjes së shëndetit në kohë pandemike (miratuar nga Komiteti më 21 prill 2020", e aksesueshme në: <https://rm.coe.int/statement-of-interpretation-on-the-right-to-protection-of-health-in-ti/16809e3640>

⁴ Urdhër nr.156, datë 10.3.2020 Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/10/156/ef6f88e4-2dde-4c03-86d8-dca1d58275d5>
Urdhër nr.157, datë 10.3.2020 Për marrjen e masave për parandalimin e infektimit nga COVID-19 të përfituesve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/10/157/0e17faa0-b7c5-456a-9998-66d38761b460>
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.156/1, datë 10.3.2020 Për ndalimin e të gjitha lëvizjeve të udhëtarëve drejt Italisë, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/10/156-1/cce2e109-f947-4f77-9a61-bc16bfd6b8d>

⁵ Vendim nr. 243, datë 24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/24/243/dc183551-1297-44e2-b35c-ffb33ee669c7>

raport me shtetet e rajonit (referuar raportit të organizatës Suedeze, Civil Rights Defenders⁶).

Gjatë kësaj periudhe, shteti shqiptar vendosi të kufizojë një kategori të drejtash që synonin ruajtjen dhe sigurinë e shëndetit të shtetasve si liria e lëvizjes, e drejta për një jetë të qetë familjare, liria e organizimit kolektiv dhe tubimit, etj.

Me anë të notës verbale të Përfaqësisë së Përhershme të Shqipërisë drejtuar Këshillit të Evropës në dt.31 Mars 2020, Shqipëria i komunikoi Sekretarit të Përgjithshëm të KiE-së zbatimin e nenit 15 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për nevojën e derogimit (apo shmangies) nga disa detyrime që Republika e Shqipërisë ka marrë përsipër sipas neneve 8 (e drejta për jetë private dhe familjare) dhe 11 (liria e tubimit dhe organizimit) të KEDNJ-së, dhe dy prej protokolleve të saj, përfshi këtu nenin 2 të Protokollit nr.4 të KEDNJ-së që garanton lirinë e lëvizjes⁷.

Kufizimet e të drejtave dhe lirive të njeriut kanë qenë në raste të pakta objekt i gjyqimit kushtetues. Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, ka argumentuar se *“në kuadrin e masave të veçanta që merren për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive, me impakt të madh, kufizimi i së drejtës së tubimit, i lidhur me lirinë e shprehjes, në rastin konkret është i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 15/2016, në formën e anulimit të grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura. Urdhri nr. 633/2020 ka dalë për të bërë të zbatueshëm këtë dispozitë ligjore dhe, për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk ka shkelje të kriterit të kufizimit “me ligj”, sipas nenit 17 të Kushtetutës.”*⁸. Nëse hedhim vështrimin në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese në vendin fqinjë, përkatësisht në Republikën e Kosovës, vërejmë se kjo gjykatë⁹, pasi shqyrtoi kërkesën e Presidentit për verifikimin e masave shtrënguese të Qeverisë, të cilat u ndërmorën pa u shpallur më parë gjendja e jashtëzakonshme për shkak të fatkeqësisë natyrore, konkludoi se ato janë në përputhje me parashikimet e ligjeve specifike në fuqi. Megjithatë, kjo Gjykatë vërejtë se *kundërvajtjet administrative të përcaktuara përmes këtyre tri Vendimeve të kontestuara, nuk janë “të përcaktuara në ligj” dhe për pasojë, u shpallën*

⁶ Civil Rights Defenders *“Të drejtat e njeriut në kohë pandemie”*, fq 10, e aksesueshme në: https://crd.org/ëp-content/uploads/2021/01/210122_Internet-Freedom-CRDK2_ALB.pdf

⁷ Deklarata në lidhje me Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1 prill 2020, e aksesueshme në: <https://rm.coe.int/09000016809e0fe5>

⁸ Vendim nr.11 datë 09.03.2021 i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 50.

⁹ Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës nr. Akt 61/20, i aksesueshëm në <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-nr-214-iv-2020-te-12-prillit-2020-te-ministrise-se-shendetesise-per-shpalljen-e-komunes-se-prizrenit-zone-karantine-dhe-vendimeve-nr-2/>

jo kushtetuese". Në vlerësimin e saj kushtetues, kjo Gjykatë u ndal gjithashtu në testin e proporcionalitetit.

Në përputhje me misionin e tij, për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) ndërtoi dhe zbatoi "Barometrin Kombëtar" mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në vendin tonë.

Barometri përpunon dhe analizon nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, të dhënat e përftuara nga një sondazh i realizuar me qytetarë dhe studentë, sa i takon perceptimit të tyre për masat anti-covid dhe kufizimet e disa prej të drejtave e lirive themelore të njeriut, përgjatë periudhës së pandemisë. Ndër këto të drejta mund të përmendim të drejtën për informim, lirinë e lëvizjes, të drejtën për tubim, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtat në sferën ekonomike, si dhe të drejtën për arsim për periudhën Mars 2020-Dhjetor 2021. Të dhënat janë mbledhur nëpërmjet pyetësorëve online dhe fizikë, duke garantuar anonimin e të anketuarve që kanë shfaqur interes për Barometrin.

1. Pasojat e pandemisë në humbjet e jetëve

Nga data 9 Mars 2020, kur raportohen infektimet e para në Shqipëri dhe deri më 11 Korrik 2022, raportohen në total, 286,732 persona të infektuar me Covid 19 (ose 10.2% e totalit të popullsisë) dhe 3512 vdekje¹⁰. Referuar po të dhënave të WorldMeter, Shqipëria renditet me numrin më të ulët të infektimeve dhe shkallës së vdekshmërisë për 1 milion Banorë, krahasuar me vende të rajonit si Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi¹¹.

Sektori i kujdesit shëndetësor është një nga më të shumtët që u godit rëndë nga pandemia, ndërkohë që të punësuarit në këtë sektor u përballen me rreze të shumta që prekën mirëqenien e tyre fizike, mendore dhe sociale¹². Më 16 maj 2021, numri i vdekjeve në shkallë globale të punonjësve të kujdesit shëndetësor për shkak të COVID-19, të raportuara në OBSH ishte vetëm 6643. Kjo shifër nuk përputhet me ato të përfthuara nga burimet e tjera të të dhënave, duke përfshirë dorëshkrimet e rishikuara nga kolegët, raportet nga organet qeveritare dhe shoqatat profesionale të kujdesit shëndetësor, si dhe mbulimi mediatik brenda dhe përtej shteteve¹³.

Në funksion të mbikëqyrjes së të dhënave, Sekretariati i OBSH-së u kërkoi shteteve të fokusohen në kategorizimin e të dhënave për infektimet dhe vdekshmërinë në radhët e punonjësve të kujdesit shëndetësor. Në muajt më të hershëm të pandemisë (Mars - Maj 2020), raportet nga Shtetet Anëtare treguan se këta punonjës u përballën me një normë të trefishtë rreziku ndaj infektimit, në krahasim me atë të popullatës së përgjithshme. Megjithatë, u shfaqën boshllëqe të konsiderueshme në raportimin e vdekjeve.

Duke ju referuar mangësive të referuara nga strukturat vendore të shërbimit shëndetësor publik përgjatë pandemisë, por edhe situatës globale në vend, është e domosdoshme që autoritetet shqiptare të

¹⁰ <https://www.worldometers.info/coronavirus/country/albania/>

¹¹ Shqipëria - 1,223 shtetas të vdekur për 1 milion banorë; Serbia – 1864 shtetas të vdekur për 1 milion banorë (ndërkohë që renditet e dyta për numrin më të lartë të të infektuarve); Mali i Zi – 4344 shtetas të vdekur për 1 milion banorë (ndërkohë që renditet i pari për numrin më të lartë të të infektuarve); Maqedonia e Veriut – 4479 shtetas të vdekur për 1 milion banorë Bosnja dhe Hercegovina – 4880 shtetas të vdekur për 1 milion banorë, ndërkohë që renditet e dyta për numrin më të ulët të infektimeve pas Shqipërisë, por ka numrin më të lartë të vdekshmërisë.

¹² The impact of COVID-19 on health and care workers: a closer look at deaths, Working paper 1 from World Health Organization, Health Workforce Department, September 2021

¹³ Po aty, fq.4

vlerësojnë me objektivitet dhe kujdesin e duhur profesional, vështirësitë e ndeshura gjatë situatës së pandemisë, ku një numër i madh mjekësh apo infermierësh humbën jetën për shkak të infektimit apo komplikacioneve nga koronavirusi. Vlen të hulumtohet më tej nga strukturat kompetente të shëndetësisë, për efikasitetin e masave parandaluese për mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të personelit shëndetësor.

2. Matja e perceptimit qytetar për të drejtat dhe liritë e tyre gjatë pandemisë

Matja e perceptimit është realizuar me anë të një sondazhi, i shpërndarë në rrugë elektronike në formatin *google form* me anë të faqes së internetit dhe në rrjeteve sociale e profesionale të komunikimit të KShH. Gjithashtu, një pjesë e tij është plotësuar fizikisht nga anketuesit e KShH-së, në 7 qytete të mëdha, përkatësisht në qytetin e Korçës, Shkodrës, Elbasanit, Tiranës, Durrësit, Fierit dhe Kukësit. Në total pyetësori arriti të sigurojë një përfaqësim kampionimi prej afro 900 qytetarësh, prej të cilëve, 488 qytetarë e kanë plotësuar në formatin elektronik, dhe 403 e kanë plotësuar pas kontaktit ballë për ballë, nga anketuesit e KShH-së. Ndërsa pyetësori i studentëve arriti të sigurojë një përfaqësim prej 444 individësh në rang vendi, të cilët e kanë plotësuar pyetësorin vetëm në format fizik.

Përgjigjet e të anketuarve, reflektojnë në mënyrë të përmbledhur këtë panoramë:

2.1 E drejta për informim

- 43% e të anketuarve janë përgjigjur se mendojnë se shteti ka ofruar pjesërisht, në mënyrë pro aktive dhe të vazhdueshme, informacion të besueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm në lidhje me krizën shëndetësore, ndërkohë që 11% e tyre mendojnë që informacioni i ofruar nga ana e shtetit nuk i përmbush këto kriterë.
- 34 % e të anketuarve kanë patur informacion të pjesshëm mbi ndryshimet ligjore, aktet dhe urdhërat të cilat kanë qene subjekt i ndryshimeve në mënyrë periodike, ndërkohë që 8% e tyre nuk kanë qenë të informuar mbi to.
- 34.34 % e të anketuarve mendojnë se janë keq informuar nga institucionet kompetente lidhur me gjendjen e shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe mënyrën e menaxhimit të kësaj shtate nga Qeveria, dhe 43.88% e tyre mendojnë se janë keq informuar nga burime të tjera, ndër të cilat përqindjen më të madhe e zënë rrjetet sociale.

2.2 Liria e lëvizjes

- 22.4% e të anketuarve mendojnë se ndalimi i zhvillimit të aktiviteteve publike ose jopublike si dhe ndalimi i grumbullimeve ka qenë i panevojshëm dhe plotësisht i panevojshëm.
- 35% e të anketuarve mendojnë se kufizimi i lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale¹⁴, ka qenë i panevojshëm dhe plotësisht i panevojshëm.
- Në 30% të rasteve në lidhje me masat për mbylljen e shkollave dhe zhvillimi i mësimi online kanë pohuar se masat kanë qenë "të panevojshme dhe plotësisht të panevojshme".
- Mbi kufizimet e lëvizjeve brenda vendit, 33.8% pranojnë se masat kanë qenë të nevojshme dhe 21.4% pohojnë se masat kanë qenë të panevojshme.
- Mbi mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve ajrore/tokësore midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera të anketuarit kanë pohuar në 33.8% të rasteve "Kufizimi i lëvizjeve brenda vendit, ka qenë i nevojshëm" dhe 29.4% "Plotësisht i nevojshëm".

2.3 Liria e tubimit

- 89% e të anketuarve pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së Covid-19.
- 31% e tyre mendojnë se anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura¹⁵, përpara shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore më 24.3.2020, përbën kufizim jo proporcional të kësaj të drejte,

2.4 E drejta për kujdes shëndetësor

- 51% e të anketuarve i janë drejtuar Institucioneve Shëndetësore Publike¹⁶ gjatë periudhës së COVID-19, ndërkohë që 18 % i janë drejtuar Spitaleve private. 31% e të anketuarve nuk i janë drejtuar asnjë institucioni shëndetësor.
- 82% e të anketuarve mendojnë se shërbimet shëndetësore nuk kanë qenë të përballueshme për të gjithë, pa diskriminim, duke përfshirë grupet e marginalizuara. 30.06% e të anketuarve pohojnë se janë mjekuar në shtëpi. Për t'u theksuar është se të gjithë personat e pyetur, të cilët i përkasin grup moshës mbi 65 vjeç, kanë

¹⁴ Nëpërmjet Urdhërit nr. 133, datë 8.3.2020 "Për kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve nëpër spitale"

¹⁵ Nëpërmjet Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020

¹⁶ Mjekut të familjes, qendrave shëndetësore, ambulancës, spitaleve

pohuar se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme, duke patur parasysh nivelin ekonomik të të ardhurave.

- Lidhur me vaksinimin, 59% e të anketuarve kanë konfirmuar se i janë nënshtruar procesit të vaksinimit ku 38% e tyre kanë pasur mundësi të zgjedhjes së vaksinës, ndërsa 21% nuk e kanë patur këtë mundësi.
- 41% e të anketuarve pohojnë se nuk janë vaksinuar, prej të cilëve, 22% janë përgjigjur se arsyeja është mungesa e besimit të vaksinat dhe 11% prej mungesës së transparencës dhe informimit lidhur me vaksinat.
- Në lidhje me vaksinimin e detyrueshëm, 74% e të të pyeturve pohojnë se nuk është i drejtë dhe 26% që është i drejtë.

2.5 Liritë ekonomiko-sociale

- 61% e të anketuarve u shprehën se kufizimet e vendosura gjatë pandemisë (mbyllja e përkohshme e aktiviteteve, kufizimi i lëvizjeve, etj) kanë ndikuar në mirëqenien e tyre ekonomike. Ky perceptim qëndron në raporte të barabarta në zonat rurale dhe urbane, ndërsa për qytete si Dibra, Fieri, Lezha, Shkodra e Vlora, perceptimet e këtij pohimi janë në nivele më të larta.
- Mbyllja e aktiviteteve dhe realizimi i punës online ka ndikuar në efektivitetin e individëve të anketuar, të cilët në 64% të rasteve kanë pohuar këtë gjë, ndërkohë që 14% e të anketuarve pohojnë se nuk janë prekur dhe 22% janë përgjigjur “nuk e di”.
- Të anketuarit pranojnë se janë detyruar nga punëdhënësi të paraqiten në punë në 16.3% të rasteve.
- Gjatë periudhës së karantinës 41.1% e të anketuarve pohojnë se pagesa e tyre ka qenë e njëjtë, 40.7% nuk kanë qenë të punësuar gjatë periudhës në shqyrtim, 9.4% kanë pohuar se paga e tyre është reduktuar dhe përafërsisht 4.8% kanë hasur vonesa në pagesat nga punëdhënësi.

2.6 Cilësia e arsimit të lartë dhe të drejtat studentore gjatë Covid 19

- Të pyetur mbi produktivitetin e mësimdhënies online, 55.9% e studentëve janë përgjigjur se mësimi ka qenë produktiv dhe në një shkallë vlerësimi nga 3 në 5. Pjesa që vlerëson mësimdhënien online gjatë muajve të pandemisë në nivele jo të mira (1,2) është përafërsisht 44.1%.
- Të pyetur nëse kanë hasur vështirësi gjatë kohës së mësimdhënies online, 52.88% e të pyeturve pranojnë të kenë patur vështirësi, 38.5% pranojnë të kenë patur vështirësi duke pohuar “disi” dhe pjesa tjetër 8.63% kanë pohuar se nuk kanë patur vështirësi.

- Vështirësitë në studim lidhur me procesin e mësimit online duket se kanë një shpërndarje të ndryshme në universitete të ndryshme. Vihet re se në Universitetin Bujqësor të Tiranës kjo pjesë përbën 78.26% të të anketuarve, më tej qëndron Universiteti i Arteve me 73.33%, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës me 62.5%, Universiteti i Mjekësisë Tiranë me 60%, Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër (53.85%), Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (53.33%). Universitetet private (31.43%), etj.
- 77.42% e studentëve kanë pohuar marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021. Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka përqindjen më të lartë të studentëve (39.13% e të pyeturve) të cilët kanë pohuar se nuk janë marrë masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor.
- Të pyetur në lidhje me marrjen pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin e tyre për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 -2021, 70.5% e studentëve janë përgjigjur që nuk kanë marrë pjesë dhe 19.4% që kanë marrë. Të pyetur nëse kanë patur kufizime për të realizuar apo marrë pjesë në këto protesta, 58.49 % e studentëve janë përgjigjur që nuk kanë patur kufizime dhe 19.51% që po kanë patur kufizime.

3. Monitorimi i strukturave të policisë dhe shëndetit publik në nivel vendor

3.1 Strukturat e policisë në Drejtoritë Vendore të Korçës, Elbasanit dhe Durrësit

Komisariatet e Policisë objekt monitorimi në këto tri Drejtori, kanë referuar vështirësitë kryesore me të cilat ato janë përballur gjatë pandemisë, si dhënia e detyrave shtesë për punonjësit e Komisariateve, të cilat diktuar nevojën për punë me orare të zgjatura dhe rritje të ngarkesës në punë. Komisarariatet referojnë se nuk ka patur rritje të pagave apo shpërblime për punonjësit e policisë për përballimin e situatës së krijuar¹⁷.

Sa i përket masave të marra nga punonjësit e policisë së shtetit për qytetarët të cilët kanë ushtruar të drejtën e tubimit gjatë kohës së pandemisë, vihet re se praktika e ndjekur nga ana e Drejtorive Vendore të Policisë objekt monitorimi (Korçë, Elbasan dhe Durrës) nuk ka qenë e

¹⁷ Komisariati i Policisë Durrës dhe Elbasan referojnë se sa i takon orëve shtesë, ato janë shpërblyer, por megjithatë nuk është bërë e mundur dhënia e pushimeve vjetore të miratuara më parë për shkak të ngarkesës në punë.

unifikuar. Në disa raste janë marrë masa administrative, ndërkohë që ka patur Komisariate që kanë ndjekur një linjë më të ashpër, duke kallëzuar protestuesit në prokurori. Komisariati i Policisë Durrës referon se gjatë periudhës për të cilën është kërkuar informacion, nuk është dhënë leje për realizimin e tubimeve apo grumbullimeve, dhe në rastet kur janë evidentuar grumbullime masive, nga ana e këtij institucioni janë referuar materiale në Prokurorinë kompetente. Një qasje e ngjashme reflektohet edhe nga ana e Komisarariatit të Policisë Korçë, i cili referon se në rastet e tubimeve të kryera në kundërshtim me parashikimet ligjore, ka ndërmarrë veprimet procedurale për veprat penale të parashikuara nga nenet 262, 150, 151 dhe 237 të Kodit Penal.

Lidhur me zbatimin e nenit 262 të Kodit Penal "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme", vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 24, datë 04.55.2021, pranoi kërkesën për gjykim incidental lidhur me antikushtetutshmërinë e normës, të vënë në lëvizje nga Gjykata e Apelit Shkodër. Kjo Gjykatë, vendosi shfuqizimin e shprehjes "pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta" në paragrafin e parë të nenit 262 të Kodit Penal, si dhe, detyrimin e Kuvendit të plotësojë normën ligjore nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të tij. Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton të jetë plotësuar detyra e lënë për organin legjislativ, për plotësimin normative të këtij neni të Kodit Penal.

Asnjë nga Komisarariatet nga të cilat është kërkuar informacioni nuk ka ofruar të dhëna nëse vlerësojnë se mjetet e përdorura kanë shërbyer për informim të mjaftueshëm të qytetarëve si dhe nëse mënyra e shpërndarjes së informacionit ka qenë efektive dhe e aksesueshme nga të gjithë qytetarët.

Nga komunikimi zyrtar me Komisarariatet vërehet se nuk ka një praktikë të unifikuar për dokumentimin dhe regjistrimin e shkeljeve të lidhura me pandeminë dhe masave të dhëna nga këto organe gjatë periudhës Mars 2020 – Dhjetor 2021. Komisariati i Policisë Durrës dhe ai Pogradec, referojnë se ka një regjistër të veçantë ku regjistrohen këto shkelje, ndërkohë që Komisariati i Policisë Korçë referon që nuk ka një të tillë. Në disa raste, KShH ka vërejtur parregullsi në procedurën e dokumentimit dhe njoftimit të shkeljeve dhe masave administrative tek qytetarët që janë gjetur përgjegjës.

Lidhur me verifikimin në banesë të personave që rezultonin pozitiv serish vihet re që praktikatat e Komisariateve, objekt monitorimi, kanë qenë të ndryshme dhe jo të unifikuara. Asnjë nga institucionet nuk ka vënë në

dispozicion të KShH-së praktika dokumentacioni të planeve të kontrollit për këta shtetas, çka vendos në pikëpyetje realizimin e tyre në praktikë.

Komisariatet e Policisë Pogradec dhe Elbasan nuk kanë ofruar informacion sa i takon pyetjes nëse qytetarët kanë patur ankesa për cilësinë ose mungesën e shërbimeve nga ana e stafit të këtyre institucioneve. Nga ana tjetër, Komisarati i Policisë Durrës ka referuar se nuk ka patur ankesa nga ana e qytetarëve për shkak se angazhimi i policisë përgjatë kësaj periudhe ka qenë në zbatim të procedurave standarte dhe akteve normative. Shmangia e dhënies së informacionit të kërkuar nga KShH, vendos në pikëpyetje faktin nëse e disponon apo jo këtë informacion dhe nëse ka praktika dokumentacioni që bëjnë të mundur identifikimin e numrit të ankesave, objektit të tyre, mënyrës së trajtimit të tyre dhe si i janë përgjigjur qytetarëve ankues këto institucione.

3.2 Njësitë e Veçanta të Kujdesit Shëndetësor Publik në Durrës, Elbasan, Pogradec dhe Korçë

KShH, ju drejtua me kërkesa zyrtare për informacion, NjVKSh Durrës, Korçë, Elbasan dhe Pogradec, për zbatimin e legjislacionit anti-covid dhe vështirësitë e këtyre institucioneve, për periudhën Mars 2020 – Dhjetor 2021. Nga korrespondenca zyrtare me këto institucione, u mundësua dhënia e një informacioni të pjesshëm, çka në disa raste, solli vendosjen në lëvizje të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ngarkesa në punë dhe mungesa e mjeteve të nevojshme logjistike dhe mbrojtëse për t'ju përgjigjur pandemisë, veçanërisht në periudhën fillestare të saj, janë vështirësitë kryesore të ndeshura dhe të referuara prej NjVKSh-ve. Njësitë referojnë se për t'ju përgjigjur ngarkesës, pavarësisht se nuk ka patur shtim page, janë dhënë shpërblime, sipas VKM nr.207, dt.10.03.2020 . Nga ky shpërblim rezultojnë se kanë përfituar vetëm personeli i angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga Covid 19, në pozicionet mjek epidemiolog apo ndihmës/epidemiolog, laborant, personel mbështetës (shofer). Korrespondenca me NjVKSh-të evidenton se nuk janë zbatuar në tërësi, politika favorizuese që të lehtësojnë transportin e stafit shëndetësor në varësi të këtyre institucioneve.

Të pyetur lidhur me kuadrin ligjor, në zbatim të të cilit është vepruar gjatë pandemisë, jo të gjitha NjVKSh-të kanë qenë mjaftueshëm të orientuara për të cituar aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Madje, një pjesë e tyre reflektojnë një qëndrim pasiv në drejtim të përshtatjes dhe miratimit të

akteve të brendshme normative që shtjellojnë më tej aktet kuadër të miratuara nga Institucionet e tyre eprore.

Njësitë kanë shmangur përgjigjen për rastet konkrete të takimeve dhe grumbullimeve publike të ndjekura prej tyre, duke krijuar pikëpyetje për mundësinë efektive të mbikëqyrjes së këtyre takimeve dhe dokumentimit të rasteve kur masat anti-covid nuk janë respektuar.

Informacioni i përcjellë prej NJVKSH-ve është i vakët dhe nuk mundëson konkludimin nëse ka patur një plan të mirëfilltë ndërgjegjësues që të përcaktojë mënyrat dhe shpeshtinë e informimit dhe komunikimit me qytetarët dhe publikun për pandeminë, shpërndarjen gjeografike, duke përcaktuar edhe sfidat dhe vështirësitë për arritjen e grupeve të caktuara të popullsisë. KSHH ka kërkuar informacion nga NJVKSH-të se cilat janë masat që janë marrë prej tyre për të komunikuar me njerëzit në nevojë që nuk kanë akses në mjetet e teknologjisë së informacionit apo rrjetet sociale, por pavarësisht pohimeve deklarative, mungon informacioni lidhur me numrin e këtyre shtetasve, si janë identifikuar, zonat e vendbanimit, shpeshtësinë e komunikimeve me ta, mundësinë objektive të burimeve njerëzore për të patur kontakte të tilla

Në korrespondencën me NJVKSH-të vërehen përgjigje formale dhe jo të konkretizuara sa i takon asistencës që kanë patur nga institucionet qendrore me trajnime apo materiale ndërgjegjësuese për punonjësit e këtyre njësive (për mënyrën e përshtatjes së punës së tyre me pandeminë).

Pyetjes se si është operuar me vendosjen në dispozicion të të dhënave të personave që kanë rezultuar me Covid 19 dhe ndaj cilave institucioneve, NJVKSH-të i janë përgjigjur në mënyra të ndryshme. Mënyra e përcjelljes së tyre, disa herë e papërcaktuar dhe në raste të tjera e kryer me anë të emailit apo shkresave, vendos në pikëpyetje mbrojtjen e të dhënave sensitive të qytetarëve, ndërkohë që nuk dihet nëse këto institucione kanë patur Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), një detyrim ky sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Përgjigjet e sjella nuk reflektojnë një procedurë të mirëfilltë, lidhur me kategorizimin e rasteve (të lehta apo të rënda), mbajtjen e evidencave statistikore të rasteve të ndjekura në mënyrë ambulatorie, sa ka qenë e mundur që kapacitetet e spitaleve rajonale t'i përgjigjen nevojave për hospitalizimin e shtetasve që kanë shfaqur komplikacione përgjatë periudhës së infektimit, vështirësitë e ndeshura, etj. Të dhënat reflektojnë pikëpyetje mbi kapacitetet e nevojshme në burime njerëzore apo edhe

logjistike, për realizimin në praktikë të ofrimit të shërbimit ambulator në banesë.

KShH vëren se pavarësisht pohimit deklarativ të NJVKSh-ve, është e paqartë mënyra e realizimit dhe shtrirja gjeografike e fushatës ndërgjegjëse për vaksinat dhe nëse ka patur një plan konkret mbi të cilin është realizuar kjo fushatë. Prej njësive pranohet se janë mbajtur evidenca të përditësuara dhe regjistra të posaçëm nga çdo qendër shëndetësore për vaksinimin, por mungon informacioni për numrin e qytetarëve të cilët kanë zgjedhur vetë llojin e vaksinës dhe cilat janë kriteret që janë ndjekur për zgjedhjen e llojit të vaksinës me dëshirë, me qëllim që shpërndarja të mos realizohet në mënyrë selektive dhe subjektivisht. Numri i shtetasve që kanë marrë dozën e dytë dhe të tretë të vaksinës, ka pësuar një ulje të ndjeshme sipas shifrave të raportuara nga këto njësi, përgjatë periudhës së monitorimit.

Korrespondenca e realizuar me NJVKSH-të evidenton mungesë përgjigjeje për realizimin e masave dhe inspektimeve në tregjet e transportin publik, shpeshësinë dhe rezultatet e këtyre inspektimeve, në një kohë kur nëse ka raportuar në qytete të ndryshme, problematikat për mosrespektimin e distancës dhe maskave mbrojtëse në autobusët e transportit publikë.

KShH vëren mungesa në sistemin e gjurmimit, dokumentimit dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve, për cilësinë apo mjaftueshmërinë e shërbimeve shëndetësore në kushtet e pandemisë. Asnjë prej NJVKSH-ve nuk ka sjellë të dhëna statistikore për numrin e ankesave, grupimin e tyre sipas objektit të tyre (natyrës) dhe si janë trajtuar e dokumentuar ato, cila është përgjigjja që i është kthyer ankuesve pas marrjes në shqyrtim të tyre.

4. Analizë mbi pajtueshmërinë me standartet e të drejtave dhe lirive të njeriut, të masave anti-covid dhe efektit të tyre, veçanërisht tek njerëzit në nevojë

Në referencë të kufijve që vetë Kushtetuta ka përcaktuar për sa i takon vetëm një kategori të drejtash që kufizohen gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore (sipas nenit 175/2), vërehet se VKM nr.243, dt.24.3.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", nuk ka respektuar këto kufij kushtetues, pasi ka zgjeruar kategorinë e të drejtave të kufizuara përtej rezervës kushtetuese, duke kufizuar edhe lirinë e tubimit, e cila mbrohet nga neni 47 i Kushtetutës. Gjithashtu, sipas nenit 170, pika 3 të Kushtetutës, ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme. Në fakt, VKM nr.243,

dt.24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore" nuk rezulton të ketë reflektuar këtë detyrim kushtetues. Kompensimi i humbjeve në fakt, u realizua me aktet normative të mëvonshme, por ky kufizim ishte i pjesshëm dhe u përqëndrua në mbështetjen financiare të kufizuar në kohë që u dha ndaj disa kategorive shtetasish.

Tërheq vëmendjen fakti se, para se të shpallte gjendjen e fatkeqësisë natyrore dhe derogimit nga disa prej detyrimeve të parashikuara në KEDNJ dhe protokollet shtesë, Këshilli i Ministrave rezultoi se ka miratuar një sërë aktesh normative me fuqinë e ligjit¹⁸, të cilat përfshinë reduktim të trafikut ajror, tokësor dhe ujor, pezullim të procesit mësimor, vendosje të procedurave të karantinimit dhe vetë-izolimit, procedurave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike si dhe vendosjen e një regjimi të rrepta gjobash dhe masash administrative në rast të mos respektimit të kufizimeve të lëvizjes, karantinës, së drejtës për tubim, të aktivitetit të bizneseve, etj. Aktet e para normative të cilat, vendosën kufizime të ndjeshme në drejtim të lirive dhe të drejtave të njeriut, u miratuan në një hark shumë të ngushtë kohor (brenda afro dy javësh), çka vuri në pikëpyetje proporcionalitetin, kohezionin e dispozitave të tyre si dhe krijuan konfuzion e paqartësi edhe në publik për shkak të shpeshtësisë së ndryshimeve. Këto akte normative nuk ju nënshtruan qoftë dhe një konsultimi të pjesshëm me publikun dhe organizatat e shoqërisë civile, si gjatë konceptimit apo hartimit të tyre nga Këshilli i Ministrave, por edhe gjatë procedurave parlamentare të shqyrtimit të tyre.

Referuar burimeve të ndryshme të informacionit, ndër të drejtat dhe liritë e tkurrura më shumë përgjatë periudhës së pandemisë, mund të renditen e drejta e informimit¹⁹, liria e lëvizjes, liria e tubimit²⁰, e drejta për kujdes shëndetësor²¹ dhe liritë ekonomiko-sociale²².

¹⁸ Aktet normative janë të parashikuara në nenin 101 të Kushtetutës, sipas të cilit, Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mblidhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve.

¹⁹<https://www.kas.de/documents/271859/271908/Medien+in+Zeiten+von+Corona.pdf/11821c87-1368-bb92-60cc-2439749fd83b?version=1.0&t=1610016038604>

<https://faktoje.al/e-drejta-per-informim-veshtiresohet-gjate-pandemise-covid-19/>

https://www.shish.gov.al/pages/lajme/raporti_2020.html

²⁰ Vendimi nr.11 datë 09.03.2021 i Gjykatës Kushtetuese

²¹<https://www.kas.de/documents/271859/0/Raporti+Sistemi+sh%C3%ABndet%C3%ABsor+gjat%C3%AB+pandemis%C3%AB+COVID-19.pdf/3c2c74d2-5851-4886-e5be-ed1fd07d5b3c?version=1.0&t=1594801042957>

²²Artikull:<https://www.worldbank.org/sq/news/opinion/2020/06/02/intervieë-world-bank-country-manager-for-albania>

Strukturat e Bashkimit Evropian sikurse është Këshilli Evropian, kanë vendosur theksin tek proporcionaliteti i masave anti-covid dhe domosdoshmëria që ato të mos cenojnë thelbin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Ky Këshill rekomandoi që marrja e masave emergjente në kushtet e pandemisë globale COVID-19 të jenë proporcionale me qëllim që standardet demokratike dhe të të drejtave të njeriut të respektohen.²³

KShH ka vërejtur, në disa raste, se masat anti-covid kanë qenë të ashpra, jo proporcionale, johumane dhe të miratuara me nxitim, të cilat kanë mbartur premisa reale apo potenciale të cenimit të thelbit të së drejtës.

Më dt. 3 Prill 2020, ndërkohë që kurba e personave të prekur me Covid-19 në vendin tonë po pësonte një rritje graduale, media raportoi me shqetësim lajmin e infektimit të stafit administrativ pranë IEVP Rrogzhinë²⁴. KShH i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të huazojnë e përshtatin një mekanizëm transparence, duke informuar publikun dhe median, në mënyrë të ngjashme me atë të përdorur nga institucionet e shëndetit publik, në vendin tonë²⁵.

KShH reagoi në dt.6 Prill të vitit 2020²⁶, për situatën shqetësuese të disa shtetasve shqiptarë të bllokuar në zonën neutrale midis kufirit grek dhe atij shqiptar, pasi nuk u lejuan të futen në territorin shqiptar nga autoritetet tona të kufirit (si në Pikat e Kalim Kufirit Kakavijë dhe Kapshticë). Qëndrimi i këtyre shtetasve në zonën neutrale për orë të tëra dhe pa kushtet minimale të jetesës vendosi në rrezik jetën dhe shëndetin e tyre, si dhe i nënshtroi këta shtetas ndaj elementëve të trajtimit johuman dhe degradues. KShH i rekomandon autoriteteve një qasje humane dhe jo ndëshkuese ndaj kësaj kategorie personash, të cilët kanë vepruar në kushtet kur liria e tyre e lëvizjes është kufizuar në mënyrë jo proporcionale

Artikull:<https://citizens-channel.com/2020/09/20/ndikimet-e-pandemise-covid-19-tek-jeta-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara/>

Artikull:<https://www.aa.com.tr/sq/ballkani/ndikimi-i-pandemis%C3%AB-covid-19-n%C3%AB-ekonomi%C3%AB-e-rajonit-tregtia-elektronike-n%C3%AB-rritje-turizmi-n%C3%AB-r%C3%ABnie/1928785>

²³ Rekomandimi i Këshillit (BE) 2020/1475 i datës 13 tetor 2020 për një qasje të koordinuar ndaj kufizimit të lëvizjes së lirë në përgjigje të pandemisë COVID-19, i aksesueshëm në: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.L_.2020.337.01.0003.01.ENG

²⁴ Lajmi mbi infektimin e mundshëm të punonjësit të IEVP "Jordan Misja" (313) u publikua më dt.15Prill 2020.

²⁵ <https://ahc.org.al/njoftim-mbi-nevojen-per-transparence-nga-institucionet-e-sistemit-penitenciar/>

²⁶ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/2575816975875150>

dhe në kushtet për të garantuar mbijetesën, pasi nuk përballojnë dot qëndrimin dhe jetesën në vendet fqinje".

KShH së bashku me 29 organizata të shoqërisë civile, ngritën alarmin në 11 Prill të vitit 2020, me anë të një deklarate për shtyp, për ndryshimet e propozuara në Kodin tonë Penal, të cilat dënojnë penalisht disa forma të mosbindjes së qytetarëve ndaj masave të organeve kompetente shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore (neni 242/1) dhe disa forma të shkeljes së rregullave të karantinës për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive (242/2)²⁷. KShH ka mbajtur qëndrimin se nevoja për ndryshimet në Kodin Penal nuk mund të justifikojnë qëllimin nëse cenohen parime të rëndësishme kushtetuese si parimi i shtetit të së drejtës, ndalimin kushtetues ndaj Kuvendit për të mos miratuar me procedurë të përshpejtuar ligje që kërkojnë shumicë të cilësuar si dhe nëse nuk përmbushen në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës²⁸.

Reporterit Special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për lirinë e tubimit dhe organizimit u bëri thirrje të gjithë shteteve anëtare që me masat e marra ndaj COVID-19 të mos cenojnë lirinë e tubimit dhe organizimit.²⁹ Në deklaratën për shtyp të dt.13 Maj 2020, KShH sugjeroi rishikimin e formulimit në aktin normativ nr.3, të datës 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19"³⁰. KShH vërejti se bazuar edhe në praktikën e vendeve të tjera demokratike të Evropës, ku janë lejuar tubimet që respektojnë distancimin fizik dhe me masa mbrojtëse, siç janë distancimi fizik i protestuesve, përdorimi i mjeteve mbrojtëse prej tyre, etj, sanksionet në legjislacionin shqiptar tkurrin në mënyrë jo proporcionale të drejtat dhe liritë themelore sikurse është liria e tubimit dhe e organizimit³¹. Në deklaratën publike për shembjen me urgjencë të Teatrit Kombëtar³², në dt.17 Maj 2020, KShH nënvizoi se nuk ishte momenti i përshtatshëm, duke marrë parasysh faktin se për shkak

²⁷ <https://ahc.org.al/deklarate-e-perbashket-per-median/>

²⁸ Sipas të cilit kufizimi i të drejtave dhe lirive të njeriut duhet të bëhet vetëm me ligj; për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve; kufizimi të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë (parimi i proporcionalitetit); të mos cenojë thelbin e së drejtës; dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

²⁹ Deklaratë e Reporterit Special të OKB për të drejtën e tubimit dhe organizimit, e aksesueshme

në: <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25792&LangID=E>

³⁰ Miratuar nga Kuvendi me ligjin nr. 24/2020.

³¹ <https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-15/>

³² <https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-17-maj-2020/>

të pandemisë Covid 19, në vendin tonë ishte vendosur gjendja e fatkeqësisë natyrore

Sa i takon akteve normative me fuqinë e ligjit të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe më pas edhe Kuvendi, tërheqin gjithashtu vëmendjen kundra vajtjet e reja administrative për mosrespektimin e masave në kushtet e kësaj pandemie, lloji dhe natyra e sanksioneve, autoritetet përgjegjëse për vendosjen e këtyre sanksioneve, mosparashikimin e së drejtës së ankimit shprehimisht në ligj dhe problematikat e aksesit në drejtësi për të kundërshtuar këto sanksione, të cilat vijnë edhe si rezultat i pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë gjyqësore si dhe mungesës së kuadrit ligjor dhe infrastrukturor për të patur akses në gjykata me mjetet e teknologjisë së informacionit. Konkretisht, u vërejt se aktet normative:

- parashikonin vendosjen e dënimeve me gjobë fikse, pra pa vendosur një marzh të arsyeshëm minimum dhe maksimumi, duke mos marrë parasysh kushtet sociale-ekonomike të shtetasve në vendin tonë.
- të drejtën e dhënies së masave administrative, e ka organi kompetent sipas fushës së përgjegjësisë si dhe, në çdo rast, Policia e Shtetit, e cila nga interpretimi ligjor duket se merr një prevalencë në raport me autoritetet e tjera ligj zbatuese. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ, autoritetet policore nuk përmbushin garancitë e kërkuara mbi paanshmërinë dhe pavarësinë të kërkuara nga neni 6/1 i Konventës Evropiane³³.
- gjobat administrative sipas akteve normative në kushtet e pandemisë përbëjnë titull ekzekutiv, çka do të thotë se subjektit ndaj të cilit jepen i lind detyrimi ti ekzekutojë (paguajë) menjëherë. Në përmbajtjen e akteve normative nuk parashikohet shprehimisht e drejta për të ankuar këto masa, tek një organ epror i autoritetit që i ka dhënë apo drejtpërsëdrejti në gjykatë³⁴³⁵.

³³ Jurisprudenca e GJEDNJ ka elaboruar standartin që gjykata ku ankohen vendimet e këtyre organeve duhet të përmbushë këto garanci dhe të ketë juridiksion të plotë për të shqyrtar faktet e përcaktuara nga autoriteti administrativ, të pranojë provat të reja në gjykim dhe të mos kufizohet vetëm në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të autoritetit administrativ (Çështja Belilos k. Zvicrës).

³⁴ Këto gjoba derdhen në masën 100% në buxhetin e shtetit. Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative menjëherë sapo ato jepen nga organi përkatës parashikohet edhe në ligjin në fuqi Nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

³⁵ Akti administrativ nr.3 parashikon vetëm se shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Në të drejtën administrative është e njohur se nëse ligji i posaçëm nuk parashikon organin epror ku mund të atakohen masat administrative, atëherë personi që preket nga këto masa mund ti drejtohet drejtpërsëdrejti gjykatës (neni 129, gërma "a" e Kodit të Procedurës Administrative).

Në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut³⁶, nën suazën e garancive procedurale të paanshmërisë dhe pavarësisë të së drejtës për një proces të rregullt (sipas nenit 6/1 të Konventës) është theksuar nevoja që vendimet e autoriteteve administrative të cilat nuk plotësojnë këto garanci, t'i nënshtrohen kontrollit vijues nga "një organ gjyqësor që ka juridiksion të plotë". Problemi që u shfaq në kushtet e kufizimit të lirisë së individëve si pasojë e karantinimit, në kohën kur edhe veprimtaria e organeve gjyqësore, përfshi këtu gjykatat administrative u pezullua në shumicën më të madhe, është mungesa e aksesit efektiv në organet e drejtësisë. Për shkak të pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore nga KLGJ³⁷, mungesës së kuadrit ligjor dhe infrastrukturor të nevojshëm për përdorimin e teknologjisë së informacionit nga përdoruesit e gjykatave, 'kundravajtësit' ose "shkelësit e akteve të mësipërme" dhe publiku i gjerë ndeshën vështirësi në aksesin efektiv në organet e drejtësisë, për t'u mbrojtur efektivisht nga arbitrariteti potencial në dhënien e sanksioneve³⁸.

Gjatë vitit të parë dhe më të vështirë të pandemisë, KSHH ka qenë e vetmja organizatë në rajon që ka hyrë në sistemin e burgjeve për të ushtruar misionin e saj monitorues, së bashku me përfaqësues të Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor, pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Në dt. 14 Tetor 2020, një grup i përbashkët monitorimi realizoi një mision monitorimi tematik në IEVP "Ali Demi" (325). Gjatë monitorimit u vërejt me shqetësim akomodimi i shtetaseve ndaj të cilave Gjykata ka caktuar masë mjekësore "mjekim i detyruar" (neni 46 Kodi Penal) dhe masë sigurimi "shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik" (nenin 239 I Kodit të Procedurës Penale), në një ambient të përbashkët në formë kapanoni, me kushte infrastrukturore të amortizuara, në mungesë të një shërbimi të specializuar periodik e të përshtatshëm mjekësor dhe psiko-social, duke u mjaftuar vetëm në trajtimin e mirëfilltë farmakologjik.³⁹

³⁶ *Ortenberg kundër Austrisë*, § 31, *Geffre kundër Francës*, *Ramos Nunes de Carvalho dhe Sá kundër Portugalisë* [Dhoma e Madhe], § 132

³⁷ <http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-24-mars-2020-per-pezuillim-veprimtarie/>
<http://klgj.al/njoftim-per-shtyp-26-mars-2020-per-pezuillim-veprimtarie/>

³⁸ E drejta për tu dëgjuar në kuadër të një procesi gjyqësor të zhvilluar brenda një afati të arsyeshëm është një nga garancitë procedurale të parashikuara shprehimisht në nenin 6/1 të KEDNJ-së, ndërkohë që veprimtaria e gjykatave rezulton të jetë e pezulluar dhe numri i masave administrative është relativisht i lartë (sipas raportimeve në media).

³⁹ Qëndrimi i këtyre shtetaseve prej afro gati 5 muajsh, nga dt.24 Prill – 14 Tetor 2020, u kushtëzua nga fakti se IVSHB u shndërrua në një spital anti-covid për popullatën e burgjeve. Kjo vendimarrje ka qenë e nxituar, dhe nuk është shoqëruar me vlerësimin paraprak, për të identifikuar dhe kapërcyer faktorët që do të përkeqësonin trajtimin dhe gjendjen e tyre. Faktet e verifikuara gjatë monitorimit, evidentuan cënimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të të drejtave dhe lirive themelore, duke i vendosur këto shtetase në kushtet e trajtimit ç'njerëzor dhe

Përgjatë 2 viteve të pandemisë, teksa ndaj qytetarëve bëhej thirrje në mënyrë të vazhdueshme për të mos marrë pjesë në grumbullime në ambiente të brendshme dhe të jashtme, që nuk respektonin masat ligjore anti-covid, ky standart duket se nuk gjeti reflektim në praktikë, përgjatë fushatës zgjedhore të zgjedhjeve parlamentare të dt.25 Prill 2021. Monitorimi i KShH-së evidentoi se takimet elektorale shpesh u zhvilluan në mënyrë informale, në ambiente të mbyllura, në cenim të masave dhe protokolleve shëndetësore për parandalimin e përhapjes së Covid-19. Gjithashtu u vërejt aplikim selektiv i gjobave administrative për mosrespektimin e këtyre masave nga subjektet zgjedhore⁴⁰. Vëzhguesit afatshkurtër të KShH-së, sinjalizuan rregullisht se masat ndaj Covid-19 (mbajtja e maskës, distancimi) nuk u zbatuan në mënyrë të përgjegjshme dhe rigoroze në Qendrat e Votimit dhe Vendet e Numërimit⁴¹.

Përkundrajt kësaj situate të procesit para dhe gjatë zgjedhor, ku masat anti-covid nuk u respektuan, u vërejt me shqetësim se vetëm 6 ditë para zgjedhjeve (19 Prill 2021), Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nxori një urdhër për karantinimin e personave që vijnë në vendin tonë, përmes rrugëve ajrore, tokësore dhe detare nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia. Ky urdhër preku gjithashtu shtetasit shqiptarë që donin të ushtronin të drejtën e votës dhe që jetojnë në këto shtete fqinje apo të cilët përdorin tranzit këto shtete për të hyrë në vend. Këto rregulla privuan në mënyrë joproporcionale dhe selektive, shtetasit shqiptar banues në këto shtete, nga e drejta themelore e votës⁴².

METODOLOGJIA

Shtyllë e rëndësishme e metodologjisë së Barometrit, e cila vjen si risi në këtë raport është matja e perceptimit të qytetarëve lidhur me masat-anticovid të realizuar me anë të një sondazhi.

A. Sondazhi me njerëzit për të drejtat dhe liritë e njeriut gjatë pandemisë

Nëpërmjet sondazhit synohej evidentimi i perceptimit të qytetarëve lidhur me kufizimet e vendosura që mund të prekin disa prej të drejtave e lirive themelore të njeriut përgjatë periudhës së pandemisë Covid-19, duke u

poshtërues https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2020/11/Raport-i-vecante_-IEVP-325.pdf

⁴⁰https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/06/Raport-Monitorimi_-Zgjedhje-Parlamentare-ne-14-Bashki-te-vendit.pdf

⁴¹<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2022/04/Raport-Perfundimtar-mbi-gjetjet-dhe-perfundimet-e-monitorimit-te-Zgjedhjeve-per-Kuvend-te-25-prill-2021.pdf>

⁴²https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2021/04/Raport-Paraprak-per-Procesin-Parazgjedhor_Monitorimi-KShH_23-Prill-2021.pdf

fokusuar specifikisht në të drejtën për informim, të lirinë e lëvizjes, të drejtën për tubim, të drejtën për kujdes shëndetësor dhe liritë ekonomiko-sociale për periudhën Mars 2020-Dhjetor 2021.

Sondazhi është realizuar me anë të një pyetësi të hartuar nga KShH, konform legjislacionit në fuqi dhe standarteve të të drejtave dhe lirive të njeriut. Pyetësi është shpërndarë në rrugë elektronike në formatin *google form* me anë të faqes së internetit dhe në rrjeteve sociale e profesionale të komunikimit të KShH. Kjo u ka mundësuar të interesuarve ta plotësojnë në mënyrë të pavarur. Gjithashtu, me qëllim plotësimin e pyetësit në një mënyrë sa më gjithëpërfshirëse, duke synuar edhe zonat rurale, një pjesë e tij është plotësuar fizikisht, në 7 qytete të mëdha, përkatësisht në qytetin e Korçës, Shkodrës, Elbasanit, Tiranës, Durrësit, Fierit dhe Kukësit.

Në total pyetësi arriti të sigurojë një përfaqësim kampionimi prej afro 900 qytetarësh, prej të cilëve, 488 qytetarë e kanë plotësuar në formatin elektronik, dhe 403 e kanë plotësuar pas kontaktit ballë për ballë, nga anketuesit e KShH-së.

Pyetësi u ndërtua mbështetur në një analizë paraprake të shpërndarjes së popullsisë në vend dhe në qytetet që janë njëkohësisht qendrat e qarqeve kryesore në vendin tonë. Mosha për të cilin u ndërtua pyetësi është mbi 18 vjeç. Për zhvillimin e pyetësit u mor në konsideratë mundësia e zhvillimit në dy forma me qëllim plotësimin e këtij pyetësi edhe nga shtetas të cilët nuk kanë mundësi aksesit në mjetet teknologjike: fizike dhe elektronike.

Pyetësi i hartuar përbëhet nga 64 pyetje (të mbyllura dhe/ose të hapura)⁴³. Pas plotësimit të pyetësit dhe hedhjes në sistem, të dhënat për përgjigjet e pyetjeve që janë përzgjedhur sipas alternativave të propozuara (të mbyllura), janë përpunuar në formën statistikore. Të dhënat për përgjigjet e hapura, janë përpunuar nga pikëpamja cilësore nga ekspertët e angazhuar për zbatimin e Barometrit. Të anketuarve, i është lënë mundësia ta plotësojnë në mënyrë anonime pyetësin, me qëllim të ndiheshin të lirë dhe jo të paragjykuar për përgjigjet e dhëna.

Pyetjet janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të ndjekin një sekuencë specifike, fillimisht duke mbledhur përgjigje për pyetjet në lidhje me informacion të përgjithshëm mbi grup moshën, gjininë, arsimimin, qarkun, zonën e banimit (urbane/rurale), informacione mbi covid, më tej kalohet në pesë sesione specifike të cilat kanë gërshetuar pyetjeje me alternativa

⁴³ Pyetjet përbëhen nga një grup prej 7 pyetjesh të hapura, 12 pyetjesh gjysëm të hapura dhe 45 pyetje me alternativa. Pyetësi mund të aksesohet në: <https://ahc.org.al/ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-dhe-lirite-themlore-te-shtetasve-shqiptare/>

dhe pyetje të hapura për të mësuar më tepër mbi përjetimet e të pyeturve gjatë ngjarjeve të zhvilluara në periudhën e studimit. Konkretisht, pyetjet janë parashtruar në 5 seksione të ndryshme, të organizuara si vijon:

- i. **Seksioni i parë** i pyetjeve mundëson mbledhjen e të dhënave të përgjithshme mbi të anketuarit
- ii. **Seksioni i dytë** mundëson mbledhjen e të dhënave lidhur me ndikimin e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 në të drejtën për informim. Këtu përfshihen mjetet e informimit, aksesit në informacion të vazhdueshëm dhe të besueshëm, keqinformimi etj.
- iii. **Seksioni i tretë** mundëson mbledhjen e të dhënave lidhur me ndikimin e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 në lirinë e tubimit dhe grumbullimit.
- iv. **Seksioni i katërt** mundëson mbledhjen e të dhënave lidhur me të drejtën për kujdes shëndetësor
- v. **Seksioni i pestë** mundëson mbledhjen e të dhënave lidhur me ndikimin e pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 në liritë ekonomiko-sociale.

Sondazhi u realizua gjatë periudhës 28 shkurt-25 Maj 2022. Pyetësi u fokusua në këtë periudhë plotësimi, pasi masat e parashikuara nëpërmjet akteve ligjore e nënligjore, gjatë muajit mars 2022 u shfuqizuan tërësisht.

44

Të dhënat nga çdo pyetje u analizuan në tërësi (në nivel kombëtar) dhe më tej në veçanti sipas rajonit, gjinisë, grup moshës dhe nivelit të urbanitetit, arsimit për të kuptuar nëse ka dallime midis këtyre grupeve të ndryshme të popullsisë në lidhje me temat specifike që trajton anketa.

⁴⁴ Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 32/3, datë 2.3.2022 Për shfuqizimin e urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2022/03/02/32-3/e9222098-fb47-46ef-b76b-0133117b93c0>

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 155, datë 2.3.2022 Për shfuqizimin e urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve", të ndryshuar, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2022/03/02/155/06d50af1-8542-46a4-bac1-be82da96002a>

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 32/3, datë 2.3.2022 Për shfuqizimin e urdhrin nr. 99, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit", të ndryshuar, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2022/03/02/32-3/e9222098-fb47-46ef-b76b-0133117b93c0>

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 155, datë 2.3.2022 Për shfuqizimin e urdhrin nr. 100, datë 10.2.2021, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve", të ndryshuar, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2022/03/02/155/06d50af1-8542-46a4-bac1-be82da96002a>

Përzgjedhja e të anketuarve është në mënyrë të rastësishme duke konsideruar dhe u kujdesur për gjithë përfshirje të gjinisë, grup moshës, rajonit gjeografik etj.

Një planifikim mbi metodologjinë dhe kuotat e parashikuara për secilin rajon gjeografik në vend u krye paraprakisht bazuar mbi të dhënat e popullsisë në rajonet që ishin në vëmendje të pyetësorit.

Për pyetësorët u tregua kujdes që çdo individ të jepte pëlqimin e tij/saj duke u informuar se pjesëmarrja në anketë ishte vullnetare, dhe asnjë e dhënë personale nuk do të shpërndahej dhe se i gjithë informacioni i dhënë do të përdorej vetëm për qëllime të analizës së të dhënave.

B. Sondazhi me studentët për cilësinë e arsimit të lartë dhe disa të drejta studentore

Të dhënat e këtij pyetësori, seksion i veçantë i Barometrit me fokus të drejtën e arsimit të lartë, përfshijnë një grup prej 14 pyetjesh të hapura, 5 pyetjesh gjysmë të hapura dhe 21 pyetje me alternative.⁴⁵ Pyetjet janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të ndjekin një sekuencë specifike. Personave të pyetur, i është lënë mundësia ta plotësojnë në mënyrë anonime pyetësorin, me qëllim të ndiheshin të lirë dhe jo të paragjykuar për përgjigjet e dhëna.

Për pyetësorët u tregua kujdes që çdo individ të jepte pëlqimin e tij/saj duke u informuar se pjesëmarrja në anketë ishte vullnetare, dhe asnjë e dhënë personale nuk do të shpërndahej dhe se i gjithë informacioni i dhënë do të përdorej vetëm për qëllime të analizës së të dhënave.

Të dhënat nga çdo pyetje u analizuan në tërësi (në nivel kombëtar) dhe më tej në veçanti sipas rajonit, gjinisë, universitetit ku studiojnë⁴⁶, natyrës së fakultetit ku studiojnë, nivelit të studimeve (bachelor apo master) për të kuptuar nëse ka dallime midis këtyre grupeve të ndryshme të studentëve në lidhje me ndikimin e Covid-19 në procesin arsimor të tyre.

Përzgjedhja e të anketuarve është në mënyrë të rastësishme duke konsideruar dhe u kujdesur për gjithë përfshirje të gjinisë, rajonit

⁴⁵ Pyetësori mund të aksesohet në: <https://ahc.org.al/pyetesor-per-studentet/>

⁴⁶ Pyetësori u realizua me studentë të Universiteteve Publike në vend të tillë si Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti i Arteve, Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Universiteti i Sporteve, Tiranë, Universiteti Politeknik i Tiranës, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Universiteti "Eqerem Çabej", Gjirokastrë, Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, Universiteti "Fan S. Noli", Korçë si dhe studentë të Universiteteve Private, në një numër më të vogël në raport me ato publike.

gjeografik, nivelit të studimeve, natyrës së studimeve sipas fakultetit etj. Pyetësi i studentëve, i cili arriti të sigurojë një përfaqësim prej 444 individësh në rang vendi, u zhvillua fizikisht nëpërmjet qasjes në ambientet universitare, ku studentët që e kanë plotësuar pyetësin kanë qenë minimalisht në vitin e dytë Bachelor, në mënyrë që gjatë periudhës së studimeve të tyre, të jenë prekur nga kufizimet e vendosura për shkak të pandemisë Covid-19.

Një planifikim mbi metodologjinë dhe kuotat e parashikuara për secilin universitet publik në vend u krye paraprakisht bazuar mbi të dhënat e studentëve aktualë të regjistruar sipas shifrave zyrtare të publikuara nga Ministria e Arsimit Sporteve dhe Rinisë. Universitetet jo-publike nuk kanë qenë të përjashtuar nga studimi por vëmendja kryesore i është kushtuar studentëve të universiteteve publike në vend. Kampionimi i studentëve u përcaktua bazuar mbi shifrat zyrtare të studentëve të regjistruar në vitin akademik 2020 ⁴⁷.

C. Metoda e vlerësimit dhe analizës së kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij

Gjithashtu, barometri pasqyron:

- një panoramë të reagimeve publike dhe ndërhyrjeve institucionale të KShH-së sa i takon kufizimeve të të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht në fazën e parë dhe më kritike të pandemisë në vend.
- një analizë të pjesshme të kuadrit ligjor të miratuar gjatë pandemisë, nën dritën e dispozitave kushtetuese,
- të dhënat e përfthuara me kërkesa për informacion drejtuar disa institucioneve në vend, sa i takon zbatimit të kuadrit ligjor për masat anti covid gjatë periudhës Mars 2020-Dhjetor 2021, si dhe aspekte të tjera të ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

⁴⁷ www.instat.gov.al/media/8303/popullsia-me-1-janar-2021.pdf

KREU 1

ANALIZË E KUADRIT LIGJOR NË FUQI

Neni 170 i Kushtetutës përcakton parimet dhe kriteret themelore sa i takon vendosjes së masave të jashtëzakonshme, ndër të tjerash gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, e cila u vendos për shkak të pandemisë së krijuar nga virusi "Covid 19", gjatë periudhës 24 Mars – 24 Qershor (tre muaj), në vendin tonë. Sipas kësaj dispozite kushtetuese:

1. Masat e jashtëzakonshme mund të vendosen për shkak të gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe zgjatin për aq kohë sa vazhdojnë këto gjendje.
2. Parimet e veprimtarisë së organeve publike dhe shkalla e kufizimit të të drejtave dhe lirive të njeriut gjatë gjithë periudhës së ekzistencës së gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, përcaktohen me ligj.
3. Ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme.
4. Aktet që ndërmerren si pasojë e marrjes së masave të jashtëzakonshme, duhet të jenë në përpjesëtim me shkallën e rrezikut dhe duhet të synojnë rivendosjen sa më të shpejtë të kushteve për funksionimin normal të shtetit.
5. Gjatë gjendjeve që kërkojnë marrjen e masave të jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohet asnjë prej këtyre akteve: Kushtetuta, ligjet për zgjedhjet për Kuvendin dhe për organet e pushtetit vendor, si dhe ligjet për masat e jashtëzakonshme.
6. Gjatë periudhës së zbatimit të masave të jashtëzakonshme nuk mund të zhvillohen zgjedhje vendore, nuk mund të zhvillohet referendum, si dhe nuk mund të zgjidhet një President i ri i Republikës. Zgjedhjet vendore mund të bëhen vetëm aty ku nuk zbatohen masat e jashtëzakonshme.

Neni 174 i Kushtetutës, parashikon organin vendimmarrës, kohëzgjatjen dhe shtrirjen territoriale të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, e cila sipas paragrafit të parë të këtij neni vendoset nga Këshilli i Ministrave, për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, në një pjesë ose në të gjithë territorin e shtetit. Në pikën 2 të kësaj dispozite, parashikohet se zgjatja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore mund të bëhet vetëm me pëlqimin e Kuvendit.

Teksa data 10 mars 2020 shënon datën e akteve të para të miratuara nga Qeveria Shqiptare, të cilat kanë parashikuar kufizime të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, për t'ju përgjigjur pandemisë globale të shkaktuar nga virusi "Covid 19", 14 ditë më vonë, përkatësisht në dt.24

Mars, Këshilli i Ministrave shpalli në vendin tonë gjendjen e fatkeqësisë natyrore. Një muaj më vonë, kjo gjendje u zgjat, deri më dt. 23.6.2020.

Referuar pikave 2 dhe 3 të nenit 175 të Kushtetutës, parashikohen të drejtat dhe liritë që mund të kufizohen gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore si dhe domosdoshmëria që aktet për shpalljen e kësaj gjendje, të cilësojnë posaçërisht të drejtat që kufizohen gjatë saj. Neni 175/2 i Kushtetutës është shterues sa takon të drejtave që mund të kufizohen gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore, duke parashikuar shprehimisht 5 kategoritë e të drejtave në nenet kushtetuese të shtjelluara në vijim:

- Neni 37 që parashikon paprekshmërinë e banesës dhe individit,
- Neni 38 që parashikon të drejtën e vendbanimit dhe lëvizjen e lirë,
- Neni 41 paragrafi 4 që parashikon kriteret kushtetuese të shpronësimit dhe kufizimet e së drejtës pronësore,
- Neni 49 që parashikon të drejtën për të fituar mjetet e jetesës me punë të ligjshme, e drejta për të zgjedhur punën dhe profesionin dhe për mbrojtjen shoqërore të të punësuarve,
- Neni 51 që parashikon të drejtën e grevës dhe kufizimet e saj.

Në referencë të kufijve që vetë Kushtetuta ka përcaktuar për sa i takon vetëm një kategori të drejtash që kufizohen gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore (sipas nenit 175/2), vërehet se VKM nr.243, dt.24.3.2020, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", nuk ka respektuar këto kufij kushtetues, pasi ka zgjeruar kategorinë e të drejtave të kufizuara përtej rezervës kushtetuese, duke kufizuar edhe lirinë e tubimit⁴⁸, e cila mbrohet nga neni 47 i Kushtetutës.

Sipas nenit 170, pika 3 të Kushtetutës, ligji duhet të përcaktojë parimet, fushat dhe mënyrën e kompensimit të humbjeve që vijnë si rezultat i kufizimit të të drejtave dhe lirive gjatë marrjes së masave të jashtëzakonshme. Në fakt, VKM nr.243, dt.24.3.2020 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore" nuk rezulton të ketë reflektuar këtë detyrim kushtetues. Kompensimi i humbjeve në fakt, u realizua me aktet normative të mëvonshme, por ky kufizim ishte i pjesshëm dhe u përqendrua në mbështetjen financiare të kufizuar në kohë që u dha ndaj disa kategorive shtetasish.

⁴⁸ Në referencë të pikës 4, gërma "d" të VKM nr.243, dt.24.03.2020

1. Aktet normative me fuqinë e ligjit

Para se të shpallte gjendjen e fatkeqësisë natyrore dhe derogimit nga disa prej detyrimeve të parashikuara në KEDNJ dhe protokollet shtesë, Këshilli i Ministrave rezulton se ka miratuar një sërë aktesh normative me fuqinë e ligjit, të cilat përfshinë reduktim të trafikut ajror, tokësor dhe ujor, pezullim të procesit mësimor, vendosje të procedurave të karantinimit dhe vetë-izolimit, procedurave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike si dhe vendosjen e një regjimi të rrepta gjobash dhe masash administrative në rast të mos respektimit të kufizimeve të lëvizjes, karantinës, së drejtës për tubim, të aktivitetit të bizneseve, etj.

Këto akte normative të cilat, vendosën kufizime të ndjeshme në drejtim të lirive dhe të drejtave të njeriut, u miratuan në një hark shumë të ngushtë kohor, çka vuri në pikëpyetje kohezionin e dispozitave të tyre si dhe krijuan konfuzion e paqartësi edhe në publik për shkak të shpeshtësisë së ndryshimeve. Aktet nuk ju nënshtruan qoftë dhe një konsultimi të pjesshëm me publikun dhe OSHC-të, si gjatë konceptimit apo hartimit të tyre nga Këshilli i Ministrave, por edhe gjatë procedurave parlamentare të shqyrtimit të tyre.

Miratimi i akteve normative me fuqinë e ligjit, parashikohet në nenin 101 të Kushtetutës, sipas të cilit *"Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve"*.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese është shprehur, *"transferimi i kompetencës legjislative Këshillit të Ministrave, që, përjashtimisht, të marrë masa të përkohshme në rast nevojë dhe urgjence, i nënshtrohet para së gjithash, kufizimeve kushtetuese, të cilat konsistojnë në kritere procedurale dhe po ashtu lëndore, të përcaktueshme nga natyra e marrëdhënies konkrete që kërkon rregullim. Në këtë kuptim, **Kuvendi nuk mund të delegojë pushtetin e tij ligjbërës, por ka detyrimin kushtetues të përmbushë kërkesat procedurale dhe lëndore për miratimin e ligjeve të cilësuar sipas nenit 81/2 dhe 83 të Kushtetutës, në raport me nenet 1, 2, 4, 7 dhe 116 të Kushtetutës, aq më pak Këshilli i Ministrave mund të***

ndërhyjë në akte normative më fuqinë e ligjit në ato fusha, rregullimi i të cilave, expressis verbis, përbën kompetencë ekskluzive të Kuvendit⁴⁹.

Gjykata Kushtetuese ka nënvizuar gjithashtu se kompetenca e Kuvendit për miratimin e aktit normativ konsiston në vlerësimin në formë dhe përmbajtje të normës dhe elementeve përbërëse të saj, si dhe në shprehjen e mendimit përfundimtar lidhur me aktin normativ. Natyra e këtij vlerësimi është politike, **por dhe juridike**. Kuvendi shqyrton praninë e të gjitha elementeve të përcaktuara shprehimisht për aktin normativ me fuqinë e ligjit në Kushtetutë, si dhe pajtueshmërinë e përmbajtjes së tij me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi. Kuvendi i Shqipërisë është organi që bën vlerësimin dhe kontrollin e nevojës dhe urgjencës, sepse Kushtetuta e ka ngarkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për këtë qëllim. Kuvendi, gjatë miratimit të aktit normativ, ka diskrecion të zgjedhë një nga tri alternativat e mëposhtme:

- (i) të marrë në shqyrtim dhe ta miratojë aktin e nxjerrë nga Këshilli i Ministrave,
- (ii) ta marrë në shqyrtim dhe të mos e miratojë atë,
- (iii) të heshtë derisa të plotësohet afati 45 ditor që dispozita kushtetuese i ka lënë në dispozicion për t'u shprehur lidhur me aktin.

Vlerësimi dhe miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit, të nxjerrë nga qeveria, dhe dhënia fuqi të mtejshme atij nuk mund të bëhet ndryshe veçse me anë të një norme që ka të njëjtat vlera, pra me ligj⁵⁰.

❖ Në dt.11 Mars 2020, Këshilli i Ministrave miratoi aktin e parë normativ nr.2 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"⁵¹. Brenda afatit kushtetues 45 ditor, ky akt u miratua nga Kuvendi me ligjin Nr. 23/2020. Në nenin 3 të këtij ligji janë parashikuar disa kundravajtje administrative, të cilat sanksionohen me gjobë që varion deri në shumën maksimale 700,000 Lek. Këto kundravajtje prekin më së shumti entet shtetërore apo private (të kontraktuara për ofrimin e shërbimeve), nëse

⁴⁹ Shih vendimin nr.5, dt. 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi nr.63

⁵⁰ Shih vendimin nr.24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese

⁵¹ Ligj nr. 23/2020 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 11.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive"", i aksesueshëm në: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200423110246ligj%20nr.%2023,%20dt.%2016.4.2020.pdf>

Akt normativ nr.2, datë 11.3.2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive," i aksesueshëm në: <https://shukalb.al/ep-content/uploads/2020/04/akt-normativ-2020-03-11-2.pdf>

nuk marrin masat e përgjithshme apo të veçanta për mbrojtjen e popullatës nga infeksionet dhe sëmundjet infektive (në rastin konkret nga Covid 19). Por në këtë akt, parashikohen sanksione edhe për personat (individët), p.sh. dënimi me gjobë 100.000 (njëqind mijë) lekë kur refuzohet vendosja në mbikëqyrje shëndetësore.

❖ Pas 4 ditësh nga miratimi i aktit të parë, në dt.15 Mars 2020, Këshilli i Ministrave miratoi aktin tjetër normativ nr.3 me fuqinë e ligjit, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19⁵²". Ky akt u shqyrtua gjithashtu në Parlament dhe u miratua prej tij në dt.16.04.2020 me ligjin nr.24/2020⁵³. Akti parashikon kundravajtjet dhe masat administrative që do të merren ndaj personave fizikë/juridikë apo individë, shqiptarë ose të huaj, të cilët shkelin rregullat, vendimet, urdhrat dhe udhëzimet e nxjerra nga organet kompetente, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19. Konkretisht:

- Gjoba më e lartë e parashikuar në këtë akt ndaj individëve kur organizohen aktiviteteve publike dhe jopublike, përfshi këtu tubimet, është në masën 5 000 000 (pesë milionë) Lek të reja.
- Hyrja e shoqëruesve dhe/ose e familjarëve të pacientëve në ambientet e shërbimit spitalor (përfshi urgjencën), me përjashtim të rasteve kur një kërkesë e tillë vjen nga drejtoria spitalore, dënohen me gjobë në masën 500 000 (pesëqind mijë).
- Dënohet me gjobë në masën 700 000 (shtatëqind mijë) lekë shtetasi, i cili hyn në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe nuk deklaron ardhjen e tij nga zonat e prekura nga infeksioni COVID-19, kur ky shtetas nuk vetëkarantinohet për një periudhë 14-ditore në ambientet e banesës së tij, si dhe shtetasi, i cili ka rezultuar pozitiv dhe nuk zbaton urdhrin e dhënë nga organet kompetente për vetëkarantinimin e detyrueshëm.
- Masa administrative me gjobë apo mbyllje aktiviteti parashikohen për institucionet arsimore, çerdhet dhe kopshtet, subjektet që zhvillojnë aktivitete në ambientet e mbyllura të argëtimit për fëmijë e të rinj,

⁵² Akt normative i Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", botuar me Fletoren Zyrtare nr. 37, datë 15 Mars 2020, i aksesueshëm në: <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2020/03/Akti-Normativ-nr.-3-date-15-mars-Per-marrjen-e-masave-te-vecanta-administrative-gjate-kohezgjatjes-se-periudhes-se-infeksionit-te-shkaktuar-nga-COVID-19.pdf>

⁵³ Ligj Nr. 24/2020 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", i aksesueshëm në: <https://www.parlament.al/files/projektligje/20200423110343ligj%20nr.%2024,%20dt.%2016.4.2020.pdf>

palestrat, qendrat 3 sportive, pishinat, qendrat e internetit, subjektet që administrojnë lokale, restorante, bare, subjektet që rrisin çmimet e mallrave apo produkteve përfshi ato të konsumit dhe farmaceutike, subjektet mediatike kur në të njëjtën studio televizive marrin pjesë më shumë se dy persona, etj.

- Drejtuesit e automjeteve të paautorizuar, të cilët nuk zbatojnë ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit, në zonat dhe oraret e përcaktuara nga organet kompetente, dënohen me heqje të lejes së drejtimit për një periudhë trevjeçare dhe me bllokim të mjetit.

❖ Në dt.16 Mars 2020, vetëm një ditë pas miratimit të aktit nr.3, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr.4 me fuqinë e ligjit, i cili bën disa shtesa në aktin normativ nr.3, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga covid-19". Ky akt u miratua nga Kuvendi në të njëjtën datë me dy aktet e mëparshme normative me fuqinë e Ligjit, përkatësisht në dt.16.04.2020, me ligjin nr.25/2020⁵⁴. Me anë të këtij akti, shtohen 3 kundravajtje të reja ndaj individëve si vijon: Pas pikës 16, të nenit 3, të aktit normativ nr.3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohen pikat 17, 18 dhe 19, me këtë përmbajtje:

- Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për ndalimin e lëvizjes për këmbësorët sipas orareve të përcaktuara, dënohen me gjobë në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe me bllokim 3 muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.
- Individët, të cilët nuk zbatojnë urdhrin e dhënë nga organet kompetente për kufizimin e lëvizjeve në parqe dhe zona të gjelbërta të hapura, në zonat urbane, apo mjedise të tjera publike të hapura, dënohen me gjobë në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe me bllokim 3 muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.
- Për individët, të cilët, në kushtet e shkeljeve të pikave 17 dhe 18, të këtij neni, lëvizin me biçikletë, ciklomotor ose motomjet, zbatohet edhe masa shoqëruese e bllokimit të mjetit lëvizës për 3 muaj."

❖ Në dt.24 Mars 2020, Këshilli i Ministrave miratoi aktin normativ nr.8 me fuqinë e ligjit, i cili propozon disa shtesa dhe ndryshime të tjera në aktin normativ nr.3 të cituar më sipër, akt i cili u miratua nga Kuvendi me

⁵⁴ Ligj nr. 25/2020 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 16.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", i aksesueshëm në: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200423110631ligj%20nr.%2025,%20dt.%2016.4.2020.pdf>

ligjin nr.29/2020, po në dt.16.04.2020⁵⁵. Ndër të tjerash, me ndryshimin e bërë përforcohet masa dhe sanksioni i propozuar ndaj individëve që nuk zbatojnë urdhrin e për kufizimin e lëvizjes vetëm në fasha orare të caktuara dhe të pashoqëruar me persona të tjerë në krah, të cilët dënohen me gjobë 10 000 (dhjetë mijë) lekë, si dhe me mos përfitimin nga paketa financiare e solidaritetit dhe bllokim 3 (tre) muaj të automjetit privat, nëse e disponon një të tillë.

Ajo çfarë vihet re te disa prej këtyre akteve, është se ato janë hartuar në një mënyrë të shkurtuar, te përmbledhur dhe pa një pjesë hyrëse apo raporte shpjeguese që i shoqërojnë. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kjo praktikë e ndjekur e bën më të vështirë vlerësimin nëse një kufizim i veçantë i të drejtave përmbush parimet dhe standardet kushtetuese dhe kjo situatë përqësohet kur rregullat ndryshojnë shpesh ose kur qasjet janë ad hoc.⁵⁶

1.1 Respektimi i kriterëve të lidhura me nenin 17 të Kushtetutës

Neni 17 i Kushtetutës vendos disa kushte që duhen respektuar/përmbushur, në mënyrë kumulative, në rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë dhe të drejtën e jetës private:

- kufizimi duhet të bëhet vetëm me ligj;
- për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve;
- kufizimi të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë (parimi i proporcionalitetit);
- të mos cenojë thelbin e së drejtës;
- dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

Togfjalëshi "vetëm me ligj" që përmendet në nenin 17 të Kushtetutës, është bërë objekt interpretimi nga GJK. Sipas jurisprudencës së saj, ky parashikim kushtetues është bërë për të treguar se kufizime të të drejtave kushtetuese nuk mund të vendosen me ndonjë akt tjetër përveç ligjit të miratuar nga Kuvendi⁵⁷.

Parimi i proporcionalitetit në trajtimin doktrinar përfshin tre elementë:

⁵⁵ Ligj Nr. 29/2020 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 24.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.3.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19", të ndryshuar", i aksesueshëm në: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200423105712ligj%20nr.%2029,%20dt.%2016.4.2020.pdf>

⁵⁶ Vendimi nr.11 datë 09.03.2021 i Gjykatës Kushtetuese.

⁵⁷ Shih vendimin 20/2006 të GJK

- Kontrolli kushtetues duhet të vlerësojë nëse masa e ndërmarrë ka qenë e **përshtatshme** për arritjen e objektivit të dëshiruar.
- Duhet të përcaktojë gjithashtu nëse masa e kontestuar ishte e **domosdoshme**, në kuptimin se shteti nuk kishte në dispozicion asnjë mënyrë tjetër më pak kufizuese ndaj lirive individuale.
- Hapi i fundit konsiston në verifikimin nëse masa është faktikisht jopërpjestimore me kufizimin e bërë, ose ajo që quhet proporcionaliteti në kuptimin e ngushtë të fjalës (*stricto sensu*). Pra, çdo kufizim duhet të kalojë të tre testet e proporcionalitetit.

(i) Kriteri i kufizimit me ligj

Në referencë të standartit të vendosur në jurisprudencën e hershme të Gjykatës Kushtetuese, vërehet se dhënia fuqi e mëtejshme ndaj akteve normative me fuqinë e ligjit të nxjerra nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të kompetencës përjashtimore të përcaktuar në nenin 101 të Kushtetutës, përbën një kompetencë të Kuvendit. Kjo kompetencë e Kuvendit konsiston në miratimin nëpërmjet një norme që ka të njëjtat vlera, pra me ligj. Në këtë kuptim, ligji që miraton Kuvendi, duke vlerësuar, formalisht dhe substancialisht, aktin normativ me fuqinë e ligjit, është instrumenti konvertues i të parit si ligj material, në një ligj formal dhe, ky i fundit, nuk mund të jetë veçse ligj i thjeshtë. Gjykata Kushtetuese ka nënvizuar se duhet treguar kujdes i veçantë që ligjet e zakonshme (pra përfshi ato të cilat miratojnë aktet normative), të mos prekin rregullimet që përfshihen natyrshëm në sferën ekskluzive të ligjeve organike që kërkojnë një shumicë të cilësuar me 3/5 e anëtarëve, përndryshe ato do të binin në kundërshtim me nenin 81, pika 2, shkronja "a" të Kushtetutës⁵⁸.

Për sa kohë, aktet normative me fuqinë e ligjit janë miratuar brenda afatit 45 ditë nga Kuvendi i Shqipërisë, ato vlerësohen se përmbushin nga pikëpamja formale, kriterin e kufizimit me ligj të të drejtave dhe lirive të njeriut, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

Gjatë periudhës së pandemisë, rezultojnë se janë nxjerrë edhe një sërë aktesh nënligjore, një prej të cilave është bërë objekt gjykimi në Gjykatën Kushtetuese. Kjo Gjykatë, në vendimin e saj nr.11, të dt.17 Nëntor 2020, teksa ka marrë në shqyrtim kërkesën e Partisë Republikane të Shqipërisë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të urdhrit ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që kufizon lirinë e tubimit⁵⁹, vëren se qasja që kanë ndjekur autoritetet publike në Shqipëri, në marrjen e masave parandaluese ndaj përhapjes së COVID-19, është që në hartimin e masave të posaçme janë mbështetur në një masë të konsiderueshme

⁵⁸ Vendimi nr.5, i vitit 2014 i Gj.Kushtetuese, fq.29

⁵⁹ Nr. 633, datë 17.11.2020

në këshillat e ekspertëve, duke ngritur edhe një Komitet Teknik të posaçëm. Sipas Gjykatës Kushtetuese, kjo qasje, e ndërthurur me kërkesën kushtetuese që kufizimet e të drejtave themelore të kufizohen me ligj, rrezikon të zbehtë rolin thelbësor të Kuvendit në aspektin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, i cili ka rëndësi jetike për shtetin ligjor dhe demokracinë. Po ashtu, për shkak të rëndësisë së situatës së shkaktuar nga pandemia, edhe pritshmëritë e qytetarëve kërkojnë një përfshirje të Kuvendit në një masë më të lartë në rregullimin ligjor të të drejtave të tyre dhe në monitorimin e situatës.

Më tej, GJK vëren se akti i kundërshtuar i Ministrisë së Shëndetësisë është bazuar në ligjin nr. 15/2016, datë 10.03.2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", neni 4 i të cilit parashikon parimet për parandalimin dhe eliminimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive. Gjykata çmon se në kuadrin e masave të veçanta që merren për të mbrojtur popullatën nga sëmundjet infektive, me impakt të madh, kufizimi i së drejtës së tubimit, i lidhur me lirinë e shprehjes, në rastin konkret është i parashikuar në nenin 7 të ligjit nr. 15/2016, në formën e anulimit të grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura. Urdhri nr. 633/2020 ka dalë për të bërë të zbatueshëm këtë dispozitë ligjore dhe, për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk ka shkelje të kriterit të kufizimit "me ligj", sipas nenit 17 të Kushtetutës.

Kjo praktikë e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, vjen në përputhje edhe me praktikën e rekomanduara ndërkombëtare gjatë Periudhës së pandemisë globale. Sipas rekomandimeve të Këshillit të Evropës, "kufizime të të drejtave të njeriut mund të bëhen vetëm me Ligj. "Ligji" në këtë kontekst përfshin jo vetëm aktet e Kuvendit por edhe p.sh. dekretet emergjente të ekzekutivit, me kusht që të mos jenë antikushtetuese."

(i) **Kriteri i proporcionalitetit**

Lidhur me kohëzgjatjen e regjimit të gjendjes së emergjencës dhe masat e emergjencës, Gjykata Kushtetuese në vendimin e mësipërm (nr.5/2020) vëren se termi i përdorur në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë, për kufizimin e lirisë së tubimit dhe grumbullimit "deri në një urdhër të dytë". krijon problematikë pasi së pari, nuk detyron autoritetet përgjegjëse të bëjnë vlerësim periodik për masat kufizuese të përcaktuara me urdhrin në fjalë dhe, së dyti, nuk i përgjigjet standardit të proporcionalitetit. Për këtë arsye, Gjykata vendosi që parashikimi "deri në një urdhër të dytë" duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën, pasi cenon nenin 17 të saj.

Pranë Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë paraqitur disa aplikime (ankesa) ndaj disa vendeve anëtare të KiE-së, lidhur me krizën shëndetësore të shkaktuar nga Covid 19, të cilat vendosin në pikëpyetje disa prej të drejtave konventore dhe në mënyrë të veçantë të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, trajtimit ç'njerëzor dhe degradues, të drejtën për liri dhe siguri, të drejtën për proces të rregullt gjyqësor, të drejtën për jetë private dhe familjare, lirinë e besimit, lirinë e shprehjes, lirinë e lëvizjes, etj.⁶⁰ Një pjesë e këtyre aplikimeve vijojnë të jenë ende në proces shqyrtimi (janë shpallur të pranueshme GJEDNJ dhe qeverive përkatëse ju janë komunikuar pyetjet), ndërkohë që pjesa tjetër janë shpallur të papranueshme për kritere të lidhura me legjitimitetin.

Sa i takon proporcionalitetit të akteve normative me fuqinë e ligjit të miratuara nga Këshilli i Ministrave dhe më pas edhe Kuvendi, ato nuk janë bërë objekt kundërshtimi në Gjykatën Kushtetuese dhe rrjedhimisht nuk i janë nënshtruar një kontrolli të rreptë të testit të proporcionalitetit. Mgjth, sikurse është theksuar në hyrje të këtij raporti, tërheqin vëmendjen kundravajtjet e reja administrative për mosrespektimin e masave në kushtet e kësaj pandemie, lloji dhe natyra e ashpër e sanksioneve, në kushtet social-ekonomike të vendit tonë, autoritetet përgjegjëse për vendosjen e këtyre sanksioneve, mosparashikimin e së drejtës së ankimit shprehimisht në ligj dhe problematikat e aksesit në drejtësi për të kundërshtuar këto sanksione, të cilat vijnë edhe si rezultat i pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë gjyqësore si dhe mungesës së kuadrit ligjor dhe infrastrukturor për të patur akses në gjykata me mjetet e teknologjisë së informacionit.

Nga ana tjetër, KShH i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me ndryshimet në Kodin Penal, në muajin e parë të pandemisë, të cilat dënojnë penalisht disa forma të mosbindjes së qytetarëve ndaj masave të organeve kompetente shtetërore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ose gjendjes së fatkeqësisë natyrore (neni 242/1) dhe disa forma të shkeljes së rregullave të karantinës për parandalimin e përhapjes së sëmundjeve infektive (242/2). Në vlerësimin e KShH-së, dënimet penale janë jo proporcionale, nuk respektojnë parimin e humanizmit të parashikuar në nenin 1/c të Kodit Penal si dhe cenojnë liritë dhe të drejtat e shtetasve. KShH ka mbajtur qëndrimin se nevoja për ndryshimet në Kodin Penal nuk mund të justifikojnë qëllimin nëse cenohen parime të rëndësishme kushtetuese si parimi i shtetit të së drejtës, ndalimin kushtetues ndaj Kuvendit për të mos miratuar me procedurë të përsheptuar ligje që kërkojnë shumicë të cilësuar si dhe nëse nuk përmbushen në mënyrë kumulative kriteret e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

⁶⁰ https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Covid_ENG.pdf

KREU 2

REZULTATET E BAROMETRIT KOMBËTAR TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, GJATË PERIUdhës SË PANDEMISË COVID-19

2.1. Të dhëna të përgjithshme të anketimit

Popullata e synuar për të grumbulluar informacion përfshiu çdo individ mbi 18 vjeç. Për të grumbulluar informacion sa më të gjerë në shtrirje gjeografike në vend (gjithashtu edhe raportin urban dhe rural) u zhvillua një studim paraprak mbështetur në shifrat e popullsisë mbi 18 vjeç për çdo qark. Përdorimi i një kampioni të ponderuar përfaqësimi kombëtar na bën të mundur që gjetjet t'i aplikojmë për të gjithë popullsinë në vend. Duke ruajtur një nivel besueshmërie mbi 95% dhe marzh gabimi 2.63% u vlerësuan vëllimet e zgjedhjeve si në tabelën 1 dhe në përfundim u pasqyruan edhe arritjet për secilin qark. Për të përcaktuar madhësinë e kuotës së secilit prej qarqeve të vendit, numri i banorëve për secilin qark në 1 janar 2021 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

Si rrjedhim, niveli i rëndësisë statistikore të kampionit përshkruhet si vijon: për një popullatë shqiptare rezidente në moshë madhore prej 2261529 banorë, me një madhësi kampioni prej 891 të anketuarve, për një nivel besimi 95% dhe marzh gabimi 2.63%.

Figura 1. Përfaqësimi sipas qarqeve






Figura 2. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve

Në pyetësor u përfshinë 891 individë nga të cilët 63% i përkasin gjinisë femërore dhe 34% gjinisë mashkullore, 3% preferojnë të mos japin këtë informacion. Qarku më i përfaqësuar është Tirana me 37.71% të anketuarve. Pas saj vijnë Fier (11.78%), Elbasan (11.9%), Durrës me 12.01% dhe Shkodër (7.52%), Korçë (8.19%) dhe zonat e tjera me më pak se 3.5%.

Figura 3. Përfaqësimi rajonal i të anketuarve sipas zonës

Përfaqësimi rajonal i të anketuarve qëndron në raportin 72% për zonën urbane dhe 28% për zonën rurale (Figura 3). Referuar shpërndarjes së kampionimit në çdo qark sipas rajonit (urban apo rural) vihet re se për pjesën më të madhe të qarqeve, përfaqësimi i banuesve të zonave urbane është më i lartë. Veçanti përbëjnë qarqet e Beratit dhe Lezhës ku përfaqësimin më të lartë e ka zona rurale (Figura 4).


Figura 4. Përfaqësimi rajonal i të anketuarve sipas qarkut



Grupmosha


Në pyetësor iu kushtua vëmendje përfaqësimit të të gjithë grupmoshave (Figura 5.a). Përfaqësinë më të lartë e kanë grupmoshat 18-25 vjeç (38.4%) dhe 26-35 vjeç (27.6%) të cilat përbëjnë pothuajse 70% të të intervistuarve. Grupmoshat mbi 60 vjeç përbëjnë përafërsisht 5% të individëve të intervistuar. Shpërndarja e grupmoshave në zona urbane dhe rurale ruan të njëjtën përfaqësim për grupmoshat e reja. Ky raport qëndron gjithashtu i njëjtë edhe sipas gjinisë femër-mashkull (Figura 5.b).

Figura 5. Përfaqësimi i të anketuarve sipas grupmoshave dhe gjinisë




Informacioni mbi arsimimin e personave të intervistuar tregoi se përfaqësimi më i lartë ishte nga individë të arsimit të mesëm të lartë (gjimnaz) dhe arsimit të lartë. Kjo sjellje u vu re edhe në të dyja gjinitë (Figura 6).

Figura 6. Përfaqësimi i të anketuarve sipas grupmoshave dhe gjinisë



Referuar informacionit mbi situatën e tyre të punësimit gjatë kësaj periudhe rezulton se përafërsisht 28.88% janë të punësuar në sektorin privat, 24.16% në sektorin shtetëror, 22.36% janë studentë 16.18% të papunë dhe 8.43% të vetëpunësuar. Për gjininë femërore dhe mashkullore u vu re e njëjta shpërndarje përsa i përket punësimit në sektorët shtetëror dhe privat, ndërsa përsa i përket vetëpunësimit kjo përqindje ishte më e lartë tek gjinia mashkullore. Për përfaqësimin e studentëve në këtë pyetësor gjinia femërore ka një përfaqësim më të lartë (24.6%) krahasuar me gjininë mashkullore (18.9%) (Figura 7).


Figura 7. Përfaqësimi i punësimit të anketuarve sipas grupmoshave dhe gjinisë



Gjatë periudhës së shqyrtuar mars 2020- dhjetor 2021, 40.85% e të anketuarve kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 dhe 35.02% jo, ndërsa 24.13% nuk kishin dijeni pasi nuk ishin testuar. Grupmosha e cila ka rezultuar në më shumë se 50% pozitive me COVID-19 gjatë periudhës në shqyrtim është grupmosha 61-64 vjeç. Grupmosha që ka përqindjen më të lartë të personave që nuk janë në dijeni sepse nuk janë testuar është grupmosha 18-25 vjeç (Figura 8.a).

Midis gjinisë femërore dhe mashkullore raporti i individëve që rezultuan me COVID-19 gjatë periudhës në shqyrtim është më i lartë në gjininë femërore se ajo mashkullore. Përafërsisht 43.93 % e gjinisë femërore kanë rezultuar të prekur me COVID-19 ndërsa tek gjinia mashkullore kjo përqindje është 34.77% e tyre. Pjesa tjetër pohon se nuk është prekur nga COVID-19 gjatë kësaj periudhe ose nuk është testuar (Figura 8.b).

Figura 8. Përfaqësimi i të anketuarve sipas grupmoshave dhe gjinisë mbi pyetjen nëse kanë rezultuar pozitivë me COVID-19



Duke iu referuar shpërndarjes së individëve sipas grupmoshave të pyetur nëse kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 gjatë periudhës në shqyrtim tabela 1.a paraqet në përqindje përgjigjet e tyre duke iu referuar çdo grupmoshe. Grupmosha 18-25 vjeç e cila përfaqëson 38.4% të të anketuarve ka 12.23% që kanë pranuar të kenë qenë prekur nga COVID-19, 14.7% që nuk janë prekur nga COVID-19 dhe 11.45% që nuk kanë qenë në dijeni të këtij fakti pasi nuk i janë nënshtruar testeve informuese (Tabela 1.a). Kjo grup moshë përbën përfaqësimin më të lartë të kampionimit.

Tabela 1.a Shpërndarja e numrit të kampionimit sipas grup moshave dhe rezultatit pozitiv me COVID-19


Grup mosha	Jo	Nuk jam në dijeni për shkak se nuk jam testuar	Po	Gjithsej
18-25 vjeç	14.70%	11.45%	12.23%	38.38%
26-35 vjeç	9.32%	6.40%	11.90%	27.61%
36-45 vjeç	5.05%	2.58%	7.41%	15.04%
46-55 vjeç	2.69%	1.68%	4.38%	8.75%
56-60 vjeç	1.68%	0.79%	2.81%	5.27%
61-64 vjeç	0.56%	0.56%	1.46%	2.58%
Mbi 65 vjeç	1.01%	0.67%	0.67%	2.36%
Gjithsej	35.02%	24.13%	40.85%	100.00%

Tabela 1.b Shpërndarja e numrit të kampionimit sipas grupmohave dhe rezultatit pozitiv me COVID-19

Gjinia	Jo	Nuk jam në dijeni për shkak se nuk jam testuar	Po
Femër	34.46%	21.61%	43.93%
Mashkull	34.44%	30.79%	34.77%
Preferoj të mos e them	53.57%	0.00%	46.43%

Pyetjes nëse kanë qenë pjesë e kategorisë që i janë nënshtruar kufizimeve të lëvizjes dhe karantinës së detyrueshme gjatë periudhës së COVID-19 (duke përfshirë periudhën e kufizimit total të lëvizjes) 46% i janë përgjigjur pozitivisht dhe 53% negativisht. Nga personat që konfirmuan se kanë qenë pjesë e kategorive që i janë nënshtruar kufizimeve të lëvizjes dhe karantinës së detyrueshme (46%), rezultoi se përafërsisht 78.7% e tyre kanë qenë të prekur nga COVID-19 dhe si pasojë kanë ndjekur rregullat për karantinimin dhe lëvizje të kufizuara, ndërsa përafërsisht 20.02% e tyre kanë qenë subjekt i riadhesimit. Pjesa tjetër kanë patur familjarë të sëmurë me COVID-19 (kjo përqindje është shumë e vogël krahasuar me dy të parat vetëm 1.1%) (Figura 9).

Figura 9. Përfaqësimi i të anketuarve që i janë nënshtruar kufizimeve të lëvizjes dhe karantinës së detyrueshme



2.2. E drejta për informim

E drejta për informim është një ndër të drejtat e cila ka pësuar një impakt të madh gjatë kufizimeve të vendosura në sajë të pandemisë globale COVID-19. Kjo e drejtë, e cila parashikohet nga neni 10 i KEDNJ, nuk bën pjesë në të drejtat nga të cilat u derogua gjatë kufizimeve të vendosura gjatë pandemisë, e megjithatë impakti i pandemisë mbi të ka qenë i konsiderueshëm.

Neni 23 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se “e drejta e informimit është e garantuar” dhe se “kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.”


Gjithashtu, e drejta për informim parashikohet edhe nga neni 3 i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.

Mjetet kryesore nëpërmjet të cilëve të anketuarit janë informuar gjatë periudhës objekt monitorimi/anketimi lidhur me situatën e shkaktuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi COVID-19 janë kategorizuar në pesë më kryesoret:

- Npërmjet rrjeteve sociale (Facebook, Twitter, Instagram etj.) (30%);
- Npërmjet medias audio-vizive (TV, Radio, Gazetë) (29%);
- Npërmjet faqeve të internetit të institucioneve përgjegjëse (5%);
- Staf mjekësor (1%)
- Nga burime të alternuara (35%);

Vihet re se burimet e alternuara, rrjete sociale dhe media audio vizive kanë shërbyer si burimi kryesor i informacionit. Të pyetur nëse mendojnë se shteti i ka ofruar në mënyrë pro aktive dhe të vazhdueshme informacion të besueshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm në lidhje me krizën shëndetësore të anketuarit i janë përgjigjur në përafërsisht 43% të pyetjeve “pjesërisht”, 37% “Po”, 11% “Jo” dhe 9% “Nuk e di” (Figura 10.b).

Figura 10. Përfaqësimi i të anketuarve mbi mjetin e informacionit
(a)



Sipas standardeve të Këshillit të Evropës, të publikuara gjatë muajit Prill 2020,⁶¹ çdo kufizim që shtetet anëtare bëjnë në aksesin në informacion zyrtar në kuadër të pandemisë duhet të jetë përjashtimor, proporcional dhe të synojë mbrojtjen e shëndetit publik. Më 13 nëntor 2020, Parlamenti Evropian u bëri thirrje shteteve anëtare t'i ofrojnë qytetarëve informacion gjithëpërfshirës, të përditësuar, të saktë dhe objektiv për shëndetin publik dhe masat e marra për ta mbrojtur atë.⁶²

“Komunikimet zyrtare nuk mund të jenë i vetmi kanal informacioni për pandeminë. Kjo do të çonte në censurë. Gazetarët, mediat, profesionistët e mjekësisë, aktivistët e shoqërisë civile dhe publiku në përgjithësi duhet të jenë në gjendje të kenë akses në informacion dhe të kritikojnë autoritetet dhe shqyrtojnë përgjigjen e tyre ndaj krizës.”⁶³

Sipas të dhënave të përpunuara nga përgjigjet e mbledhura nëpërmjet pyetësorit, pjesa më e madhe e qytetarëve kanë marrë informacion

⁶¹ Këshilli i Europës, “Respecting democracy, rule of law and human rights in the framework of the COVID-19 sanitary crisis: A toolkit for member states”, Prill 2020, e aksesueshme në <https://rm.coe.int/sg-inf-2020-11-respecting-democracy-rule-of-law-and-human-rights-in-th/16809e1f40>

⁶² THE CORONAVIRUS PANDEMIC AND FUNDAMENTAL RIGHTS: A YEAR IN REVIEW (europa.eu)


⁶³ Ensuring the Public's Right to Know in the COVID-19 Pandemic, Maj 2020, e aksesueshme në https://www.article19.org/wp-content/uploads/2020/05/Ensuring-the-Publics-Right-to-Know-in-the-Covid-19-Pandemic_Final-13.05.20.pdf

nëpërmjet burimeve të alternuara, rrjeteve sociale dhe mediave audio vizive. Problematik në këtë rezultat është se pavarësisht detyrimeve ligjore dhe nevojës së shtuar për informacion, masat kufizuese dhe zhvendosja e komunikimeve dhe veprimtarisë së institucioneve online, patën ndikim negativ në ushtrimin e të drejtës për informim. "Kjo ka prekur veçanërisht njerëzit në nevojë që i përkasin grupeve të marxhinalizuara, ata pa akses në internet, dhe grupet e interesit si gazetarët dhe organizatat e shoqërisë civile."⁶⁴

Duke qenë se në ndër burimet kryesore të informimit për qytetarët ka qenë edhe media, akses i të cilës në informacion gjatë kohës së pandemisë ka qenë i limituar, rrjedhimisht i tillë ka qenë dhe informacioni që i është ofruar qytetarëve nga ana e tyre.

Sipas të dhënave të mbledhura nëpërmjet pyetësorit, lidhur me informacionin e marrë mbi shërbimet publike të cilat kanë qenë të pezulluara gjatë periudhës Mars-Qershor 2020, përafërsisht 61% e të pyeturve kanë pohuar se kanë patur këtë informacion, 26% pjesërisht, 8% nuk kanë qenë të informuar dhe pjesa tjetër është përgjigjur nuk e di (Figura 11.a). Lidhur me pyetjen nëse ata janë informuar rregullisht mbi ndryshimet ligjore, aktet dhe urdhërat të cilat kanë qenë subjekt i ndryshimeve në mënyrë periodike përafërsisht 51% e të anketuarve i janë përgjigjur "po", 34% janë përgjigjur "pjesërisht", 8% "jo" dhe 6% nuk e di (Figura 11.b). Përsa i përket pyetjes nëse ky informacion është dhënë nga autoritetet përgjegjëse në kohën e duhur, të anketuarit në përafërsisht 52% të rasteve janë përgjigjur "po", 35% "pjesërisht", 8% "jo" dhe 5% "nuk e di" (Figura 11.c). Në lidhje e mjetet e përdorura për të dhënë informacionin 52% janë përgjigjur "po", 35% "pjesërisht" dhe 8% "jo", pjesa tjetër "nuk e di".

Figura 11. Përfaqësimi i të anketuarve mbi mjetin e informacionit




⁶⁴ <https://faktoje.al/covid-19-pandemia-qe-po-rrit-infektimet-dhe-terrin-informativ/>

Të anketuarit kanë pohuar në 50% të rasteve se nevoja për mjete të tjera alternative për të dhënë informacionin është e nevojshme dhe në 50% të rasteve se nuk është e nevojshme. Lidhur me pyetjen nëse mendojnë se janë marrë masat e nevojshme nga ana e autoriteteve për të siguruar akses në informacion për kategoritë e personave që i përkasin shtresave në nevojë të anketuarit i janë përgjigjur në përafërsisht 37.04% të rasteve “pjesërisht”, 27.5% “po” dhe 16.6% “Jo” (Figura 12.a).

Lidhur me perceptimin nëse qytetarët mendojnë se janë keq informuar në ndonjë rast nga institucionet kompetente lidhur me gjendjen e shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe mënyrën e menaxhimit të kësaj situate nga Qeveria të anketuarit i janë përgjigjur përafërsisht 65.66% të rasteve “Jo”, pra nuk ka patur keqinformim (Figura 12.b). 34.34 % e qytetarëve mendojnë se janë keq informuar dhe kanë konsideruar si burime informacioni keq informuese Rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Twitter etj.) të cilat zënë përafërsisht 20.54% më pas vjen media audio-vizive (televizion, radio etj) në masën 15.15% dhe burime të tjera (familjarë, të afërm etj.) 6.73% (Figura 12.c).

Figura 12. Përfaqësimi i të anketuarve mbi pyetjen nëse mendojnë se janë marrë masat e nevojshme nga ana e autoriteteve për të siguruar akses në informacion për kategoritë e personave që i përkasin shtresave në nevojë(a) (b) keqinformimin në ndonjë rast nga institucionet kompetente (c) burime informacioni keq informuese



Të pyetur nëse mendojnë se mbi gjendjen e shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe mënyrën e menaxhimit të situatës nga Qeveria dhe keqinformimit për këtë nga burime jo-zyrtare 56.12% mendojnë se nuk ka patur keqinformim dhe 43.88% mendojnë të kundërtën (Figura 13.a). Ata që mendojnë se ka patur keqinformim e orientojnë këtë në 29.6% të rasteve drejt rrjeteve sociale, 12.9% medias audio vizive dhe më pak burimeve të tjera si shoqëria apo familja (Figura 13.b). Nuk ka ndonjë dallim midis keqinformimit në zona urbane dhe rurale (Tabela 2)

Figura 13. Përfaqësimi i të anketuarve mbi aksesimin e informacionit dhe keginformimit




Tabela 2 Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi keqinformimin në ndonjë rast nga institucionet kompetente lidhur me gjendjen e shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe mënyrën e menaxhimit të kësaj situate nga Qeveria.

Keqinformim /menaxhim	Zonë rurale(periferi)	Zonë urbane(qytet)	Gjithsej
Jo	64.14%	66.25%	65.66%
Po	35.86%	33.75%	34.34%
Gjithsej	100.00%	100.00%	100.00%

Të pyetur mbi pasojat e keqinformimit, të anketuarit që e kanë pranuar këtë kanë theksuar se keqinformimi ka çuar në shfaqje të ankthit, stresit, frikës, panik, përkeqësim të gjendjes psikologjike, pasiguri etj. Reja e fjalëve që të anketuarit kanë shprehur tregon këto përjetime në shkallët e përmendura në pyetësor.



2.3. Liria e lëvizjes

Liria e lëvizjes parashikohet nga neni 38 i Kushtetutës, i cili parashikon se:


"Kushdo ka të drejtë të zgjedhë vendbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit."

Megjithatë, kjo liri bën pjesë ndër liritë nga të cilat Shqipëria derogoi në kuadër të masave të marra si pasojë e pandemisë Covid-19.

Liria e lëvizjes u kufizua nëpërmjet një sërë aktesh, të cilat konsistojnë kryesisht në kufizimin e lëvizjeve me mjetet e transportit, kufizimin e lëvizjeve brenda vendit, kufizimin e lëvizjes me automjetet private ose shtetërore të administratës publike, lëvizjes përmes rrugëve ajrore, kufizimin e lëvizjeve në zona urbane etj.⁶⁵

Në këtë sesion janë zhvilluar pyetje lidhur me ndikimin e pandemisë Covid-19 në të drejtat dhe liritë themelore, në mënyrë të veçantë me lirinë e lëvizjes. Lidhur me mënyrat kryesore të lëvizjes, gjatë periudhës së kufizimeve të lëvizjes sipas fashave orare, ato janë kategorizuar në tre më kryesoret: mjete private të transportit (automjet, motoçikletë, biçikletë etj.); me këmbë; ose nuk kam lëvizur.

Figura 14. Përfaqësimi i të anketuarve mbi mënyrat kryesore të lëvizjes



⁶⁵ Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.168, datë 12.3.2020 "Për ndalimin / kufizimin e lëvizjeve me mjetet e transportit" <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/12/168/9defec25-be0e-4c7a-98de-96139378aea8>

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.168/1, datë 15.3.2020 Për kufizimin e lëvizjeve brenda vendit <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/15/168-1/a47c4c2a-acbb-4265-8d16-67b8bc868387>


Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.168/2, datë 18.3.2020 Për kufizimin e lëvizjes me automjetet private ose shtetërore të administratës publike <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/18/168-2/749cd3c3-d407-4b22-82e0-8f646c262740>

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.173/1, datë 14.3.2020 Për ndalimin e lëvizjes përmes rrugëve ajrore me Greqinë <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/14/173-1/a00c8ca6-c7db-4791-9368-6095f3e22e51>

Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.177/1, datë 16.3.2020 Për kufizimin e lëvizjes në zonat urbane <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/03/16/177-1/ee66bfc9-936f-4344-805e-272cf9b06db0>

Lidhur me sa të nevojshme dhe proporcionale qytetarët mendojnë se kanë qenë masat e ndërmarra gjatë periudhës Mars 2020-Dhjetor 2021, në 64.4% të rasteve, të anketuarit kanë pohuar se “ndalimi i zhvillimit të aktiviteteve publike ose jopublike si dhe ndalimi i grumbullimeve”, kanë qenë të nevojshme dhe plotësisht të nevojshme. Mbi kufizimin e lëvizjes së shoqëruesve dhe/ose familjarëve të pacientëve në spitale 26.7% kanë pohuar se kjo masë ka qenë e nevojshme dhe 20% pranojnë se masa ka qenë plotësisht e nevojshme. Në 32.5% të rasteve në lidhje me masat për mbylljen e shkollave dhe zhvillimi i mësimit online kanë pohuar se masat kanë qenë “të nevojshme” dhe 19.4% “plotësisht të nevojshme”. Mbi kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve 30.6% kanë pranuar se kjo masë ka qenë e nevojshme dhe 24.2% ka pranuar se ka qenë plotësisht e nevojshme. Mbi kufizimin e lëvizjeve me mjete transporti publik/privat të anketuarit kanë pranuar në 28.6% se masat kanë qenë të nevojshme dhe 22.7% qëndrojnë neutral. Mbi kufizimet e lëvizjeve brenda vendit, 33.8% pranojnë se masat kanë qenë të nevojshme dhe 21.4% pohojnë se masat kanë qenë të panevojshme. Mbi mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve ajrore/tokësore midis Republikës së Shqipërisë dhe shteteve të tjera të anketuarit kanë pohuar në 33.8% të rasteve “Kufizimi i lëvizjeve brenda vendit, ka qenë i nevojshëm” dhe 29.4% “Plotësisht i nevojshëm” (Figura 15).


Figura 15. Përfaqësimi i të anketuarve mbi mënyrat kryesore të lëvizje



Të pyeturit mbi faktin se a janë gjendur në shkelje të fashës orare të lëvizjes, 25% e tyre kanë konfirmuar se po nga të cilët 10% kanë marrë vërejtje, 8% janë toleruar dhe 7% kanë marrë gjobë (Figura 16).


Praktika e ndjekur nga ana e autoriteteve përgjegjëse për dhënien e masave administrative, bazuar në Aktin normativ të Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.", nuk ka qenë e unifikuar dhe në shumicën e rasteve, autoritetet kanë mbajtur një qëndrim tolerues, në kundërshtim me parashikimet e këtij akti normativ.

Figura 16. Përfaqësimi i të anketuarve mbi shkelje të fashës orare të lëvizjes



Midis gjinisë femërore dhe mashkullore raporti i individëve, që nuk janë gjendur në shkelje të fashës orare të lëvizjes, është më i madh tek femrat me afërsisht 52.44% (Figura 17.a). Grup moshë 18-25 vjeç dhe 26-35 vjeç janë ato që kanë përqindjen më të madhe të personave që janë gjendur në shkelje të fashës orare të lëvizjes me përkatësisht 9.76% dhe 8.08% (Figura 17.c). Gjithashtu zonat urbane kanë përqindjen më të madhe të personave që janë gjendur në shkelje të fashës orare 18.29% krahasuar me zonat rurale, me 6.73% të personave (Figura 17.b).

Figura 17. Përfaqësimi i të anketuarve mbi shkelje të fashës orare të lëvizjes sipas gjinisë (a), rajonit (b) dhe grup moshës (c)



Personat e grup moshave 18-25 vjeç, 26-35 vjeç dhe 36-45 vjeç janë ata që kanë përqindjen më të lartë, për marrjen e masën me gjobë në rastet kur janë gjendur në shkelje të fashës orare të lëvizjes. Personat të cilët kanë qenë më të toleruarit (masën 100%) janë ata që i përkasin grupmoshës mbi 65 vjeç (Figura 18.a). Në personat e grup moshës 18-25 vjeç, 30.09% e tyre kanë marrë masën e gjobës dhe 36.28% masën "Tolerancë", ndërsa 33.63% kanë marrë "Vërejtje". Në personat e grup moshës 36-35 vjeç, pjesa më e madhe e tyre kanë marrë masën "Vërejtje", 42.53 dhe 29.28 % masën "Tolerancë".

Përsa i përket masave sipas qarqeve vihet re se përqindjen më të lartë të masave të vendosura me gjobë e ka Qarku i Elbasanit me 60 % të rasteve të identifikuar, ndjekur nga Qarku i Dibrës me 42.86% të rasteve. Qarku i Beratit, Shkodrës dhe Vlorës, nuk kanë vendosur masa me gjobë. Përqindjen më të lartë të vendosur për masën "Tolerancë" e mban Qarku i Lezhës me 66.67% të rasteve, ndjekur nga Qarku i Vlorës me 60% (Figura 18.b). Përqindjen më të lartë të vendosur për masën "Vërejtje" e mban Qarku i Kukësit me 61.54 % të masave të vendosura nga ky qark, në lidhje me rastet kur personat janë gjendur në shkelje të fashës orare të lëvizjes (Tabela 4.a dhe 4.b).


Tabela 4.a Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi shkelje të fashës orare të lëvizjes sipas grup moshës

Moshë	Çfarë qëndrimi kanë mbajtur autoritetet?			
	Gjobë	Tolerancë	Vërejtje	Total
18-25 vjeç	30.09%	36.28%	33.63%	100.00%
26-35 vjeç	27.59%	29.89%	42.53%	100.00%
36-45 vjeç	29.73%	24.32%	45.95%	100.00%
46-55 vjeç	5.00%	30.00%	65.00%	100.00%
56-60 vjeç	7.14%	35.71%	57.14%	100.00%
61-64 vjeç	20.00%	20.00%	60.00%	100.00%
Mbi 65 vjeç	0.00%	100.00%	0.00%	100.00%
Total	25.99%	32.13%	41.88%	100.00%

Tabela 4.b Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi shkelje të fashës orare të lëvizjes sipas qarkut

Qarku në të cilin jeni banues	Çfarë qëndrimi kanë mbajtur autoritetet?			
	Gjobë	Tolerancë	Vërejtje	Total
Qarku i Beratit	0.00%	40.00%	60.00%	100.00%
Qarku i Dibrës	42.86%	28.57%	28.57%	100.00%
Qarku i Durrësit	27.27%	40.91%	31.82%	100.00%
Qarku i Elbasanit	60.00%	13.33%	26.67%	100.00%
Qarku i Fierit	30.77%	19.23%	50.00%	100.00%
Qarku i Korçës	15.38%	26.92%	57.69%	100.00%
Qarku i Kukësit	30.77%	7.69%	61.54%	100.00%
Qarku i Lezhës	33.33%	66.67%	0.00%	100.00%
Qarku i Shkodrës	0.00%	41.67%	58.33%	100.00%
Qarku i Tiranës	19.35%	41.94%	38.71%	100.00%
Qarku i Vlorës	0.00%	60.00%	40.00%	100.00%
Total	25.99%	32.13%	41.88%	100.00%

Figura 18. Përfaqësimi i të anketuarve mbi shkelje të fashës orare të lëvizjes



2.4. Liria për tubim

Liria për tubim parashikohet nga neni 47 i Kushtetutës si dhe rregullohet më tej me një ligj të veçantë.⁶⁶ Kjo e drejtë bënte pjesë në kategorinë e të drejtave të cilat iu nënshtruan kufizimeve, nëpërmjet notës verbale të dërguar nga qeveria shqiptare për derogimin nga KEDNJ. Duke vënë në dukje rëndësinë e respektimit të lirisë së tubimit edhe gjatë kësaj periudhe, në prill të vitit 2020, Reporterit Special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për lirinë e tubimit dhe organizimit u bëri thirrje të gjithë shteteve anëtare që me masat e marra ndaj COVID-19 të mos cenojnë lirinë e tubimit dhe organizimit.⁶⁷ Megjithatë, kjo e drejtë u kufizua nëpërmjet Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, akt i cili ju nënshtrua kontrollit kushtetues nga Gjykata jonë Kushtetuese⁶⁸.

⁶⁶ Ligji Nr.8773/2001 Për Tubimet


⁶⁷ Deklaratë e Reporterit Special të OKB për të drejtën e tubimit dhe organizimit, e aksesueshme

në: <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25792&LangID=E>

⁶⁸ Ky urdher është ankumuar për antikushtetueshmëri përpara Gjykatës Kushtetuese nga subjekti Partia Republikane, e cila ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën i urdhrit nr. 633, datë 17.11.2020 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në vendimin e saj Nr.11 datë 09.03.2021, Paragrafi 70, GJK ka argumentuar se kufizimi nga urdhri i ministrit i së drejtës së tubimit, të lidhur me të drejtën e shprehjes, është i domosdoshëm në një shoqëri demokratike, pasi diktohet nga një nevojë urgjente shoqërore. Megjithatë, Gjykata vlerëson se akti i kundërshtuar nuk respekton kriterin e proporcionalitetit,

Të anketuarit janë pyetur nëse kanë marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së Covid-19, ku një përqindje e madhe e tyre (89%) pohojnë se nuk kanë marrë pjesë në tubime gjatë kësaj periudhe (Figura 19.a). Sa i takon pyetjes nëse anulimi i grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura nëpërmjet Urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.132, datë 8.3.2020, përpara shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore më 24.3.2020, përbën kufizim jo proporcional të kësaj të drejte, 35% e tyre mendojnë se "jo", ndërsa 31% mendojnë "po" dhe 34% nuk kanë dijeni (Figura 19.b). Në lidhje me kufizimet e vendosura mbi lirinë për tubim vihet re se 54% e të pyeturve mendojnë se kufizimet e vendosura kanë qenë të nevojshme e proporcionale, dhe 21% e tyre mendojnë se nuk kanë qenë të nevojshme dhe proporcionale (Figura 19.c).


Figura 19. Përfaqësimi i të anketuarve mbi pjesëmarrje në tubime dhe lirinë e tubimi



Të pyetur mbi pjesëmarrjen në aktivitete (të ndryshme nga tubimet), ku numri i pjesëmarrësve tejkalonte normat e përcaktuara nga aktet ligjore/nënligjore, gjatë situatës së emergjencës, 89% e tyre kanë konfirmuar që nuk kanë marrë pjesë në tubime që tejkalojnë normat e përcaktuara. Ndër personat që kanë marrë pjesë në këto tubime, në 12% të rasteve, nuk është konstatuar ky fakt nga autoritetet përkatëse (Figura 20).

sipas nenit 17 të Kushtetutës, për shkak të mosparashikimit të një afati të përcaktuar për kohëzgjatjen e masave kufizuese dhe për këtë shkak shprehja "gjer në një urdher të dytë" duhet të shfuqizohet.

Figura 20. Përfaqësimi i të anketuarve mbi pjesëmarrje në tubime që tejkalojnë normat e lejuara



Sipas gjinisë vihet re se në të dy gjinitë (femër/mashkull) nuk ka patur një interesim të lartë për të qenë pjesë e tubimeve (përkatësisht, 91.07% e femrave nuk kanë marrë pjesë në tubime dhe 85.1% e meshkujve nuk kanë marrë pjesë në tubime). Tek meshkujt interesi për të marrë pjesë në tubime është më i lartë (14.9%) se tek femrat (8.93%)

Midis grup moshave, raporti i individëve, që kanë marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së pandemisë, është më i lartë në grup moshën 26-35 vjeç, nga personat e kësaj grupmoshe 14.63% e tyre kanë marrë pjesë në tubime (Figura 21.b, Tabela 5.a, 5.b). Ndër personat e pyetur që jetojnë në zonat rurale, 10.36% e tyre janë përgjigjur që kanë marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së pandemisë dhe 89.64% që nuk kanë marrë pjesë. Ndër personat e pyetur që jetojnë në zonat urbane, 11.88% e tyre janë përgjigjur që kanë marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së Covid -19 dhe 88.13% që nuk kanë marrë pjesë.

Në krahasimin midis qarqeve, 70% e të të pyeturve nga Qarku i Kukësit kanë marrë pjesë në tubime, duke e bërë atë qarkun me më tepër pjesëmarrje.

Figura 21. Përfaqësimi i të anketuarve mbi pjesëmarrje në tubime dhe lirinë e tubimit




Tabela 5.a Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi pjesëmarrje në tubime dhe lirinë e tubimit sipas grup moshës

Mosha	A keni marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së Covid -19?		
	Jo	Po	Total
18-25 vjeç	88.30%	11.70%	100.00%
26-35 vjeç	85.37%	14.63%	100.00%
36-45 vjeç	88.81%	11.19%	100.00%
46-55 vjeç	93.59%	6.41%	100.00%
56-60 vjeç	89.36%	10.64%	100.00%
61-64 vjeç	95.65%	4.35%	100.00%
Mbi 65 vjeç	100.00%	0.00%	100.00%
Total	88.55%	11.45%	100.00%

Tabela 5.b Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi pjesëmarrje në tubime dhe lirinë e tubimit sipas zonës

Zona ku ju jetoni mund të identifikohet si	A keni marrë pjesë në tubime gjatë periudhës së Covid -19?		
	Jo	Po	Total
Zonë rurale (qytet)	89.64%	10.36%	100.00%
Zonë urbane (periferi)	88.13%	11.88%	100.00%
Total	88.55%	11.45%	100.00%

2.5. E drejta për kujdes shëndetësor

Neni 55 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti.

Gjithashtu, kjo e drejtë parashikohet nga neni 11 i Kartës Sociale Evropiane, ku vjen si një plotësim i neneve 2 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si dhe është interpretuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut – duke imponuar një varg detyrimesh pozitive për të siguruar ushtrimin efektiv të tij.⁶⁹ Një pjesë e rëndësishme në pyetësor i është kushtuar dhe të drejtës për kujdes shëndetësor. Ndër të anketuarit 51% e tyre kanë pohuar se gjatë periudhës së COVID-19 i janë drejtuar institucioneve shëndetësore publike (Mjeku i familjes, qendrat shëndetësore, ambulancë, spital), 18 % institucioneve shëndetësore private dhe 31% e tyre nuk i janë drejtuar asnjë institucioni shëndetësor. Ndër ata që i janë drejtuar qendrave shëndetësore publike, 55% ju është rekomanduar të qëndrojnë në shtëpi, 37% janë drejtuar pranë institucioneve shëndetësore të posaçme Covid-19 dhe 8% i janë drejtuar pranë institucioneve shëndetësore private. Personat e pyetur, të cilët janë drejtuar pranë institucioneve shëndetësore private në 58% janë përgjigjur se tarifat mjekësore për marrjen e shërbimit, janë bërë pengesë për ta dhe 42% pohuan se tarifat nuk kanë qenë një pengesë.


Vlen të theksohet se në një pjesë të rasteve që i janë drejtuar fillimisht institucioneve shëndetësore publike, ato më tej i kanë këshilluar këto

⁶⁹ DIGEST OF THE CASE LAW OF THE EUROPEAN COMMITTEE OF SOCIAL RIGHTS, e aksesueshme në: <https://rm.coe.int/digest-2018-parts-i-ii-iii-iv-en/1680939f80>

raste t'i drejtohen institucioneve shëndetësore private. Kjo përbën një kufizim të kësaj të drejte, pasi qasja në kujdesin shëndetësor duhet t'i sigurohet të gjithëve pa diskriminim. Grupet me rrezik veçanërisht të lartë si personat e moshuar, të pastrehët, të varfërit, ata që jetojnë në institucione duhet të mbrohen në mënyrë adekuate nga masat e vendosura. Barazia shëndetësore siç përcaktohet nga OBSH duhet të jetë qëllimi: mungesa e dallimeve të shmangshme, të padrejta ose të korrigjueshme midis grupeve të njerëzve, pavarësisht nëse ato grupe përcaktohen socialisht, ekonomikisht, demografikisht ose gjeografikisht ose me mjete të tjera shtresimi. Idealisht, të gjithë duhet të kenë një mundësi të drejtë për të arritur potencialin e tyre të plotë shëndetësor dhe askush nuk duhet të jetë në disavantazh nga arritja e këtij potenciali.⁷⁰

Lidhur me pyetjen a i janë nënshtruar procesit të vaksinimit, 59% e të anketuarve kanë konfirmuar "po", ku 38% e tyre kanë pasur mundësi të zgjedhjes së vaksinës, ndërsa 21% nuk e kanë patur këtë mundësi. Ndër personat që nuk i janë nënshtruar procesit të vaksinimit, (41% e të anketuarve nuk i janë nënshtruar), 22% janë përgjigjur se arsyeja është mungesa e besimit te vaksinat dhe 11% prej mungesës së transparencës dhe informimit lidhur me vaksinat (Figura 22. a). Në lidhje me vaksinimin e detyrueshëm, 74% e të pyeturve pohojnë se nuk është i drejtë dhe 26% që është i drejtë.

Figura 22.a Përfaqësimi i të anketuarve mbi vaksinimin e detyruar, mundësinë e zgjedhjes së vaksinës




Ndër personat që mendojnë se vaksinimi i detyrueshëm është i drejtë, 12% e mendojnë se sektori ku ai duhet të zbatohet, është sektori shëndetësor. Ndërsa 9% mendojnë se të gjithë duhet të nënshtrohen vaksinimit, pavarësisht sektorit ku punojnë (Figura 22.b).

⁷⁰ <https://www.coe.int/en/web/european-social-charter/article-11>

Transparenca, informacioni dhe komunikimi janë thelbësore për të kontribuar në ndërtimin e besimit, duke mundësuar procesin e pëlqimit të informuar dhe duke siguruar që çdo person për të cilin vaksina tregohet se i ofrohet një mundësi e drejtë për të aksesuar vaksinimin. Në këtë kontekst, promovimi i dialogut publik do të ishte i rëndësishëm për të ndihmuar në kuptimin shqetësimeve të qytetarëve në këtë drejtim.⁷¹

Figura 22.b Përfaqësimi i të anketuarve mbi vaksinimin e detyruar, sektori ku duhet të zbatohet



Grupmosha 18-25 vjeç është grupmosha e vetme me një përqindje më të madhe të të pavaksinuarve në krahasim me të vaksinuarit.(Figura 23.a). Në personat e grupmoshës 18-25 vjeç, 57.31 % e tyre nuk i janë nënshtruar procesit të vaksinimit. Në personat e grupmoshës mbi 65 vjeç, 85.71% i janë nënshtruar procesit të vaksinimit. Kjo grup moshë ka dhe përqindjen më të madhe të të vaksinuarve, ndjekur nga grup moshë 56-60 vjeç, me 76.6% të vaksinuar për këtë grup moshë.

Në nivel qarku vihet re se në Qarkun e Dibrës, 78.57% e të pyeturve i janë nënshtruar procesit të vaksinimit. Në Qarkun e Elbasanit, 82.02% e të anketuarve nuk i janë nënshtruar procesit të vaksinimit, ndjekur kjo nga Qarku i Korçës me 53.42%. Këto janë dy qarqet e vetëm ku përqindje e të pa vaksinuarve është më e madhe se ajo e të vaksinuarve (Figura, 23.b).

⁷¹ Covid-19 and vaccines: Ensuring equitable access to vaccination during the current and future pandemics, e aksesueshme në" <https://rm.coe.int/dh-bio-statement-vaccines-e/1680a12785>

Figura 23. Përfaqësimi i të anketuarve mbi vaksinimin sipas grup moshës dhe qarkut





Figura 24. Përfaqësimi i të anketuarve mbi "a keni patur mundësi zgjedhjeje të vaksinës" sipas gjinisë, grup moshës dhe zonës




Të pyetur në lidhje me mundësinë e zgjedhjes së vaksinës, për ata që i janë nënshtruar procesit të vaksinimit, 34.63% e femrave dhe 35.94% e meshkujve janë përgjigjur që nuk kanë patur mundësi zgjedhjeje të vaksinës. Në zonat rurale 66.05% dhe në zonat urbane 63.79% e kanë pasur mundësinë e zgjedhjes së vaksinës (Tabela 6).

Tabela 6 Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi mundësinë e zgjedhjes së vaksinës sipas grup moshës

Nëse po, a keni patur mundësi zgjedhjeje të vaksinës?			
Mosha	Jo	Po	Total
18-25 vjeç	27.81%	72.19%	100.00%
26-35 vjeç	36.09%	63.91%	100.00%
36-45 vjeç	39.80%	60.20%	100.00%
46-55 vjeç	49.12%	50.88%	100.00%
56-60 vjeç	38.46%	61.54%	100.00%
61-64 vjeç	33.33%	66.67%	100.00%
Mbi 65 vjeç	33.33%	66.67%	100.00%
Total	35.56%	64.44%	100.00%


Referuar pyetjes se ku janë drejtuar në rastin kur kanë patur simptoma të ngjashme me ato të Covid-19, 53% e femrave dhe 47% e meshkujve u janë drejtuar Institucioneve të Shëndetit Publik (Mjekut të familjes, QSH, ambulancë, spital). Ndër personat e pyetur, që janë përgjigjur se jetojnë në zonat rurale, 51.01% e tyre janë shprehur se i janë drejtuar Institucioneve shëndetësore publike dhe 30.77 % që nuk i janë drejtuar asnjë institucioni. Ndër personat e pyetur, që janë përgjigjur se jetojnë në zonat urbane, 50.97% e tyre janë shprehur se i janë drejtuar Institucioneve shëndetësore publike dhe 30.65 % që nuk i janë drejtuar asnjë institucioni.

Figura 25. Përfaqësimi i të anketuarve sipas gjinisë, grup moshës dhe zonës mbi institucionet që janë drejtuar nëse kanë patur simptoma të COVID-19



Vetëm 18% e të anketuarve, që i përkasin kategorisë së personave të mjekuar në shtëpi, mendojnë se shërbimet shëndetësore kanë qenë të përballueshme për të gjithë, pa diskriminim, duke përfshirë grupet e marginalizuara. Personat të cilët janë mjekuar në shtëpi, 78.6% e tyre mendojnë se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme duke patur parasysh nivelin ekonomik të të ardhurave (Figura 26).

Figura 26. Përfaqësimi i të anketuarve mbi shërbimet shëndetësore dhe përballimin e tyre



Personat që janë mjekuar në shtëpi, 30.06% e të të pyeturve janë mjekuar në shtëpi, në pjesën më të madhe mendojnë se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme duke patur parasysh nivelin ekonomik të të ardhurave. Personat që i përkasin zonave rurale në 76.5% konfirmojnë se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme, ndërsa në zonat urbane kjo përqindje është 79.4% e zonës urbane.

Personat që i përkasin zonave rurale në 76.5% konfirmojnë se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme, ndërsa në zonat urbane kjo përqindje është 79.4% e zonës urbane.

Të gjithë personat e pyetur, të cilët i përkasin grup moshës mbi 65 vjeç, kanë pohuar se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme duke patur parasysh nivelin ekonomik të të ardhurave. Pjesa më e madhe e personave, për çdo grupmoshë, mendojnë se mjekimet e nevojshme kanë qenë të papërballueshme duke patur parasysh nivelin ekonomik të të ardhurave (Figura 27).

Figura 27. Përfaqësimi i të anketuarve sipas grup moshës dhe zonës mbi përballimin e mjekimeve





Tabela 7 Shpërndarja e numrit të kampionimit mbi përballimin e mjekimeve për personat e mjekuar në shtëpi

Lidhur me personat që janë mjekuar në shtëpi, a mendoni se mjekimet e nevojshme kanë qenë të përbalueshme duke patur parasysh nivelin ekonomik të të ardhurave?			
Mosha	Jo	Po	Total
18-25 vjeç	76.02%	23.98%	100.00%
26-35 vjeç	78.86%	21.14%	100.00%
36-45 vjeç	76.12%	23.88%	100.00%
46-55 vjeç	88.46%	11.54%	100.00%
56-60 vjeç	78.72%	21.28%	100.00%
61-64 vjeç	73.91%	26.09%	100.00%
Mbi 65 vjeç	100.00%	0.00%	100.00%
Total	78.56%	21.44%	100.00%

2.6. Liritë ekonomiko-sociale

Të anketuarit u pyetën mbi perceptimet e tyre në lidhje me liritë ekonomike- sociale dhe 61% e tyre u shprehën se kufizimet e vendosura (mbyllja e përkohshme e aktiviteteve, kufizimi i lëvizjeve etj.) gjatë periudhës së shqyrtuar kanë ndikuar negativisht në mirëqenien e tyre ekonomike ndërsa 39% pohuan se nuk kanë ndikuar. Ky perceptim qëndron në raporte të barabarta në zonat rurale dhe urbane, ndërsa referuar qarqeve vihet re se qarku i Dibrës, Fierit, Lezhës, Shkodrës e Vlorës janë qarqet të cilat kanë pohuar më tepër se qarqet e tjera se këto kufizime kanë ndikuar tek mirëqenia e tyre ekonomike. Për qarkun e Kukësit vlen të dallohet se 60% kanë pohuar se kufizimet nuk kanë ndikuar tek mirëqenia e tyre ekonomike. (Figura 28).


Figura 28. Përfaqësimi i të anketuarve mbi ndikimin e masave në mirëqenien ekonomike sipas qarqeve dhe rajonit



Mbyllja e aktiviteteve dhe realizimi i punës online ka ndikuar në efektivitetin e individëve të anketuar në 64% të rasteve, 14% nuk janë prekur dhe 22% janë përgjigjur “nuk e di”. Në zonat urbane 62% e të anketuarve janë përgjigjur se mbyllja e aktivitetit dhe kalimi në alternativën online ka ndikuar në efektivitetin e tyre, për zonat rurale kjo përqindje është 68%. Pra, vihet re një përfaqësim pothuajse i njëjtë në të dy zonat. Qarqet në të cilat është ndjerë më shumë ky efekt janë qarku i Vlorës (92%), Durrësit (76.64%), Lezhës (75%), Kukësit (70%) dhe Tiranës (69%). Në qarkun e Elbasanit dhe të Shkodrës vihet re një përqindje e konsiderueshme e personave të cilët janë neutral (përgjigjur “nuk e di”) në lidhje me këtë perceptim. Qarku i Kukësit ka një përfaqësim prej 70% që


pranojnë se mbyllja e aktivitetit dhe realizimi i punës online nuk ka ndikuar në efektivitetin e tyre (Figura 29).

Figura 29. Përfaqësimi i të anketuarve mbi ndikimin e masave në mirëqenien ekonomike sipas qarqeve dhe rajonit



Ajo që vihet re është fakti se në përgjithësi (përfshi zonat rurale apo urbane) të anketuarit pranojnë se janë detyruar nga punëdhënësi të paraqiten në punë në masën respektivisht 16.3% dhe 18.4%. Përafërsisht për zonat rurale 38.3% dhe zonat urbane 36.1% e të anketuarve nuk kanë qenë të punësuar gjatë kësaj periudhë. Përafërsisht 45.4% për zonat rurale dhe 45.5% për zonat urbane nuk janë detyruar nga punëdhënësi të paraqiten në punë gjatë periudhës Mars-Qershor 2020 (Figura 30).


Figura 30. Përfaqësimi i të anketuarve mbi detyrimet nga punëdhënësi për t'u paraqitur në punë sa i takon zonës.



Gjatë periudhës së karantinës 41.1% e të anketuarve pohojnë se pagesa e tyre


ka qenë e njëjtë, 40.7% nuk kanë qenë të punësuar gjatë periudhës në shqyrtim, 9.4% kanë pohuar se paga e tyre është reduktuar dhe përafërsisht 4.8% kanë hasur vonesa në pagesat nga punëdhënësi dhe 5% kanë dhënë arsye të tjera ndër të cilat mbyllje e aktivitetit personal (Figura 31).

Figura 31. Përfaqësimi i të anketuarve mbi detyrimet nga punëdhënësi për t'u paraqitur në punë në raport me pagën.



Në lidhje me ndërprerjen e veprimtarisë së sektorit ku kanë qenë të punësuar gjatë periudhës së studimit të anketuarit i janë përgjigjur "Po" në masën 12.01%), "Jo" në masën 28.28%, 21.1% i janë përgjigjur "është ndërprerë përkohësisht" dhe 38.5% i janë përgjigjur se nuk kanë qenë të punësuar gjatë kësaj periudhe. Ajo që vihet re është fakti se nuk ka dallime të dukshme midis zonave urbane dhe rurale që lidhen me këtë çështje (Figura 32).

Figura 32. Përfaqësimi i të anketuarve ndërprerjen e veprimtarisë së sektorit ku kanë qenë të punësuar



Nëse veprimtaria e sektorit në të cilin kanë qenë të punësuar është ndërprerë përkohësisht të anketuarit pohojnë në 65% të rasteve se janë marrë masa për të garantuar shëndetin dhe sigurinë në punë duke përfshirë edhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme mbrojtëse. Ndërsa në rastet kur veprimtaria nuk është ndërprerë vihet re një përqindje më e ulët (52%) (Figura 33)

Figura 33. Përfaqësimi i të anketuarve mbi masat e marra për të garantuar shëndetin dhe sigurinë në punë.



33% e të anketuarve vlerësojnë se janë marrë masa për të mbrojtur vendet e punës, pensionet dhe përfitimet e tjera shëndetësore dhe sociale të punëtorëve gjatë pandemisë, duke përfshirë punëtorët e vetëpunësuar, punëtorët në forma jo tradicionale të punësimit si dhe punëtorët në ekonominë informale, ndërsa 27% mendojnë se nuk janë marrë masa dhe 40% nuk kanë informacion (Figura 34).

Figura 34. Përfaqësimi i të anketuarve masat për të mbrojtur vendet e punës, pensionet dhe përfitimet shëndetësore/sociale të punëtorëve



33% e të anketuarve vlerësojnë se janë marrë masa për të mbrojtur vendet e punës, pensionet dhe përfitimet e tjera shëndetësore dhe sociale të punëtorëve gjatë pandemisë, duke përfshirë punëtorët e vetëpunësuar, punëtorët në forma jotradicionale të punësimit si dhe punëtorët në ekonominë informale, ndërsa 27% mendojnë se nuk janë marrë masa dhe 40% nuk kanë informacion.

KREU 3

MONITORIMI TEMATIK I INSTITUCIONEVE TË NGARKUARA ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT ANTI-COVID

Gjatë muajit Gusht 2021, vëzhgues të KShH-së realizuan misione verifikimi në terren pranë institucioneve vendore të policisë dhe kujdesit shëndetësor publik në Qarkun e Korçës, Elbasanit dhe Durrësit lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut gjatë pandemisë COVID-19. Gjatë verifikimeve u morën takime me drejtuesit e këtyre institucioneve.

Duke qenë se informacioni dhe dokumentacioni zyrtar i vendosur në dispozicion prej tyre ishte jo i plotë, duke pamundësuar arritjen e konkluzioneve të qarta nga këto monitorime, KShH ju drejtua këtyre institucioneve me shkresa zyrtare bazuar në ligjin nr.119/2014 për të drejtën e informimit. Objekt i kërkesave për informacion shtrihej përgjatë periudhës Mars 2020-Dhjetor 2021, me fokus zbatimin e kuadrit ligjor nga këto institucione për sa i takon masave anti-covid dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve.

3.1. Monitorimi i Strukturave Vendore të Policisë së Shtetit

3.1.1 Drejtoritë Vendore të Policisë

- *Publikimi i akteve normative dhe nënligjore, kriter i detyrueshëm, por jo gjithmonë i zbatuar gjatë pandemisë*

Publikimi i akteve normative që kufizojnë liritë e qytetarëve duhet të bëhet në mënyrë të saktë, edhe gjatë periudhës së pandemisë, si një kusht që të respektohet parimi i sigurisë juridike dhe qytetarët të parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vërejtur në Dhjetor të vitit 2021, se Urdhëri nr. 237 datë 27.05.2021 i Ministrit të Brendshëm i cili përcaktonte kufizimet e orarit të muzikës, nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare. Rrjedhimisht, ky urdhër nuk ka fuqi ligjore sepse referuar nenit 117 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, aktet nënligjore normative duhet të botohen në fletoren zyrtare dhe marrin fuqi juridike pas botimit. Në përfundim gjykata vlerësoi se normat me karakter kufizues të përcaktuara në këtë urdhër nuk rezultojnë të kenë qenë “mjaftueshmërisht të qarta” dhe precize me “indikacione të mjaftueshme” sa i takon zbatueshmërisë së këtyre masave me karakter kufizues. Për

rrjedhojë aktet administrative objekt gjykimi (gjobat) të dala në bazë të këtij urdhëri janë të paligjshme dhe në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara nga Kushtetuta dhe KEDNJ.

Në vlerësim të vendimit të gjykatës të sjellë në vëmendje më sipër, është e sugjerueshme, rritja e përgjegjshmërisë në veprimtarinë e institucioneve, në hartimin, publikimin apo edhe zbatimin e akteve normative apo administrative, të cilat sjellin kufizime të lirive dhe të drejtave të njeriut. Zbatimi korrekt i procedurës sjell një "cilësi norme" optimal dhe zbatim të saktë të saj.

- *Liria e Tubimit*

Sa i përket masave të marra nga punonjësit e policisë së shtetit për qytetarët të cilët kanë ushtruar të drejtën e tubimit gjatë kohës së pandemisë, vihet re se praktika e ndjekur nga ana e Drejtorive Vendore të Policisë nuk ka qenë e unifikuar sa i takon zbatimin të kuadrit ligjor që i cakton detyrë këtyre strukturave për marrjen e masave administrative ndaj personave që organizojnë këto aktivitete si dhe subjektet që i kanë lejuar ato.⁷²

Nëpërmjet shkresës kthim-përgjigje⁷³, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, konfirmon se: *"Nga kontrollet e ushtruara në territor dhe informacionet e grumbulluara janë evidentuar aktivitete kryesisht nga subjektet politike dhe fetare... Në të gjitha masat që ka konstatuar, policia ka marrë masa duke ndëshkuar me masë administrative 5.000.000 lekë gjobë disa përfaqësues nga subjekte të ndryshëm politikë dhe një fetare të cilët organizonin aktivitete në kundërshtim me aktin normativ. Njëkohësisht janë ndëshkuar me masën administrative 1.000.000 lekë gjobë edhe pronarët e lokaleve të cilët lejuan zhvillimin e këtyre aktiviteteve".*

Drejtorja Vendore e Policisë Durrës⁷⁴, konfirmon se në 7 raste janë organizuar tubime të paligjshme nga qytetarë apo subjekte politike. Për këto raste, kjo drejtori nuk rezulton të ketë marrë masa administrative por të ketë ndjekur një rrugë tjetër ligjore duke referuar materialet kallëzuese

⁷² Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 633, datë 17.11.2020 Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura, i aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/11/17/633/5c8ca1e2-0838-4488-9f0b-2ecfbc756f45> Akt normativ nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, i aksesueshëm në <https://qbz.gov.al/eli/akt-normativ/2020/03/15/3/333da18e-47fd-4cc7-b38c-562ec56da463>

⁷³ Drejtuar KShH-sw, me prot nr. 1879 datë 02.03.2022.

⁷⁴ Me shkresën nr. 2532 prot. Datë 07.03.2022 drejtuar KShH

në prokurori. Përkatësisht, rezulton se për 5 prej këtyre tubimeve, materialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme", në një rast për veprat penale të parashikuara nga neni 262, 293 dhe 150 të Kodit Penal dhe në një rast tjetër për veprat penale të parashikuar nga neni 262/4, neni 267 dhe 25 të Kodit Penal.

Lidhur me zbatimin e nenit 262 të Kodit Penal "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme", vlen të theksohet se Gjykata Kushtetuese me Vendimin nr. 24, datë 04.55.2021, pranoi kërkesën për gjykim incidental lidhur me antikushtetutshmërinë e normës, të vënë në lëvizje nga Gjykata e Apelit Shkodër.

Kjo Gjykatë, vendosi shfuqizimin e shprehjes "pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta" në paragrafin e parë të nenit 262 të Kodit Penal, si dhe, detyrimin e Kuvendit të plotësojë normën ligjore nga data e shpalljes së vendimit të Gjykatës Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të tij. Gjykata Kushtetuese argumentoi se Kuvendi duhet të rishikojë nenin 262, paragrafi i parë, të KP-së në drejtim të harmonizimit të tij me nenin 47 të Kushtetutës, që garanton lirinë e tubimit paqësor dhe pa armë.

Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton të jetë plotësuar detyra e lënë për organin legjislativ, për plotësime normative të këtij neni të Kodit Penal. Mungesa e një norme të formuluar në mënyrë të qartë e të plotë, konform vendimit të detyrueshëm për zbatim të Gjykatës Kushtetuese, krijon pasiguri juridike tek qytetarët si dhe krijon premisa për cenimin e lirisë së tubimit, për shkak të mënyrës se si kjo dispozitë e paplotë mund të zbatohet nga organet përgjegjëse për kallëzimin, fillimin e procedimit penal, hetimin apo gjykimin e çështjeve penale të lidhura me akuzat për këtë dispozitë.

Gjithashtu janë vërejtur mangësi sa i përket publikimit të akteve normative të Ministrive përgjegjëse, të zbatuara nga institucionet përkatëse e veçanërisht strukturat e Policisë së Shtetit. Neni 117/1 i Kushtetutës, parashikon se "Ligjet, aktet normative të Këshillit të Ministrave, të ministrave, të institucioneve të tjera qendrore marrin fuqi juridike vetëm pasi botohen në Fletoren Zyrtare". KShH ka monitoruar edhe praktikën gjyqësore lidhur me kundërshtimin e sanksioneve administrative të dhëna në zbatim të këtyre akteve normative gjatë pandemisë. Konkretisht:

3.1.2 Monitorimi i Komisariateve të Policisë

KShH ju drejtua me kërkesa zyrtare për informacion, Komisariateve të Policisë Durrës, Korçë, Elbasan dhe Pogradec, për zbatimin e legjislacionit anti-covid dhe vështirësitë e këtyre institucioneve, për periudhën Mars 2020 – Dhjetor 2021⁷⁵. Nga korrespondenca zyrtare me këto institucione, u mundësua dhënia e një informacioni të pjesshëm, çka në disa raste, solli vendosjen në lëvizje të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në analizë të këtij informacioni evidentohet se:

(i) *Vështirësitë institucionale gjatë pandemisë*

Të gjitha Komisariatet e Policisë objekt monitorimi, kanë referuar vështirësitë kryesore me të cilat ato janë përballur gjatë periudhës Mars 2020-Dhjetor 2021, si dhënia e detyrave shtesë për punonjësit e Komisariateve, të cilat kanë passjellë nevojën për punë me orare të zgjatura dhe rritje të ngarkesës në punë. Komisariati i Policisë Durrës dhe Elbasan referojnë se sa i takon orëve shtesë, ato janë shpërblyer, por megjithatë nuk është bërë e mundur dhënia e pushimeve vjetore të miratuara më parë për shkak të ngarkesës në punë. Këto pushime janë shpërblyer në të holla sipas Urdhërit Nr. 3585/4 datë 25.06.2021 të DPPSH. Komisariatet referojnë se nuk ka patur rritje të pagave apo shpërblime për punonjësit e policisë për përballimin e situatës së krijuar.

Sipas nenit 49 pika 2 të Rregullores së Policisë së Shtetit, për të gjithë punonjësit që punojnë në terren duhet të sigurohen kushte pune që sigurojnë mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit, kushtet higjienike, plotësimin e nevojave personale, fizike dhe mundësi për çlodhje. Gjatë periudhës së parë të pandemisë, Komisariatet e Policisë të qytetit Korçë dhe Pogradec referojnë mungesë të mjeteve logjistike sa i takon mjeteve për mbrojtjen e shëndetit (maska, doreza, desinfektantë dhe mjete të tjera mbrojtëse) për shkak të mbylljes së aktiviteteve. Komisariati i Policisë Durrës referon se nuk ka patur mungesa të tilla ndërkohë që, Komisariati i Policisë Elbasan nuk ka dhënë një përgjigje sa i takon kësaj pyetjeje.

(ii) *Organika institucionale*

Sipas Komisariatit të Policisë Durrës, pavarësisht rritjes së ngarkesës në pune, organika institucionale referohet të ketë qenë e mjaftueshme si dhe përveç pagesës për orët shtesë, janë dhënë shpërblime për punë të mire

⁷⁵ Nëpërmjet shkresave me nr. 75, 76, 73 dhe 74 datë 10.02.2022.

në vitin 2020 dhe 2021. E kundërta reflektohet në përgjigjet e Komisariateve të Pogradecit, Korçës dhe Elbasanit, të cilat referojnë se organika institucionale nuk ka qenë tërësisht e mjaftueshme për të përballuar ngarkesën si pasojë e shtimit të detyrave që duhej të kryheshin nga punonjësit në këto institucione. Komisaritet e Policisë Elbasan dhe Korçë referojnë se mangësitë në organikë janë ndjerë më shumë në rastet e punonjësve të cilët kanë qenë me raport shëndetësor për shkak të infektimit me Covid 19 ose kanë patur raste të familjarëve të sëmurë ose të cilët kanë ndërruar jetë.

(iii) *Transporti për punonjësit*

Sa i takon ofrimit të transportit për punonjësit, Komisariati i Policisë Korçë, Pogradec, Elbasan dhe Durrës referojnë se në kushtet e pezullimit të transportit publik, nuk është ofruar asnjë lloj shërbimi për transportin e punonjësve të policisë nga shtëpia në punë. Komisariati i Policisë Korçë referon se ka patur raste të punonjësve të cilëve i është dashur të realizojnë një distancë prej 8 km në këmbë për të mbërritur në punë dhe e anasjellta.

(iv) *Kuadri ligjor në zbatim të të cilit është vepruar gjatë pandemisë*

Të katërta Komisaritet kanë referuar një bazë të gjerë ligjore në të cilën është bazuar puna e tyre përgjatë periudhës Mars 2020-Dhjetor 2021, në të cilat përfshihen akte ligjore e nënligjore, urdhëra e udhëzime, ndër të cilat:

- Akti Normativ nr. 3, datë 15.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19, i ndryshuar",
- Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 615, datë 9.11.2020, "Për kufizimin e aktiviteteve të bareve, restoranteve, fast food dhe lokaleve."
- Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 616, datë 9.11.2020 "Për kufizimin e lëvizjes brenda vendit.",
- Urdhër i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 633, datë 17.11.2020 "Për ndalimin e grumbullimeve në vende të mbyllura apo të hapura."
- Aktet urdhëruese të DPPSH-së si Urdhri nr. 349, datë 17.03.2020 "Për procedurat e konstatimit, evidentimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së

infeksionit të shkaktuar nga Covid-19, Urdhri nr. 324, datë 13.03.2020 "Për verifikimin dhe kontrollin e të gjithë shtetasve shqiptar dhe të huaj rezident në Shqipëri, që kanë hyrë nga republika e Italisë në Republikën e Shqipërisë nga data 27.02.2020 e në vijim.; Udhëri nr. 323, datë 12.03.2020 "Për marrjen me masave të veçanta në pandeminë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga Covid 19 etj.

Në bazë e për zbatim të këtyre akteve, Drejtoria Vendore Policisë Durrës si dhe vetë Komisariati i Policisë Durrës kanë miratuar Urdhëra të ndryshëm⁷⁶, ndërkohë që 3 Komisariatet e tjera nuk kanë referuar një përgjigje sa i takon faktit nëse së brendshmi kanë miratuar akte të brendshme si rregullore, urdhëra, udhëzimi, qarkore, plan kontrolli apo inspektive për t'ju përgjigjur pandemisë.

(v) *Qëndrimi institucional për takimet dhe grumbullimet publike*

Komisariati i Policisë Durrës referon se gjatë periudhës për të cilën është kërkuar informacion, nuk është dhënë leje për realizimin e tubimeve apo grumbullimeve, dhe në rastet kur janë evidentuar grumbullime masive, nga ana e këtij institucioni janë referuar materiale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës.⁷⁷ Një qasje e ngjashme reflektohet edhe nga ana e Komisaritit të Policisë Korçë, i cili referon se në rastet e tubimeve të kryera në kundërshtim me parashikimet ligjore, ka ndërmarrë veprimet procedurale për veprat penale të parashikuara nga nenet 262, 150, 151 dhe 237 të Kodit Penal.

Nga ana tjetër, Komisariati i Policisë Elbasan referon se gjatë fazës së parë të pandemisë, nuk është lejuar që shtetasit të ushtrojnë lirinë e tubimit, në respektim edhe të kufizimeve të vendosura nga institucionet përgjegjëse. Më pas, tubimet janë lejuar në respektim të masave mbrojtëse të referuara nga Komiteti i Ekspertëve. Komisariati i Policisë

⁷⁶ Urdhëri nr.303 datë 17.03.2020 "Për planifikimin e shërbimeve të punonjësve të policisë së DVP dhe komisaritit i policisë Durrës për pika kontrolli në kuadër të marrjes së masave për mospërhapjen e coronavirusit në qytetin e Durrësit dhe më gjerë për datën 18.03.2020", si dhe Urdhëri i Komisaritit të Policisë Durrës nr. 371/1, datë 07.04.2020 "Për kalimin në shërbim të përforcuar me sistem 12 orësh të strukturave në vartësi të DVP Durrës" si dhe urdhëri nr. 729, datë 08.11.2021 "Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative" etj.

⁷⁷ Në 5 raste janë referuar materiale praën prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës sa i takon tubimit të paligjshëm nga një subjekt politik (1 rast), grumbullimit të paligjshëm të shtetasve (3 raste) dhe tubim paqësor pa lejen e autoriteteve kompetente (1 rast).

Pogradec referon se nuk ka patur raste të ushtrimit të lirisë së tubimit në qytetin e Pogradecit por ky institucion ka shmangur një përgjigje të drejtpërdrejtë për pyetjen e bërë, për realizimin e mbikëqyrjes dhe kontrollit të takimeve publike që janë zhvilluar, praktikës së ndjekur dhe dokumentimit të rasteve kur masat anti-covid nuk janë respektuar.

(vi) *Informimi i publikut*

Sa i takon informimit të publikut lidhur me masat anti covid si dhe nëse institucionet vlerësojnë se mjetet e përdorura kanë ofruar informimin e mjaftueshëm të qytetarëve, Komisariati i Policisë Korçë, Pogradec dhe Elbasan referojnë se masat e ndërmarra për informimin e qytetarëve kanë konsistuar kryesisht nëpërmjet televizioneve lokale, takimeve me drejtuesit e institucioneve, rrjeteve sociale, broshurat, takimet ndërgjegjësuere, vendosjes së broshurave nëpër institucione etj. Komisariati i Policisë Durrës nuk rezulton të ketë marrë masa të natyrës ndërgjegjësuere, duke prezumuar se qytetarët kanë qenë të informuar në çdo moment nëpërmjet mediave të ndryshme sa i takon kufizimeve të vendosura sa i takon lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve.

Asnjë nga institucionet nga të cilat është kërkuar informacioni nuk ka ofruar të dhëna nëse vlerësojnë se mjetet e përdorura kanë shërbyer për informim të mjaftueshëm të qytetarëve si dhe nëse mënyra e shpërndarjes së informacionit ka qenë efektive dhe e aksesueshme nga të gjithë qytetarët. Sa i takon komunikimit me shtetas të cilët nuk kanë akses në internet dhe mjete teknologjike, nga ana e institucioneve është referuar se kryesisht është komunikuar verbalisht nëpërmjet vizitave në banesë (në respektim të masave anti-covid) etj. Nga ana e Komisarariatit të Policisë Durrës, referohet se nuk janë marrë masa ndërgjegjësuere/informuese në terren.

(vii) *Shkeljet e evidentuara dhe masat e marra*

Nga komunikimi zyrtar me Komisarariatet vërehet se nuk ka një praktikë të unifikuar për dokumentimin dhe regjistrimin e shkeljeve të lidhura me pandeminë dhe masave të dhëna nga këto organe gjatë periudhës Mars 2020 – Dhjetor 2021. Komisariati i Policisë Durrës dhe ai Pogradec, referojnë se ka një regjistër të veçantë ku regjistrohen këto shkelje, ndërkohë që Komisariati i Policisë Korçë referon që nuk ka një të tillë. Komisariati i Policisë Elbasan referon se masat e dhëna ndaj subjekteve biznese evidentohen në një regjistër të veçantë ndërsa masat e tjera regjistrohen në regjistrat e Sekretarisë së Komisarariatit Elbasan.

Shkeljet administrative tipike të cilat janë konstatuar më shpesh në të katërta komisariatet, kryesisht kanë të bëjnë me mos mbajtjen e maskës, lëvizje pa autorizim përtej orarit të lejuar, mosrespektimi i orarit të mbylljes për baret dhe restorantet. Sa i takon procedurës së ndjekur, dy prej Komisariateve të Policisë, përkatësisht Korçë dhe Durrës, janë vërejtur elementë që krijojnë pikëpyetje për respektimin e të drejtës së procesit të rregullt, pasi mungon dokumentacioni që vërteton marrjen dijeni të këtyre shtetasve për vendimmarrjet dhe për të garantuar prezencën e tyre në mbledhjet e Komisionit.

Më konkretisht:

➤ **Komisariati i Policisë Korçë**

Të dhënat e përcjella evidentojnë se janë dhënë:

- Masa administrative për maska: **3.082**
- Masa administrative për qytetarët të cilët kanë lëvizur pa autorizim pas orës 20:00/23:00: **283**
- Masa administrative për aktivitete biznese lokale: **48**
- Masa administrative për individë "Organizimi i tubimeve": **2**

Sa i takon procedurës së ankimit ndaj këtyre masave, Komisarati i Policisë Korçë i ka bashkëlidhur edhe kopjen e dy praktikave të dokumentacionit, për caktimin e masës së dënimit për kundërvajtjet administrative⁷⁸. Në analizë të vendimit të dt. 20.01.2022 të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë Komisarariatit të Policisë Korçë⁷⁹, i cili ka vendosur dënimin me gjobë në masën 10.000 lekë për shtetasin B.Gj, pasi nuk ka zbatuar udhërin e dhënë nga organet kompetente për ndalimin e lëvizjes për këmbësorët sipas orareve të përcaktuara⁸⁰, vërehet se:

- Në seksionin e posaçëm të vendimit të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, mungon nënshkrimi i qytetarit dhe nuk disponohet asnjë dokument që provon marrjen dijeni të qytetarit mbi këtë procedurë dhe refuzimin e nënshkrimit prej tij.

⁷⁸ Me shkresën nr. 813/1 prot. Datë 17.02.2022 drejtuar KShH-së

⁷⁹ Vendim i cili me shkresën 505 datë 31.01.2022 të Komisarariatit Korçë i dërgohet Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë

⁸⁰ Për shkelje të pikës 17 e nenit 3 të Aktit Normativ nr. 3, datë 15.03.2020

- Pjesë e praktikës është deklarata e qytetarit i cili kërkon ti falet gjoba, por në brendësi të saj nuk ezaurohet asnjëri prej elementëve të mësipërm.
- KShH vlerëson se nënshkrimi i vendimmarrjes vërteton njoftimin e qytetarit për sanksionin dhe është element i rëndësishëm për të mundësuar ankimin efektiv të masës administrative në një organ më të lartë administrativ dhe/ose gjyqësor.

➤ **Komisariati i Policisë Durrës**

Ky Komisariat ka përcjellë 2 praktika të shqyrtuara prej tij të Kundërvajtjeve Administrative. Në vendimin e nr. 683 të datës 08.11.2021, dhe vendimin nr. 759, datë 10.12.2021 të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative pranë Komisaritit të Policisë Durrës, të cilët kanë vendosur respektivisht dënimin me gjobë në masën 1.000.000 lekë për shtetasin Gj.D dhe dënimin me gjobë në masën 10.000 lekë për shtetasin N.M, vërehet se:

- Shtetasit kanë nënshkruar procesverbalin mbi Kundërvajtjen administrative, në të cilin mungon data dhe ora në të cilën do të shqyrtohet kundërvajtja administrative pranë Komisaritit të Policisë Durrës.
- Në Vendimin e Komisionit përgjegjës, nuk reflektohet nënshkrimi për marrjen dijeni të kundërvajtësit mbi këtë vendim si dhe bashkëlidhur praktikës nuk disponohet asnjë dokument i cili të vërtetojë marrjen dijeni të qytetarit mbi zhvillimin e kësaj procedure dhe as shprehjen e vullnetit nga ana e tij për të mos marrë pjesë në të.
- Në të dyja rastet, qytetarët kanë marrë dijeni mbi Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative nëpërmjet njoftimit zyrtar të realizuar disa ditë pas marrjes së vendimit nga Komisioni.

➤ **Komisariati i Policisë Pogradec**

Ky komisariat ka vendosur në dispozicion praktikën e tij të lidhur me vendimmarrjes nr. 35, datë 06.08.2021 të Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative, për vënien e gjobës në masën 1.000.000 lekë ndaj shtetasit M.K. Në ndryshim nga praktikat e mësipërme, evidentohet se në për këtë vendim është marrë dijeni nga shtetasi i cili ka qenë prezent në mbledhjen e Komisionit, tregues pozitiv në drejtim të garantimit të elementëve proceduralë të procesit të rregullt ndaj subjektit ndaj të cilit është vendosur masa.

Ky shtetas ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Drejtorisë Vendore të policisë Korçë, prej nga rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me vendimin nr. 1, datë 26.08.2021, ka konfirmuar gjobën e vendosur, me korrigjimin që masa në fakt duhej dhënë ndaj personit fizik (subjektit) dhe jo shtetasit M.K, edhe pse ky shtetas është përfaqësuesi i subjektit ndaj të cilit duhej dhënë gjoba. Vendimi i është komunikuar zyrtarisht ankuesit, duke respektuar parimin e njoftimit, pjesë e së drejtës për proces të rregullt administrativ.

➤ **Komisariati i Policisë Elbasan**

Ky komisiariat nuk ka vendosur në dispozicion KShH-së praktika të dokumentacionit, të masave të dhëna ndaj qytetarëve apo subjekteve.

(viii) Procedura e ndjekur për realizimin e monitorimit/kontrolleve

Sa i takon procedurës së ndjekur gatë monitorimit apo kontrolleve, nga ana e Komisarariatit të Policisë Elbasan është referuar që kjo procedurë është bazuar në Aktin Normativ nr. 3 datë 15.03.2020 si dhe të udhëzimeve e vendimeve të ardhura nga Komiteti Teknik i ekspertëve. Pak a shumë, të njëjtën përgjigje ka sjellë edhe Komisarati i policisë Pogradec dhe ai i Durrësit. Komisarati i Policisë Korçë reflekton një përgjigje më të drejtpërdrejtë në raport me këto dy Komisariate, duke evidentuar se nuk ka patur një procedurë të paracaktuar apo standarte për realizimin e monitorimeve apo kontrolleve ndaj individëve/subjekteve që nuk kanë zbatuar masat anti covid. Kontrollat e subjekteve dhe individëve referohet të kenë qenë të rastësishme dhe jo të planifikuara paraprakisht⁸¹. Në mungesë të një përgjigjeje të plotë nga dy Komisarariatet e përmendura më herët në këtë paragraf, KShH vëren se mungesa e procedurave standarte për verifikimet dhe kontrollet periodike vlen edhe për ta.

(ix) Verifikimi në banesë i shtetasve të infektuar

Lidhur me verifikimin në banesë të personave që rezultonin pozitiv serish vihet re që praktikën e Komisariateve, objekt monitorimi, kanë qenë të ndryshme dhe jo të unifikuara. Asnjë nga institucionet nuk ka vënë në dispozicion të KShH-së praktika dokumentacioni të planeve të kontrollit për këta shtetas, çka vendos në pikëpyetje realizimin e tyre në praktikë.

⁸¹ Në kthim-përgjigjen e këtij institucioni referohet se të gjitha shkeljet e konstatuara kanë qenë flagrante të konstatuara në terren, nëpërmjet denoncimeve të qytetarëve ose nëpërmjet aplikacionit "Komisariati Dixhital".

Komisariati i Policisë Elbasan dhe ai Korçë kanë referuar se verifikimi në banesë bëhej për ata shtetas emrat e të cilëve i viheshin në dispozicion nga ana e institucioneve shëndetësore. Format e verifikimi përfshinin komunikimin me telefon telefonit si dhe verifikim në distancë nga ana e punonjësit të policisë, duke mos patur asnjë kontakt fizik por vetëm kontakt vizual. Nga ana tjetër, Komisariati i Policisë Pogradec referon se ka kryer vizita në banesë për verifikimin e shtetasve që rezultojnë pozitivë. Komisariati i Policisë Durrës nuk ka dhënë detaje mbi këtë pyetje, por ka referuar se pas mbërritjes së listës nga ana e institucioneve shëndetësore janë bërë verifikimet e nevojshme për zbatimin e detyrimit të karantinimit.

(x) *Mbështetja ndaj stafit të institucionit me trajnime dhe materiale ndërgjegjësuese*

Një nga çështjet objekt monitorimi ka qenë edhe trajnimi dhe mbështetja ndaj stafit të Komisariateve me materiale ndërgjegjësuese nga institucionet qendrore, për zbatimin e legjislacionit dhe përshtatjen e stafit për zbatimin e këtij kuadri ligjor në kushtet e pandemisë. Komisariati i Policisë Elbasan referon se punonjësit e policisë janë trajnuar nga punonjësit e institucioneve të shëndetit publik, për masat që duhet të marrin gjatë kryerjes së punës së tyre për tu mbrojtur nga Covid 19. Ndërkohë, Komisaritet e Policisë Durrës, Pogradec dhe Korçë referojnë se nuk kanë patur ndonjë trajnim të posaçëm, por janë informuar me anë të medias, rrjeteve sociale si dhe janë orientuar me aktet nënligjore që kanë përcjellë institucionet qendrore.

(xi) *Bashkëpunimi me organet e tjera publike*

Pyetjes se si ka qenë bashkëpunimi me institucionet e tjera gjatë periudhës së pandemisë, Komisariati i Policisë Pogradec ka përcjellë një përgjigje të vakët, duke e cilësuar atë si shumë të mirë dhe konform legjislacionit në fuqi. Pak a shumë në të njëjtën linjë është përgjigjur edhe Komisariati i Policisë Durrës, që ka veçuar bashkëpunimin me Bashkinë Durrës, Njësitë Bashkiake, Prefekturë, institucionet arsimore etj. Komisariati i Policisë Elbasan ka përmendur veçanërisht bashkëpunimin me MShMS dhe institucioneve në varësi të saj, ku ka referuar si shembull konkret përcjelljen e listës së shtetasve pozitivë me covid 19 që duheshin verifikuar në banesë.

Komisariati i Policisë Korçë referon në terma më konkrete se bashkëpunimi ka qenë shumë i mirë, duke referuar si shembuj ngritjen dhe funksionimin e grupit Task Forcë nga ana e Prefektit me pjesëmarrjen e institucioneve lokale ku përfshihet Bashkia Korçë, DSHP, Policia e

Shtetit etj, me qëllim monitorimin dhe kontrollin e situatës së respektimit të kufizimeve në fuqi.

(xii) Ankesat e qytetarëve për cilësinë/mungesën e shërbimeve.

Komisariatet e Policisë Pogradec dhe Elbasan nuk kanë ofruar informacion sa i takon pyetjes nëse qytetarët kanë patur ankesa për cilësinë ose mungesën e shërbimeve nga ana e stafit të këtyre institucioneve. Nga ana tjetër, Komisariati i Policisë Durrës ka referuar se nuk ka patur ankesa nga ana e qytetarëve për shkak se angazhimi i policisë përgjatë kësaj periudhe ka qenë në zbatim të procedurave standarte dhe akteve normative. Shmangia e dhënies së informacionit të kërkuar nga KShH, vendos në pikëpyetje faktin nëse e disponon apo jo këtë informacion dhe nëse ka praktika dokumentacioni që bëjnë të mundur identifikimin e numrit të ankesave, objektit të tyre, mënyrës së trajtimit të tyre dhe si i janë përgjigjur qytetarëve ankues këto institucione.

I vetmi institucion që ka ofruar një përgjigje më të plotë ndaj kësaj pyetjeje, është Komisariati i Policisë Korçë, i cili referon ka patur ankesa në rastet e qytetarëve të cilët janë ndëshkuar me masë administrative për shkelje të ndryshme që ata kanë kryer⁸². Ndaj këtyre ankesave është dhënë përgjigje verbalisht në moment, ndërkohë që nëse ka patur ankesa ndaj vendimit të Komisionit për Shqyrtimin e Kundërvajtjeve Administrative, ato janë shqyrtuar më tej nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në Drejtorinë Vendore të Policisë.

3.2 Monitorimi i Strukturave Vendore të Shëndetit Publik

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ju drejtua me kërkesa zyrtare për informacion, Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjVKSh) Durrës, Korçë, Elbasan dhe Pogradec, për zbatimin e legjislacionit anti-covid dhe vështirësitë e këtyre institucioneve, për periudhën Mars 2020 – Dhjetor 2021⁸³. Nga korrespondenca zyrtare me këto institucione, u mundësua dhënia e një informacioni të pjesshëm, çka në disa raste, solli vendosjen në lëvizje të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në analizë të këtij informacioni evidentohet se:

⁸² Në të tilla raste, referohet se nga ana e qytetarëve ka patur pretendime se maskat i kanë në xhep ose e mbajnë në mjekër (në rastet kur janë gjendur pa maskë), se nuk kishin dijeni për orën dhe kufizimet, nuk po shërbenin por po pastronin, nuk i bindën klientët (në rastin e subjekteve të cilat janë gjendur në shkelje të orarit), etj.

⁸³ Përkatesisht me shkresat me nr.prot, respektivisht nr.81, 83, 80 dhe 82, dt. 10 Shkurt 2020.

(i) *Vështirësitë institucionale gjatë pandemisë*

Ngarkesa në punë dhe mungesa e mjeteve të nevojshme logjistike dhe mbrojtëse për t'ju përgjigjur pandemisë, veçanërisht në periudhën fillestare të saj, janë vështirësitë kryesore të ndeshura dhe të referuara prej NJVKSh-ve.

Konkretisht, NJVKSH Korçë referon se është përballur me vështirësi sa i përket ngarkesës në punë të punonjësve (për marrjen e mostrave për Sars-Cov2, hetimin dhe gjurmimin e rasteve, ndjekjen e personave pozitivë, etj), oraret e tejzgjatura si në ditët e punës dhe gjatë ditëve festive/fundjavave, si dhe gjatë Marsit evidentohen si vështirësi mungesa e mjeteve logjistike dhe mbrojtëse. NJVKSh Durrës referon mbingarkesën fizike dhe psikologjike të punonjësve si dhe oraret e zgjatura të punës⁸⁴. Pak a shumë e njëjta përgjigje reflektohet edhe në shkresën zyrtare të përcjellë nga NJVKSH Elbasan, ku elementë të shtuar dhe më të konkretizuar sa i takon vështirësive janë mungesa me veshje mbrojtëse individuale për marrjen e mostrave në terren, pamjaftueshmëria e burimeve njerëzore për të përballuar pandeminë në terren por edhe në raportimet e detyrueshme ditore si dhe në hedhjen e të dhënave në sistemin SISl.

Në ndryshim nga këto institucione, NJVKSh Pogradec nuk përcakton asnjë faktor vështirësie dhe referon se ka përballuar me sukses një nga detyrat, duke e kufizuar rrethin e përgjegjësive në termometrimin dhe plotësimin e skedave për shtetasit që hynë nga pikat doganore Tushemisht dhe Qafë Thanë.

(ii) *Organika institucionale*

NJVKSH Elbasan ka pranuar mungesën e organikës, e cila nuk ka qenë e mjaftueshme në Sektorin e Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor. Pamjaftueshmëria e organikës së Shërbimit të Epidemiologjisë referohet edhe nga NJVKSh Durrës. Teksa pranon ngarkesën në punë dhe oraret e tejzgjatura gjatë ditëve të pushimit, NJVKSH Korçë referon se organika institucionale ka qenë e mjaftueshme për t'ju përgjigjur situatës së pandemisë. Edhe NJVKSh Pogradec e cilëson të mjaftueshme organikën për përmbushjen e detyrave.

Njësitë referojnë se për t'ju përgjigjur ngarkesës, pavarësisht se nuk ka patur shtim page, janë dhënë shpërblime, sipas VKM nr.207,

⁸⁴ Shkresa me nr.prot 152/1, dt.17.02.2022

dt.10.03.2020⁸⁵. Nga ky shpërblim rezultojnë se kanë përfituar vetëm personeli i angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga Covid 19, në pozicionet mjek epidemiolog apo ndihmës/epidemiolog, laborant, personel mbështetës (shofer).

(iii) *Transporti për punonjësit*

Korrespondenca me NJVKSh-të evidenton se nuk janë zbatuar në tërësi, politika favorizuese që të lehtësojnë transportin e stafit shëndetësor në varësi të këtyre institucioneve. Në disa raste, përgjigjet janë edhe kontradiktore apo evasive.

Transporti publik për punonjësit e epidemiologjisë në NJVKSH Korçë është garantuar vetëm për marrjen e mostrave në terren, në vatrat si brenda qytetit dhe në zonat rurale, duke nënkuptuar se për punonjësit e shëndetësisë në varësi të kësaj Njësie, nuk është garantuar transport publik dhe nuk janë ofruar masa lehtësuese të tjera të transportit. Gjithashtu, NJVKSH Elbasan pranon se nuk është mundur asnjë shërbim për lehtësimin e transportit nga puna në shtëpi. NJVKSH Durrës referon se lidhur me transportin, stafet e shërbimit shëndetësor janë organizuar mes kolegesh, brenda territorit të qytetit, ndërkohë që për stafin që vinte nga Tirana është siguruar nga Bashkia e Durrësit, një furgon, për një periudhë kohe, pa përcaktuar shtrirjen e saj. NJVKSH Pogradec referon në mënyrë evazive se nuk ka patur problematika në drejtim të transportit dhe se të gjithë punonjësve u sigurohej transport në çdo moment të nevojshëm dhe pa pengesë.

(iv) *Kuadri ligjor në zbatim të të cilit është vepruar gjatë pandemisë*

Të pyetur lidhur me kuadrin ligjor, në zbatim të të cilit është vepruar gjatë pandemisë, jo të gjitha NJVKSh-të kanë qenë mjaftueshëm të orientuara për të cituar aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse. Madje, një pjesë e tyre reflektojnë një qëndrim pasiv në drejtim të përshtatjes dhe miratimit të akteve të brendshme normative që shtjellojnë më tej aktet kuadër të miratuara nga Institucionet e tyre eprore.

NJVKSH Korçë ka referuar si bazë ligjore, ligjin nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", nenin 3, pika 19 të vendimit të Komitetit të Përkohshëm Teknik, nr. prot

⁸⁵ Dhënie shpërblimi për personelin, mjekë, infermierë, dhe punonjës të tjerë"

5005, dt. 09.11.2020 si dhe udhëzimin e Institutit të Shëndetit Publik "Për përfundimin e izolimit për personat e infektuar me Sars Cov 2 si dhe karantinimin e personave të kontaktit". Gjithashtu, referohen se janë zbatuar të gjitha aktet normative, rregullore, urdhëra dhe udhëzime të ISHP-së dhe MSHMS-së, ndër të cilash, Udhëzuesi i MSHMS nr.289, dt. 04.05.2020 "Për masat ndaj Covid -19 që duhet të ndërmarrin Institucionet arsimore", për të cilin ngarkohet Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore, Udhëzuesi i miratuar me urdhërin nr.579, dt. 14.10.2020, nga zv.Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Mbi ndjekjen në shtëpi të rasteve me infeksion Covid 19", Udhëzimi i Shtatorit të vitit 2020, i Institutit të Shëndetit Publik për Ndjekjen e rasteve në Institucionet Arsimore, Urdhëri nr. 30, dt.16.03.2020, i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (Drejtoria Qendrore) në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për triazhimin e pacientëve nga mjeku i familjes".

Sektori i Epidemiologjisë në NJVKSH Elbasan referon që është mbështetur në të njëjtin kuadër ligjor si NJVKSH Korçë, ndërkohë që pranon se nuk ka miratuar vetë rregullore, urdhëra, udhëzimi, qarkore, plan kontrolli apo inspektime për t'ju përgjigjur pandemisë. I njëjti konkluzion vlen edhe për NJVKSH Korçë, e cila ka shmangur dhënien e përgjigjes. NJKVSH Durrës ka referuar shkurtimisht si bazë ligjore, ligjin nr.15/2016 si dhe udhëzimet dhe urdhërat e dalë nga ISHP, Komiteti i Ekspertëve dhe MShMS. Përgjigjja më e vakët është ajo e NJKVSh Pogradec, e cila cilëson dy akte në mënyrë jo të plotë, duke mos cilësuar organin që i ka nxjerrë apo miratuar ato.

(v) *Qëndrimi institucional për takimet dhe grumbullimet publike*

Njësitë kanë shmangur përgjigjen për rastet konkrete të takimeve dhe grumbullimeve publike të ndjekura prej tyre, duke krijuar pikëpyetje për mundësinë efektive të mbikëqyrjes së këtyre takimeve dhe dokumentimit të rasteve kur masat anti-covid nuk janë respektuar.

NJVKSH Korçë referon se ka vlerësuar të gjitha takimet publike në takim me ISHSH-në dhe masat anti-covid në masën më të madhe janë respektuar. NJVKSH Elbasan ka shmangur dhënien e kësaj përgjigjeje, duke zhvendosur vëmendjen tek takimet sensibilizuese dhe informuese që janë kryer për masat anticovid në shkolla, fasoneri, dyqane, etj. Pavarësisht se KShH ju drejtua Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale lidhur me këtë përgjigje të

pjesëshme, serish, NJVKSH ka dhënë të njëjtin informacion lidhur me këtë pikë⁸⁶. Mungesë reagimi dhe informacioni lidhur me këtë çështje (objekt monitorimi) vërehet edhe në shkresën zyrtare të NJVKSh Durrës, ndërkohë që NJVKSH Pogradec pohon në mënyrë të përmbledhur se takimet publike ku kanë marrë pjesë shumë qytetarë, janë zhvilluar në respektim të masave anti covid (pa specifikuar datën, vendin kur janë realizuar dhe numrin e qytetarëve përfaqësues).

(vi) *Informimi i publikut*

Informacioni i përcjellë prej NJVKSH-ve është i vakët dhe nuk mundëson konkludimin nëse ka patur një plan të mirëfilltë vizibiliteti që të përcaktojë mënyrat dhe shpeshtinë e informimit dhe komunikimit me qytetarët dhe publikun për pandeminë, shpërndarjen gjeografike, duke përcaktuar edhe sfidat dhe vështirësitë për arritjen e grupeve të caktuara të popullsisë.

NJVKSH Korçe referon se informimi i publikut për masat kundër covid është realizuar me fletëpalosje, broshura, postera me informacione, intervista dhe fushata sensibilizuese në mediat lokale dhe me anë të rrjeteve sociale. Pak a shumë, e njëjta përgjigje jepet edhe nga NJVKSH Elbasan, ku thuhet se informacioni është dhënë me fletëpalosje, në rrugë telefonike dhe me median, ndërkohë që vlerësohet se njerëzit e kanë marrë informacionin e duhur gjatë pandemisë. NJVKSH Durrës referon se informimi i qytetarëve është bërë nga sektori i promocionit si dhe personeli shëndetësor. NJVKSH Pogradec, referon se informimi për masat kundër Covid 19 është realizuar në mënyrë sistematike, me shpërndarje të mjeteve sensibilizuese, biseda me qytetarët në grupe të vogla dhe me anë të rrjeteve sociale apo Televizionet Lokale.

(vii) *Mbështetja ndaj stafit të institucionit me trajnime dhe materiale ndërgjegjësuëse prej institucioneve drejtuese*

Në korrespondencën me NJVKSh-të vërehen përgjigje formale dhe jo të konkretizuara sa i takon asistencës nga institucionet qendrore me trajnime apo materiale ndërgjegjësuëse për punonjësit e këtyre njësive (për mënyrën e përshtatjes së punës së tyre me pandeminë).

NJVKSH Korçe referon se janë realizuar trajnime nga ISHP dhe MSHMS, në nivelin e punonjësve të njësisë si dhe të Spitalit Rajonal Korçë. Kjo përgjigje nuk është ilustruar me shembuj konkret, për të kuptuar objektin

⁸⁶ Shkresa me nr.prot 303, dt. 19.04.2022, dërguar nga NJKVSH Elbasan, në adresë të KSHH-së dhe për dijeni Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

e trajnimeve, tematikat e trajtuara dhe shpeshtësinë e tyre. E njëjta qasje vihet re edhe në përgjigjen e NJVKSH Durrës, e cila referon se janë zhvilluar trajnime të epidemiologëve fillimisht nga ISHP dhe ma pas ky trajnim është realizuar nga vetë kjo Njësi, me mjek apo personel infermier nga çdo QSH dhe në vazhdimësi është shtrirë në të gjithë personelin shëndetësor. Më e plotë është përgjigjja e NJVKSH Elbasan, e cila referon se janë zhvilluar disa trajnime nga ISHP me tematika si menaxhimi i stresit gjatë pandemisë, menaxhimi i trajtimit të rasteve pozitive, përdorimi me korrektësi i mjeteve mbrojtëse, etj. NJVKSH Pogradec referon se kanë qenë pjesë e trajnimeve të vazhdueshme nëpërmjet platformës zoom, por nuk ilustron shembuj konkret se cili organ i ka realizuar këto trajnime, cilat tematika janë trajtuar dhe sa punonjës kanë marrë pjesë.

(viii) Mbivendosjet e Kompetencave me institucionet e tjera

NJVKSH-të Korçë, Elbasan dhe Pogradec referojnë se nuk ka patur mbivendosje të kompetencave të tyre me institucionet e tjera, ndërkohë që NJVKSH Durrës ka shmangur dhënien e një përgjigjeje konkrete në shkresën e saj.

(ix) Bashkëpunimi me organet e tjera publike

Pyetjes se si ka qenë bashkëpunimi me institucionet e tjera gjatë periudhës së pandemisë, NJVKSH-të i janë përgjigjur shkurtimisht, duke mos ilustruar shembuj konkretë të bashkëpunimit, për të kuptuar se në ç' drejtim kanë konsistuar, nivelin e ndërveprimit me këto institucione në situata të caktuara, ndër më të zakonshmet të përballura gjatë pandemisë, dhe cilat janë disa nga vështirësitë e ndeshura.

NJVKSH Korçë ka referuar se është bashkëpunuar me të gjitha institucionet në nivel vendor, si Policia e Shtetit, Drejtoria Arsimore, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), Drejtoria Spitalore për ndjekjen e rasteve pozitive, për kryerjen e karantinës së detyrueshme në rastin e vatrave dhe shpërthimeve të rasteve pozitive. NJVKSH Elbasan referon se ka patur situata ku është dashur bashkëpunim i ngushtë me këto institucione. NJVKSH Durrës referon se bashkëpunimi më i mirë ka qenë me Drejtorinë e Policisë dhe ISHSH, ndërkohë që kësaj liste, NJVKSH Pogradec i ka shtuar edhe punonjësit e Bashkisë.

(x) *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për personat që kanë rezultuar pozitiv me Covid 19*

Pyetjes se si është operuar me vendosjen në dispozicion të të dhënave të personave që kanë rezultuar me Covid 19, në ç"formë dhe ndaj cilave institucioneve janë vendosur këto të dhëna, dhe si është realizuar marrja, përpunimi dhe administrimi i tyre, NjVKSh-të i janë përgjigjur pjesërisht, duke reflektuar në raste të caktuara edhe praktika të ndryshme. Mënyra e përcjelljes së tyre, disa herë e papërcaktuar dhe në raste të tjera e kryer me anë të emailit apo shkresave, vendos në pikëpyetje mbrojtjen e të dhënave sensitive të qytetarëve, ndërkohë që nuk dihet nëse këto institucione kanë patur Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI), një detyrim ky sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

NjVKSH Korçë është përgjigjur se këto të dhëna janë ofruar në bazë të Aktit normativ, vetëm për mjekun e familjes që ndiqte anën shëndetësore të pacientëve të prekur, ndaj Policisë së Shtetit për ndjekjen e karantinës dhe izolimit të personave pozitivë, Operatorit Rajonal të Kujdesit Shëndetësor në Elbasan.

NjVKSH Elbasan reflekton një përgjigje të ndryshme në raport me atë të Korçës, duke referuar se për çdo person që ka rezultuar pozitiv sipas vërtetimit përkatës⁸⁷, të dhënat i dërgoheshin mjekësisë familjare, Bashkisë përkatëse, ISHH, ku tërheq vëmendjen mos përmendja e Policisë së Shtetit dhe përse është përfshirë në këtë rreth institucioneve marrëse edhe Bashkia e Qytetit.

NjVKSH Durrës referon se lista e rasteve covid pozitiv, e hartuar nga Shërbimi i Epidemiologjisë⁸⁸ i bëhej me dije NjVKSh-së dhe më pas drejtuesve të QSH, Drejtorisë së Policisë dhe ISHSh-së, të cilëve ju dërgohej me email. Gjithashtu, NjVKSH Pogradec referon se është Sektori i Epidemiologjisë që ka vendosur në dispozicion të gjitha të dhënat e personave të rezultuar pozitivë⁸⁹, të cilët ju janë dërguar në formë elektronike institucioneve përkatëse (pa përcaktuar kujt prej tyre) duke përfshirë edhe numrin e telefonit të pacientit. E njëjta procedurë është vijuar edhe me mjekët e familjeve.

⁸⁷ Të lëshuar nga shefja e Epidemiologjisë dhe të miratuar nga titullari i institucionit.

⁸⁸ Ky shërbim realizonte fillimisht hetimin epidemiologjik, merrte monstra NF dhe më pas analizonte përgjigjen në bazë të Sistemit Informativ të Sëmundjes Infektive (SISI). Hetimi realizohej pas referimit të rasteve për suspect covid nga mjekët e familjes, 127 apo kontakteve me rastet pozitive.

⁸⁹ Marrja e të dhënave është bërë me anë të pyetësorit të pacientëve dhe familjarëve të tyre nga stafi i Epidemiologjisë.

(xi) *Kanalet e komunikimit të qytetarëve që kanë kërkuar ndihmë mjekësore*

Komunikimi i NJVKSh-ve me qytetarët nuk rezulton të jetë realizuar mbi një plan periodik dhe që përcakton qartazi format dhe mënyrat e kontaktit. Përgjigjet e NJVKSH-ve janë të tipologjive të ndryshme dhe në tërësi, kanë një natyrë të përgjithshme. Është tërësisht e paqartë se mbi çfarë kriteresh janë bërë vizitat mjekësore nga mjekët e familjes në shtëpi dhe a ka qenë objektivisht e mundur për ta për t'i realizuar këto vizita. Në këtë drejtim mungojnë të dhënat statistikore por edhe ato cilësore.

NJVKSH Korçë referon se ka ofruar vetëm marrjen e tamponit PCR apo Rapid Test për personat me simptoma apo kontaktet e tyre, në shtëpi, në institucione, në ambientet e NJVKSH-së, duke bërë hetimin, gjurmimin dhe izolimin e rasteve pozitive⁹⁰. Gjithashtu referohet se mjekët e familjes dhe stafet infermierë, në bashkëpunim me Shërbimin Social të Bashkive përkatëse kanë shkuar pranë çdo banori që nuk ka patur mundësi teknologjike komunikimi, duke ofruar asistencën e nevojshme, por në këtë drejtim, nuk ofrohen të dhëna statistikore të kategorizuara, se në sa raste është bërë e mundur kjo gjë. Komunikimi nga NJVKSh Elbasan është realizuar me telefonata apo video telefonata. Në rastet kur ka qenë e nevojshme, mjetet e familjes kanë vizituar nga afër çdo pacient, por pa referuar kriteret mbi të cilat janë realizuar vizitat apo numrin e tyre. Janë ofruar shërbime ambulatorë (injeksione) në banesë apo Qendrën Shëndetësore. NJVKSH Pogradec referon shkurt se komunikimi me qytetarët është realizuar me anë të numrit të urgjencës 127 të vendosur në dispozicion, mjekut të familjes dhe sektorit të Epidemiologjisë, ndërkohë që NJVKSH Durrës i është shmangur dhënies së informacionit lidhur me këtë çështje.

(xii) *Masat e veçanta për komunikimin me shtetasit në nevojë*

KSHH ka kërkuar informacion nga NJVKSH-të se cilat janë masat që janë marrë prej tyre për të komunikuar me njerëzit në nevojë që nuk kanë akses në mjetet e teknologjisë së informacionit apo rrjetet sociale. Në përgjigje të kësaj pyetje, NJVKSh Korçë ka referuar se këta persona janë ndihmuar duke shkuar në vendbanim dhe me anë të komunikimit të drejtpërdrejtë. Përgjigjja e NJVKSh Elbasan është shumë e vakët duke cituar se stafi shëndetësor ka realizuar komunikim ballë për ballë. Për të dyja këto institucione, mungon informacioni lidhur me numrin e këtyre shtetasve, si

⁹⁰ Ka një Sistem të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI), i cili administrohet nga IShP.

janë identifikuar, zonat e vendbanimit, shpeshësinë e komunikimeve me ta, mundësinë objektive të burimeve njerëzore për të patur kontakte të tilla, etj. NjVKSH Durrës i është shmangur dhënies së informacionit lidhur me këtë çështje. E paqartë dhe disi kontradiktore është përgjigjia e NjVKSh Pogradec, e cila referon se për personat që nuk kanë akses në mjetet e teknologjisë së informacionit/komunikimit, janë realizuar kontrole nga infermieri dhe mjeku i zonës që më pas ka komunikuar me sektorin Epidemiologjik. Është e paqartë se ç'forma dhe mënyra janë identifikuar këta shtetas dhe sa e mundur objektivisht ka qenë realizimi i kontaktit me ta, me anë të stafit mjekësor/infermier të NjVKSh Pogradec.

(xiii) Format e ofrimit të shërbimit shëndetësor ndaj shtetasve të infektuar me Covid 19

Në fokus të kërkesës për informacion ka qenë edhe procedura e ndjekur për ofrimin e shërbimit shëndetësor për shtetasit e infektuar me Covid, për rastet e asistencës ambulatorë të dhënë në banesë, nëse janë mbajtur plane që garantojnë ofrimin e kujdesit shëndetësor ndaj familjeve (në banesë ose pranë institucionit), gjatë pandemisë. Përgjigjet e sjella nuk reflektojnë një procedurë të mirëfilltë, lidhur me kategorizimin e rasteve (të lehta apo të rënda), mbajtjen e evidencave statistikore të rasteve të ndjekura në mënyrë ambulatorë, sa ka qenë e mundur që kapacitetet e spitaleve rajonale t'i përgjigjen nevojave për hospitalizimin e shtetasve që kanë shfaqur komplikacione përgjatë periudhës së infektimit, vështirësitë e ndeshura, etj. Të dhënat reflektojnë pikëpyetje mbi kapacitetet e nevojshme për realizimin në praktikë të ofrimit të shërbimit ambulator në banesë.

NjVKSH Korçë ka referuar se personat pozitivë janë ndjekur nga mjeku i familjes në rastet e lehta dhe ata që kanë pasur nevojë për asistencë më të specializuar janë drejtuar në Spitalin Rajonal të Korçës. NjVKSH Elbasan është përgjigjur se janë realizuar vizita në QSH, në ambulancën e specialiteteve dhe në banesën e pacientëve. NjVKSh Pogradec referon se është realizuar marrja e tamponit për të gjitha kategoritë e shtetasve me sëmundje shoqëruese dhe invalid në familje prej Sektorit të Epidemiologjisë. Ndërkohë që, NjVKSH Durrës i është shmangur dhënies së informacionit lidhur me këtë çështje.

(xiv) Fushatat ndërgjegjësuere për vaksinimin, llojin dhe efektet e tyre / Evidencat statistikore për shkallën e vaksinimit

KShH vëren se pavarësisht pohimit deklarativ të NjVKSh-ve, është e paqartë mënyra e realizimit dhe shtrirja gjeografike e fushatës ndërgjegjëse për vaksinat dhe nëse ka patur një plan konkret mbi të cilin është realizuar kjo fushatë. Prej njësive pranohet se janë mbajtur evidenca të përditësuara dhe regjistra të posaçëm nga çdo qendër shëndetësore për vaksinimin, por mungon informacioni për numrin e qytetarëve të cilët kanë zgjedhur vetë llojin e vaksinës dhe cilat janë kriteret që janë ndjekur për zgjedhjen e llojit të vaksinës me dëshirë, me qëllim që shpërndarja të mos realizohet në mënyrë selektive dhe subjektivisht.

NJVKSH Elbasan ka referuar se janë realizuar fushata të shumta ndërgjegjëse për informimin e qytetarëve dhe ofrimin e vaksinimit. Numri i banorëve të këtij qyteti që është vaksinuar me dozat e para, përgjatë periudhës objekt monitorimi është në masën 40%. Kjo njësi referon se janë mbajtur formularë për vaksinim të detyrueshëm të cilat janë hedhur në E-Albania, por pa përcaktuar se mbi cilat kriterë, bazë ligjore dhe në sa raste është aplikuar ky lloj vaksinimi. Kontradiktore është përgjigjja e dhënë që vaksina zgjidhej nga mjeku i familjes, mbi bazën e rekomandimit të tij/saj, sa kohë që larmishmëria e vaksinave është shtuar pas muajve të parë pasi ajo u disponua nga autoritetet shëndetësore shqiptare.

NjVKSH Korçë referon se fushata është realizuar me anë të promocionit derë më derë, në disa qendra vaksinimi gjatë takimeve me grupe të ndryshme të popullsisë, me fletëpalosje, etj. Sa i takon shkallës së vaksinimit në qytetin e Korçës, evidentohet se deri në Dhjetor të vitit 2021 janë vaksinuar 147,330 qytetarë me dozën e parë, 43,833 qytetarë me dozën e dytë dhe 5610 qytetarë me dozën e tretë. Nga ky trend, vërehet re një ulje e ndjeshme e numrit të vaksinuar me dozat e dytë dhe të treta, përkatësisht rreth 30% e personave që janë vaksinuar me dozën e parë, kanë bërë dozën e dytë dhe vetëm 3.8% e kategorisë së shtetasve që kanë marrë dozën e parë janë vaksinuar me dozën e tretë.

NjVKSH Durrës referon se gjatë procesit të vaksinimit janë bërë fushata ndërgjegjëse nga sektori i promocionit si dhe nga personeli shëndetësor në çdo nivel, sipas fushatës që MShMS ka ndërmarrë, aksioni kombëtar “dërë më derë”. Deri në Dhjetor të vitit 2021 rezulton se kanë marrë të paktën një dozë vaksine, 86,330 persona, ndërkohë që mungon informacioni për personat e vaksinuar me dozën e dytë dhe të tretë. Kjo njësi referon se qytetarët kanë aplikuar për llojet e vaksinave që kanë patur në vend, por është e paqartë sa janë përmbushur kërkesat e tyre për

një lloj të caktuar vaksinash dhe si është operuar me kërkesat e qytetarëve që nuk mund të plotësoheshin, bazuar në sasinë e disponuar të vaksinave dhe se cilat janë kriteret për përzgjedhjen e vaksinave për këtë kategori shtetasish.

NjVKSH Pogradec referon se fushata është realizuar me anë të takimeve me komunitetin, biseda derë me derë në qytet dhe fshat, si dhe informim me anë të FB dhe televizioneve lokale. Deri në fund të muajit shkurt 2022, vaksinimi në Pogradec me dozën e parë është në masën 25,278 persona, me dozën e dytë, vihet re një ulje e lehtë me 24,061 vakcina dhe me dozën e tretë, vihet re një ulje e ndjeshme, të cilën e kanë marrë 3,604 Shtetas (ose afro 15% e atyre të vaksinuar me dy dozat e para). Në ato raste kur pa pasur në gjendje më shumë se një lloj vaccine, qytetarët kanë bërë zgjedhjen e vaksinës së aplikuar me dëshirë, por pa përcaktuar ndonjë lloj prioritarizimi në mënyrën e përzgjedhjes së vaksinave dhe kriterëve që bëjnë të mundur shpërndarjen e tyre në mënyrë objektive dhe jo selektive.

(xv) *Masat mbrojtëse dhe inspektimet për respektimin e masave anti-covid në tregje dhe transportin publik*

Korrespondenca e realizuar me NJVKSH-të evidenton mungesë përgjigjeje për realizimin e masave dhe inspektimeve në tregjet e transportin publik, shpesh tësinë dhe rezultatet e këtyre inspektimeve, në një kohë kur nëse ka raportuar në qytete të ndryshme, problematikat për mosrespektimin e distancës dhe maskave mbrojtëse në autobusët e transportit publikë⁹¹.

NjVKSH Durrës i është shmangur dhënies së informacionit lidhur me këtë çështje, ndërkohë që NJVKSH Korçë referon se ka kontrolluar respektimin e masave mbrojtëse nga ana e institucioneve të tjera apo edhe në subjekte private në bashkëpunim me ISHH, por nuk jep një informacion konkret mbi pyetjen lidhur me masat mbrojtëse dhe inspektimet për zbatimin e tyre në tregje dhe transportin publik, nëse janë ndeshur vështirësi për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Të njëjtën përgjigje pak a shumë jep edhe organi homolog në Elbasan, i cili në fakt specifikon masat mbrojtëse si ruajtja e distancës me mbi 1 metër, vendosja e sinjalistikës informuese, përdorimi i maskave, etj. NjVKSh Pogradec pohon se sektori i epidemiologjisë dhe shëndetit mjedisor së bashku me sektorin e kujdesit parësor dhe në bashkëpunim me ISHSh kanë kryer inspektime në tregje

⁹¹ <https://shqiptarja.com/lajm/tregjet-e-autobuset-harrojne-covid-zhduken-tunelet-e-dezinfektimit-dhe-maskat-vezhgimi-i-report-tv?r=kh7>
<https://faktoje.al/transporti-urban-shkel-protokollin-e-covid-19/>

dhe mjetet e transportit publik, por nuk konkretizon asnjë element orientues që bën të mundur vlerësimin e impaktit të këtyre inspektimeve dhe garantimit të zbatimit të zbatimit të masave anti-covid.

(xvi) Ankesat e qytetarëve për cilësinë e shërbimit shëndetësor

Korrespondenca me NjVKSh-të objekt monitorimi evidenton në tërësi një mungesë në sistemin e gjurmimit, dokumentimit dhe trajtimit të ankesave të qytetarëve, për cilësinë apo mjaftueshmërinë e shërbimeve shëndetësore në kushtet e pandemisë. Asnjë prej NjVKSH-ve nuk ka sjellë të dhëna statistikore për numrin e ankesave, grupimin e tyre sipas objektit të tyre (natyrës) dhe si janë trajtuar e dokumentuar ato, cila është përgjigjja që i është kthyer ankuesve pas marrjes në shqyrtim të tyre.

NjVKSH Korçë referon se i gjithë stafi i QSH ka qenë në një situatë alerti 24 orë në 7 ditë, duke qëndruar në kontakt të vazhdueshëm me të gjithë personat që kanë pasur ankesa, duke i zgjidhur ato në kohë reale. Por ky autoritet i shmanget dhënies së informacionit të kërkuar nga KSHH, duke vendosur në pikëpyetje faktin nëse e disponon apo jo këtë informacion dhe nëse ka praktika dokumentacioni që bëjnë të mundur identifikimin e numrit të ankesave, objektit të tyre, mënyrës së trajtimit të tyre dhe si i janë përgjigjur qytetarëve ankues, qendrat shëndetësore apo autoritetet e tyre eprore.

NjVKSH Durrës i është shmangur dhënies së informacionit lidhur me këtë çështje, ndërkohë që NjVKSH Pogradec deklaron se nuk ka asnjë ankesë të depozituar nga qytetarët gjatë gjithë periudhës së pandemisë. NjVKSH Elbasan referon se nuk ka ankesa të dokumentuara, por ka patur ankesa në rastet kur mjekët e familjeve kishin dhënë rekomandime të shumta për testime (duke krijuar stok). Këto ankesa janë marrë në rrugë telefonike, teksa qytetarët prisnin për tu testuar.

KREU 4: E DREJTA PËR ARSIM GJATË COVID-19

Një nga pasojat më të rënda të pandemisë COVID-19 ka qenë ndërprerja e arsimit në mbarë botën me mbylljen e shkollave e universiteteve për arsye të shëndetit publik. Në përgjigje të nevojës për të ndalur përhapjen e virusit, Shtetet fizikisht mbyllën shkollat, universitetet dhe institucionet e aftësimi dhe morën masa në përpjekje për të realizuar shkollimin në distancë. Në realitet aksesit në arsim nëpërmjet mjeteve dhe platformave teknologjike nuk ishte i aksesueshëm për të gjithë, veçanërisht për nxënësit me probleme social-ekonomike, ose me aftësi të kufizuara.⁹² Shtetet u munduan të adresonin këto probleme duke mundësuar ofrimin e programit mësimor jo vetëm në platformat digjitale, por dhe në televizionet publike, duke zvogëluar kështu mungesën e barazisë në aksesin në arsim mes nxënësve të niveleve të ndryshme ekonomike. Megjithatë, edhe kur teknologjia ishte në dispozicion, qasja në arsim u kufizua në mënyra të tjera. Për shembull, disa nxënës patën reduktime ose vonesa në ofrimin e mësimi dhe/ose detyrat e shtëpisë, dhe morën komente kthyes minimale lidhur me punën që kryen, ndërkohë që ndërveprimet direkte me mësuesit dhe shokët/shoqet e klasës qenë të limituara ose nuk ishin prezente.⁹³


E drejta e arsimit mbrohet sipas Nenit 2 të Protokollit Nr. 1, ku pjesa e parë e tij thotë: *“Askujt nuk i mohohet e drejta për arsimim.”* Kjo e drejtë gjithashtu parashikohet nga neni 57 i Kushtetutës, i cili thotë se: *“Kushdo ka të drejtën për arsimim.”* Megjithatë, e drejta për edukim ishte një ndër të drejtat nga të cilat Shteti Shqiptar dergoi bazuar në nenin 15 të KEDNJ, kështu që kufizime të konsiderueshme u bënë mbi të.

⁹² Gjevori, E; Xhepa, I : *“Manual i të drejtës për arsim”*, Tiranë 2020, e aksesueshme në: <https://www.kas.de/documents/271859/271908/Recht+auf+Ausbildung.pdf/144285bd-0a01-3e7f-d422-3dfa8e30a47e?version=1.0&t=1607352541309>

⁹³ Aire Centre: *“Covid-19 dhe Impakti mbi të Drejtat e Njeriut – Shikim i përgjithshëm mbi jurisprudencën përkatëse të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*, 2020 e aksesueshme në; <https://www.kmd.al/ep-content/uploads/2020/10/covid-guide-alb.pdf>

4.1. Të dhëna të anketimit

Figura 35. Përfaqësimi sipas universiteteve



Në lidhje me shpërndarjen e kampionimit të realizuar të studentëve sipas nivelit të studimit (bachelor apo master) shpërndarja është si në tabelën më poshtë. Vihet re se student të Universitetit të Mjekësisë në Tiranë kanë një përfaqësim të kategorisë "Tjetër" në masën 40%. Këtu mund të përfshihen student të doktoratës apo programe studimi dy vjeçare.

Universiteti	Bachelor	Master	Tjetër
Tjetër/Pa përgjigje	58.33%	25.00%	16.67%
Universitet Privat	74.29%	17.14%	8.57%
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës	95.00%	5.00%	0.00%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	78.26%	17.39%	4.35%
Universiteti Eqerem Çabej, Gjirokastrë	96.77%	3.23%	0.00%
Universiteti Fan S. Noli, Korçë	20.69%	72.41%	6.90%
Universiteti i Arteve	90.00%	6.67%	3.33%
Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani	74.29%	25.71%	0.00%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	33.33%	26.67%	40.00%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	33.33%	66.67%	0.00%
Universiteti i Tiranës	76.06%	19.72%	4.23%
Universiteti Ismail Qemali, Vlorë	80.00%	13.33%	6.67%
Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	88.46%	11.54%	0.00%
Universiteti Politeknik i Tiranës	83.33%	16.67%	0.00%





Figura 36. Përfaqësimi gjinor i të anketuarve



Në pyetësor u përfshinë 444 individë nga të cilët 68% i përkasin gjinisë femërore dhe 31% gjinisë mashkullore, 1% preferojnë të mos japin këtë informacion.

Figura 37. Përfaqësimi rajonal i të anketuarve sipas zonës




Përfaqësimi rajonal i të anketuarve qëndron në raportin 74% për zonën urbane dhe 26% për zonën rurale (Figura 37). Referuar shpërndarjes së kampionimit në çdo universitet sipas rajonit (urban apo rural) vihet re se për pjesën më të madhe të qarqeve përfaqësimi është në zonat urbane.

Veçanti bën universiteti Universiteti “Eqerem Çabej” qarku Gjirokastrë ku ky përfaqësim është mbi 50%. (Tabela 7).

Tabela 7 Shpërndarja e numrit të kampionimit në universitetet kryesore dhe rajonin në Shqipëri

Universiteti	Zonë rurale	Zonë urbane	Tjetër
Tjetër	33.33%	66.67%	0.00%
Universitet Privat	20.00%	80.00%	0.00%
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës	35.00%	65.00%	0.00%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	26.09%	73.91%	0.00%
Universiteti Eqerem Çabej, Gjirokastrë	58.06%	41.94%	0.00%
Universiteti Fan S. Noli, Korçë	37.93%	58.62%	3.45%
Universiteti i Arteve	16.67%	80.00%	3.33%
Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani	42.86%	57.14%	0.00%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	13.33%	86.67%	0.00%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	22.22%	77.78%	0.00%
Universiteti i Tiranës	16.90%	81.69%	1.41%
Universiteti Ismail Qemali, Vlorë	20.00%	80.00%	0.00%
Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	38.46%	61.54%	0.00%
Universiteti Politeknik i Tiranës	25.00%	75.00%	0.00%




Fakulteti

Në pyetësor u kushtua vëmendje përfaqësimit të të gjithë programeve të studimit dhe drejtimeve të studimit (Figura 38.a). Përfaqësinë më të lartë


e kanë fakultetet e drejtësisë të ndjekura nga shkencat natyrore dhe ato sociale, ekonomike. Përfaqësim të ulët vihet re të kenë fakultetet bujqësore, filologjike, gjuhëve të huaja dhe ato inxhinierike. (Figura 38)

Figura 38. Përfaqësimi i të anketuarve sipas natyrës së fakultetit ku ata studiojnë



Të pyetur mbi zhvillimin e mësimi në formë online gjatë gjithë vitit akademik 2020-2021, studentët në masën 84.9% kanë pranuar këtë formë mësimi, ndërsa 6.7% kanë pohuar jo dhe pjesa tjetër 8.4% kanë pranuar se janë përdorur forma të kombinuara (pjesërisht online për një periudhë dhe pjesërisht fizikisht) (Figura 39).


Figura 39. Përfaqësimi i të anketuarve mbi mësimi format e mësimdhënies gjatë gjithë vitit akademik 2020-2021



Referuar informacionit mbi zhvillimin e mësimi online dhe nivelit të studimit vihet re një përfaqësim pothuajse i njëjtë në nivelet bachelor dhe


master. Studentët që i përkasin nivelit bachelor kanë pranuar në masën 83.3% se mësimi gjatë periudhës së pandemisë për vitin akademik 2020-2021 është zhvilluar online, ndërsa për studentët e nivelit master ky përfaqësim është më i lartë, 88.5%. Studentët e vetë deklaruar “Tjetër” kanë pranuar në masën 90.9% se mësimi është zhvilluar online. (Figura 40).

Figura 40. Përfaqësimi i studentëve mbi mënyrat e zhvillimit të mësimit sipas nivelit të studimit



Të pyetur mbi periudhën e kohëzgjatjes së studimeve në formën online studentët i janë përgjigjur në masën 16.11% se këto studime kanë zgjatur deri në tre muaj, 27.07% pohojnë se studimet online kanë zgjatur deri në gjashtë muaj, 9.84% deri në 1 vit të plotë akademik, 2.68% pohojnë “një vit e gjysmë” dhe 44.3% pohojnë se kohëzgjatja ka qenë më shumë. (Figura 41 a)

Figura 41. Përfaqësimi i studentëve mbi kohëzgjatjen e mësimit online (a) dhe nivelit të studimit (b)




Studentët të cilët gjatë periudhës së studimit kanë qenë në nivelin e tyre bachelor pranojnë në masën 46.18% se kohëzgjatja e mësimit online ka qenë më shumë se një vit e gjysëm; në studentët e nivelit master 43.62% pranojnë se studimet kanë qenë me kohëzgjatje mbi një vit e gjysëm. Vihet re se disa programe studimi kanë vijuar procesin online deri në gjashtë muaj (23.24% e studentëve të nivelit bachelor e kanë pranuar këtë, 35.11% e studentëve të nivelit master dhe 45.45% e studentëve të kategorisë tjetër ku përfshihen shumica e studentëve të universitetit ët mjekësisë) (Figura 41 b).

Tabela 8: Kohëzgjatja e mësimeve online sipas nivelit të studimeve

Sa ka zgjatur mësimeve online?	Niveli i studimeve:		
	Bachelor	Master	Tjetër
Më shumë	46.18%	43.62%	22.73%
Një vit e gjysmë.	2.14%	5.32%	0.00%
Një vit i plotë akademik	10.40%	5.32%	18.18%
Deri në gjashtë muaj	23.24%	35.11%	45.45%
Deri në tre muaj	18.04%	10.64%	13.64%
Total	100.00%	100.00%	100.00%

Të pyetur mbi produktivitetin e mësimeve online (në një shkallë vlerësimi nga 1 "pak" deri në 5 "shumë produktive") studentët janë përgjigjur në masën 7.13% se mësimi ka qenë shumë produktiv dhe në një shkallë vlerësimi nga 3 në 5 (55.9%) pranojnë se procesi ka qenë produktiv. Ndërsa pjesa tjetër e vlerësojnë produktivitetin në një shkallë të ulët (1 ose 2). Pjesa që vlerëson mësimeve online gjatë muajve të pandemisë në nivele jo të mira (1,2) është përafërsisht 44.1%.

Figura 42. Përfaqësimi i studentëve mbi produktivitetin e mësimit online



Ajo që vihet re është fakti se në nivelet e studimit bachelor ose master pjesa më e madhe e studentëve vlerësojnë një nivel mesatar të produktivitetit online. Për nivelin master produktiviteti për 67.74% të studentëve të anketuar ka qenë mesatar dhe mbi nivelin mesatar (3,4,5) (Figura 43 (a) dhe (b)).

Figura 43: Niveli i produktivitetit të mësimdhënies sipas nivelit të studimit





Tabela 9: Produktiviteti sipas nivelit të studimit dhe zonës

Produktiviteti (1 deri 5)	Bachelor	Master	Zonë rurale	Zonë urbane
1	19.15%	13.98%	16.95%	18.96%
2	27.36%	18.28%	28.81%	24.16%
3	34.95%	40.86%	35.59%	36.70%
4	12.16%	17.20%	10.17%	13.76%
5	6.38%	9.68%	8.47%	6.42%
Gjithsej	100.00%	100.00%	100.00%	100.00%


Figura 44: Vlerësimi i produktivitetit sipas gjinisë dhe zonës



Nuk vihet re diferencë e dallueshme midis vlerësimit të produktiviteti sipas gjinisë (femër/mashkull) (Figura 44 (a)) ose sipas zonës së banimit (urbane/rurale) (Figura 44(b)).


Përsa i përket formës së mësimdhënies më efektive të pyetur sipas zonës së banimit dhe nivelit të studimit sërisht nuk vihet re një dallim midis këtyre kategorive.

Figura 45: Përfaqësimi i studentëve sa i përket formës së mësimdhënies më efektive sipas zonës së banimit dhe nivelit të studimit.



Të pyetur nëse kanë hasur vështirësi gjatë kohës së mësimdhënies online 52.88% e të pyeturve pranojnë të kenë patur vështirësi (i njëjti raport i përafërt qëndron për zonat urbane dhe rurale), 38.5% pranojnë të kenë patur vështirësi duke pohuar "disi" dhe pjesa tjetër 8.63% kanë pohuar se nuk kanë patur vështirësi. Ajo që vihet re është fakti se nuk ka dallim të dukshëm midis zonës urbane dhe rurale. (Figura 46)

Figura 46: Përfaqësimi i të anketuarve mbi pyetjen nëse kanë hasur vështirësi gjatë kohës së mësimdhënies online.



Pyetjes “A keni hasur vështirësi gjatë zhvillimit të mësimi online në periudhën e pandemisë?” I janë përgjigjur “Po” 52.88% (në gjininë femërore 54.13% dhe gjininë mashkullore 50.69%). Femrat kanë një ndryshim të vogël me meshkujt por që tregon një nivel vështirësie më të lartë në perceptimet e tyre krahasuar me meshkujt përse i përket vështirësisë në zhvillimin e mësimi online. (Tabela 10)

Tabela 10: Përfaqësimi i studentëve mbi pyetjen nëse kanë hasur vështirësi gjatë zhvillimit të mësimi online në periudhën e pandemisë sipas gjinisë.

	Femër	Mashkull	Total
Disi	38.94%	37.50%	38.50%
Jo	6.93%	11.81%	8.63%
Po	54.13%	50.69%	52.88%

Pyetjes “A kanë ndikuar këto vështirësi në procesin e studimit tuaj?” i janë përgjigjur pozitivisht 53.33% (56.07% tek gjinia femërore dhe 47.52% gjinia mashkullore). Sërisht vihet re një nivel më i lartë tek femrat mbi vështirësitë e hasura gjatë këtij procesi krahasuar me meshkujt. Vihet re gjithashtu se në zonat rurale kjo përqindje është më e lartë (54.62%) krahasuar me zonat urbane (52.91%), çka pohon se zonat rurale kanë patur ndjeshmëri më të lartë vështirësie në procesin e studimit. Këtu arsye të ndryshme mund të jenë: sigurimi i internetit, pajisjeve elektronike për ndjekjen e mësimi, komunikimi me profesorët etj. (Tabela 11)

Tabela 11: Përfaqësimi i studentëve mbi pyetjen nëse këto vështirësi kanë ndikuar në procesin e studimit të tyre sipas gjinisë dhe zonës.


	Zonë				
	Femër	Mashkull	Zonë rurale	urbane	Total
Disi	35.41%	39.01%	37.82%	36.39%	36.67%
Jo	8.52%	13.48%	7.56%	10.70%	10.00%
Po	56.07%	47.52%	54.62%	52.91%	53.33%
Gjithsej	100%	100%	100%	100%	100%

Vështirësitë në studim lidhur me procesin e mësimi online duket se kanë një shpërndarje të ndryshme në universitete të ndryshme. Vihet re se në Universitetin Bujqësor të Tiranës kjo pjesë përbën 78.26% të të anketuarve, më tej qëndron Universiteti i Arteve me 73.33%, Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës me 62.5%, Universiteti i Mjekësisë Tiranë me 60%, Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër (53.85%), Universiteti Ismail Qemali, Vlorë (53.33%). Universitetet private (31.43%), Universiteti i Sporteve (33.3%) kanë përfaqësimin më të ulët në raport me vështirësitë. Universiteti i Tiranës i cili ka përfaqësimin më të lartë të anketuarve në masën 49.3% ka pohuar se ka patur vështirësi në studim në lidhje me procesin e mësimi online. (Tabela 12)

Tabela 12: Përfaqësimi i studentëve lidhur me nivelin e vështirësisë së mësimi online sipas Universiteteve.

Universiteti ku studioni:	Disi	Jo	Po
Tjetër	41.67%	8.33%	41.67%
Universitet Privat	45.71%	17.14%	31.43%
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës	25.00%	7.50%	62.50%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	13.04%	8.70%	78.26%
Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastrë	51.61%	6.45%	35.48%
Universiteti Fan S. Noli, Korçë	41.38%	17.24%	34.48%
Universiteti i Arteve	20.00%	6.67%	73.33%
Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani	45.71%	5.71%	48.57%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	26.67%	3.33%	60.00%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	33.33%	22.22%	33.33%
Universiteti i Tiranës	35.21%	11.27%	49.30%
Universiteti Ismail Qemali, Vlorë	46.67%	0.00%	53.33%
Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	38.46%	3.85%	53.85%
Universiteti Politeknik i Tiranës	25.00%	16.67%	50.00%

Figura 47: Përfaqësimi i studentëve lidhur me nivelin e vështirësisë së mësimin online sipas Universiteteve.



Për personat të cilët kanë pranuar se kanë patur vështirësi gjatë mësimin online shkalla e vështirësisë sipas universiteteve jepet në Tabelën më poshtë dhe grafikun në vijim. Ajo që vihet re është fakti se për Universitetin Bujqësor të Tiranës serish shkalla e vështirësisë ka qene e lartë (nivelet 4 dhe 5, 82.61%), Universiteti i Arteve (4 dhe 5, 56.67%), Universiteti i Shkodrës (nivelet 4 dhe 5, 50%). (Figura 48 dhe Tabela 13).

Figura 48: Përfaqësimi i studentëve lidhur me nivelin e vështirësisë sipas Universitetit




Tabela 13: Përfaqësimi i studentëve lidhur me nivelin e vështirësisë sipas Universitetit

Universiteti ku studioni:	1	2	3	4	5
Tjetër	9.09%	9.09%	36.36%	36.36%	9.09%
Universitet Privat	20.69%	6.90%	37.93%	20.69%	13.79%
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës	5.13%	10.26%	46.15%	25.64%	12.82%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	0.00%	8.70%	8.70%	47.83%	34.78%
Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastrë	7.69%	26.92%	46.15%	11.54%	7.69%
Universiteti Fan S. Noli, Korçë	15.38%	11.54%	46.15%	7.69%	19.23%
Universiteti i Arteve	13.33%	3.33%	26.67%	10.00%	46.67%
Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani	14.29%	8.57%	51.43%	8.57%	17.14%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3.70%	18.52%	40.74%	11.11%	25.93%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	12.50%	37.50%	12.50%	25.00%	12.50%
Universiteti i Tiranës	9.09%	18.18%	37.12%	22.73%	12.88%
Universiteti Ismail Qemali, Vlorë	0.00%	30.77%	53.85%	7.69%	7.69%
Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	4.17%	8.33%	37.50%	29.17%	20.83%
Universiteti Politeknik i Tiranës	18.18%	18.18%	54.55%	0.00%	9.09%

Të pyetur mbi faktin nëse fakulteti ku ata studiojnë i ka kushtuar vëmendje zhvillimit të analizës mbi nevojat e studentëve gjatë pandemisë studentët janë përgjigjur sipas tabelës 14. Në Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës, 48.72% e studentëve të anketuar kanë referuar se kanë dijeni mbi kryerjen e një analize të nevojave të studentëve, i shoqëruar Universiteti Ismail Qemali Vlorë me 40%, Universiteti Eqrem Çabej, Gjirokastrë me 39.29% e vazhdim me universitet sipas shifrave në tabelën 14. Vihet re se për këtë çështje Universiteti Bujqësor i Tiranës është ai që ka neglizhuar me shumë (60.87% janë përgjigjur negativisht në lidhje me përpjekjet e universitetit), ndjekur nga Universiteti i Mjekësisë (48.15%), Universiteti i Arteve Tiranë (46.67%). Universiteti i Tiranës si më i përfaqësuar me studentë të anketuar përfaqësohet në masën 34.81% "jo", 51.85% nuk janë në dijeni dhe 13.33% pohojnë se janë marrë masa.

Tabela 14: A ka realizuar Fakulteti pranë të cilit ju studioni një analizë të nevojave të studentëve gjatë pandemisë?

Universiteti ku studioni:	Jo	Nuk kam dijeni	Po
Tjetër	27.27%	72.73%	0.00%
Universitet Privat	15.15%	60.61%	24.24%
Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës	23.08%	28.21%	48.72%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	60.87%	34.78%	4.35%
Universiteti Eqerem Çabej, Gjirokastrë	10.71%	50.00%	39.29%
Universiteti Fan S. Noli, Korçë	37.04%	25.93%	37.04%
Universiteti i Arteve	46.67%	46.67%	6.67%
Universiteti i Elbasanit Aleksandër Xhuvani	25.71%	48.57%	25.71%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	48.15%	37.04%	14.81%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	25.00%	50.00%	25.00%
Universiteti i Tiranës	34.81%	51.85%	13.33%
Universiteti Ismail Qemali, Vlorë	13.33%	46.67%	40.00%
Universiteti Luigj Gurakuqi, Shkodër	37.50%	29.17%	33.33%
Universiteti Politeknik i Tiranës	33.33%	66.67%	0.00%

Nëse analizohet përpjekja e fakulteti pranë të cilit studiojnë të një analize të nevojave të studentëve gjatë pandemisë vihet re se Fakultetet e Gjuhëve të huaja kanë një përfaqësim më të lartë të këtyre përpjekjeve pasi në masën 40% studentët e këtyre universiteteve e konfirmojnë këto përpjekje, më tej qëndron Universiteti Bujqësor me 33.33%. Në kontrast me to. Fakulteti i Ekonomisë me 31.71%. Fakultetet e Histori Filologjisë (73.68%), Inxhinierisë (68.75%), Drejtësisë (52.7%), Shkencave Sociale (49.02%), Shkencave Natyrore (47.69%) janë fakultetet më pak të informuara në lidhje me çështjen në fjalë. (Figura 49 dhe tabela 15)

Figura 49: Përfaqësimi i studentëve lidhur me pyetjen nëse është realizuar një analizë e nevojave të studentëve gjatë pandemisë




Tabela 15: Përfaqësimi i studentëve lidhur me pyetjen nëse është realizuar një analizë e nevojave të studentëve gjatë pandemisë

Në cilin fakultet studioni:	Jo	Nuk kam dijeni	Po
Fakultetet e Inxhinierive	25.00%	68.75%	6.25%
Fakultetet e Universitetit			
Bujqësor	41.67%	25.00%	33.33%
Fakulteti i Drejtësisë	33.78%	52.70%	13.51%
Fakulteti i Ekonomisë	26.83%	41.46%	31.71%
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	20.00%	40.00%	40.00%
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	21.05%	73.68%	5.26%
Fakulteti i Shkencave Sociale	23.53%	49.02%	27.45%
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	29.23%	47.69%	23.08%
Tjetër	42.61%	40.00%	17.39%

Të pyetur mbi a ka pasur ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi studentët në masën 42.9% kanë konfirmuar që po ka pasur ndryshime, ndërsa 28.4% kanë pohuar se nuk ka pasur ndryshime (Figura 50)


Figura 50 Përfaqësimi i të anketuarve mbi ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi



Studentët të cilët studiojnë në Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, pranojnë në masën 56% se ka pasur ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi, gjatë periudhës së mësimi online. Studentët të cilët studiojnë në Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër, pranojnë në masën 55.56% se ka pasur ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi.


Studentët të cilët studiojnë në Universiteti Bujqësor të Tiranës pranojnë në masën 47.83% se nuk ka pasur ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi. (Figura 51).

Figura 51. Përfaqësimi i të anketuarve mbi ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi, sipas universiteteve dhe fakulteteve



Studentët të cilët studiojnë në Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, pranojnë në masën 68.42% se ka pasur ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi, gjatë periudhës së mësimi online. Gjithashtu 52% e studentëve të cilët studiojnë në Fakultetin e Shkencave Sociale, e konfirmojnë këtë gjë. Studentët të cilët studiojnë në Fakultetet e Universitetit Bujqësor, 40.54% e tyre pranojnë se nuk ka pasur ndryshime në programet mësimore për t'iu përshtatur kushteve të zhvillimit të mësimi. (Figura 51).


Figura 52 Përfaqësimi i të anketuarve mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në kufizimin e praktikave apo ekspeditave mësimore



Pyetjes mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në kufizimin e praktikave apo ekspeditave mësimore në fakultetin ku ata studiojnë, 67.04% e studentëve


i janë përgjigjur pozitivisht, pra që ka pasur ndikim dhe 14.70% që nuk ka pasur ndikim.

Figura 53 Përfaqësimi i të anketuarve mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në kufizimin e praktikave apo ekspeditave mësimore sipas fakultetit dhe nivelit të studimit




Të anketuarit në lidhje mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në kufizimin e praktikave apo ekspeditave mësimore, në çdo fakultet, përqindja më e madhe e studentëve kanë pohuar që ka pasur ndikim. Përqindja më e lartë është në fakultetet e Inxhinierive, ku 81.25% e studentëve të pyetur, të cilët studiojnë në këtë fakultet kanë konfirmuar po. Ndikimin e pandemisë Covid-19 në kufizimin e praktikave apo ekspeditave mësimore, sipas nivelit të studimit, 71.74% e studenteve në nivelin Bachelor, kanë konfirmuar që ka pasur ndikim dhe 65.86 e studentëve në nivelin Bachelor kanë dhënë të njëjtin pohim. (Figura 53 b)

Figura 54 Përfaqësimi i të anketuarve mbi përgatitjen e stafit pedagogjik për t'ju përshtatur mësimdhënies në kushtet e pandemisë.



Të pyetur në lidhje mbi përgatitjen e stafit pedagogjik për t'ju përshtatur mësimdhënies në kushtet e pandemisë, 60.5% e studentëve kanë pohuar se stafi pedagogjik ka qenë disi i përgatitur, 29.6% kanë pohuar se stafi pedagogjik ka qenë shumë i përgatitur dhe 9.9% sa nuk ka qenë aspak i përgatitur.

Figura 55. Përfaqësimi i të anketuarve mbi përgatitjen e stafit pedagogjik për t'ju përshtatur mësimdhënies në kushtet e pandemisë, sipas zonave dhe universiteteve




Në studentët e pyetur të cilët banonin në zonat rurale, 64.71% e tyre kanë pohuar se stafi pedagogjik ka qenë disi i përgatitur dhe 28.57% që ka qenë shumë i përgatitur. Në studentët e pyetur të cilët banonin në zonat urbane, 59.13% e tyre kanë pohuar se stafi pedagogjik ka qenë disi i përgatitur dhe 30.03% që ka qenë shumë i përgatitur (Figura 55). Vihet re se studentët në universitetet private, kanë dhe përqindjen më të lartë të studentëve të cilët mendojnë se stafi pedagogjik ka qenë shumë i përgatitur, 68.75% te studentëve (tabela 16).

Tabela 16: Përfaqësimi i studentëve lidhur me përgatitjen e stafit pedagogjik për t'ju përshtatur mësimdhënies në kushtet e pandemisë sipas universiteteve.

Universiteti ku studioni:	Sa i përgatitur ka qenë stafi pedagogjik për t'ju përshtatur mësimdhënies në kushtet e pandemisë?			Totali
	Aspak i përgatitur	Disi i përgatitur	Shumë i përgatitur	
Tjetër	0.00%	70.00%	30.00%	100.00%
Universitet Privat	9.38%	21.88%	68.75%	100.00%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	8.70%	86.96%	4.35%	100.00%
Universiteti i Arteve	13.33%	73.33%	13.33%	100.00%
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	2.86%	80.00%	17.14%	100.00%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	21.43%	67.86%	10.71%	100.00%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	12.50%	50.00%	37.50%	100.00%
Universiteti i Tiranës	12.88%	59.09%	28.03%	100.00%
Universiteti Politeknik i Tiranës	8.33%	66.67%	25.00%	100.00%
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	5.00%	80.00%	15.00%	100.00%
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	8.00%	60.00%	32.00%	100.00%
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër	4.00%	36.00%	60.00%	100.00%
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	6.67%	33.33%	60.00%	100.00%
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	6.90%	51.72%	41.38%	100.00%
Total	9.68%	60.59%	29.73%	100.00%


Figura 56 Përfaqësimi i të anketuarve mbi përgatitjen e stafit pedagogjik për t'ju përshtatur mësimdhënies në kushtet e pandemisë, sipas nivelit të studimit



Në studentët e pyetur të cilët ishin në nivelin Bachelor, 61.04% e tyre kanë pohuar se stafi pedagogjik ka qenë disi i përgatitur, po ashtu 60% e


studentëve të nivelit të studimit Master dhe 57.14% e studentëve në nivele të tjera studimi. (Figura 56).

Figura 57 Përfaqësimi i të anketuarve mbi kufizimin jo të domosdoshëm apo shkelje të së drejtës për arsim, në kuadër të masave të marra lidhur me situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19.



Në lidhje me pyetjen mbi kufizimin jo të domosdoshëm apo shkelje të së drejtës për arsim, në kuadër të masave të marra lidhur me situatën e shkaktuar nga pandemia COVID-19, 28.6% e studentëve janë përgjigjur se ka pasur shkelje, 35.9% disi, dhe 21.5% që nuk ka pasur (Figura 57).


Figura 58. Përfaqësimi i të anketuarve mbi aksesin online në materiale mësimore nga biblioteka e Universitetit gjatë vitit akademik 2020-2021.



Në lidhje me pyetjen mbi aksesin online në materiale mësimore nga biblioteka e Universitetit gjatë vitit akademik 2020-2021, 45.62% e


studenteve kanë konfirmuar se nuk kanë patur akses online në materiale mësimore nga biblioteka e Universitetit ku studiojnë/kanë studiuar gjatë vitit akademik 2020-2021; 27.88% kanë pohuar se kanë patur dhe 26.5% nuk kanë qenë në dijeni (Figura 58).

Figura 59. Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021



Në lidhje me pyetjen mbi marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021, 48.62% e studentëve kanë pohuar se janë marrë masa dhe 23.5% kanë konfirmuar se nuk janë marrë masa (Figura 59).


Figura 60 Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021, sipas zonave.



Në lidhje me marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021, 47.41% e studentëve në zonat rurale kanë

konfirmuar po dhe 25% jo. Ndërsa 49.36% e studentëve në zonat urbane kanë konfirmuar po dhe 23.25% jo (Figura 60).

Figura 61 Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021, sipas universiteteve dhe fakulteteve.




Studentët e pyetur, nga Universitetet private, 77.42% e tyre kanë pohuar marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021. Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka përqindjen më të lartë të studentëve të cilët kanë pohuar se nuk janë marrë masa nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor, konkretisht 39.13% e studentëve nga ky universitet. Përqindjen më të lartë të studentëve të cilët janë përgjigjur se janë marrë masa nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021 i përkasin Fakulteti i Ekonomisë me 64.1%, ndjekur nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë me 61.11% (Figura 61), tabela 17)

Tabela 17: Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen e masave nga ana e Universitetit për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021, sipas universiteteve dhe fakulteteve.

A mendoni se janë marrë masa nga ana e Universitetit ku ju studioni për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021?			
Universiteti ku studioni:	Jo	Nuk e di	Po
Tjetër	11.11%	44.44%	44.44%
Universitet Privat	12.90%	9.68%	77.42%
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	23.08%	41.03%	35.90%
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	7.41%	22.22%	70.37%
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	24.00%	12.00%	64.00%
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	20.00%	13.33%	66.67%
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	24.00%	28.00%	48.00%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	39.13%	43.48%	17.39%
Universiteti i Arteve	23.33%	43.33%	33.33%
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	32.35%	29.41%	38.24%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	20.83%	33.33%	45.83%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	12.50%	62.50%	25.00%
Universiteti i Tiranës	26.92%	22.31%	50.77%
Universiteti Politeknik i Tiranës	16.67%	33.33%	50.00%
Total	23.38%	27.78%	48.84%
(a)			


A mendoni se janë marrë masa nga ana e Universitetit ku ju studioni për mundësimin e aksesit në platformat online në funksion të realizimit të procesit mësimor gjatë vitit akademik 2020-2021?			
Në cilin fakultet studioni:	Jo	Nuk e di	Po
Fakultetet e Inxhinierive	20.00%	33.33%	46.67%
Fakultetet e Universitetit Bujqësor	29.41%	14.71%	55.88%
Fakulteti i Drejtësisë	28.57%	21.43%	50.00%
Fakulteti i Ekonomisë	20.51%	15.38%	64.10%
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	26.32%	21.05%	52.63%
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	27.78%	11.11%	61.11%
Fakulteti i Shkencave Sociale	19.23%	25.00%	55.77%
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	18.75%	34.38%	46.88%
Tjetër	23.64%	40.91%	35.45%
Total	23.52%	27.79%	48.69%

Figura 62. Përfaqësimi i të anketuarve mbi garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online




Në lidhje me pyetjen mbi garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online, 52% e studentëve kanë pohuar se ju është garantuar aksesit dhe 9.7% se nuk ju është garantuar dhe 22.3% se ju është garantuar disi (Figura 62).

Figura 63. Përfaqësimi i të anketuarve mbi garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online të përdorura sipas zonave.




Në lidhje me garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online të përdorura, 47.86% e studentëve në zonat rurale kanë konfirmuar po dhe 6.84% jo. Ndërsa 53.82% e studentëve në zonat urbane kanë konfirmuar po dhe 10.83% jo (Figura 63).

Figura 64 Përfaqësimi i të anketuarve mbi garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online të përdorura sipas universiteteve dhe fakulteteve.




Studentët e pyetur, nga Universitetet private, kanë përqindjen më të lartë të studentëve, konkretisht 71.88%, të cilët kanë pohuar garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online të përdorura. Përqindjen më të lartë të studentëve të cilët kanë pohuar garantimin e aksesit në materialet mësimore gjatë vitit akademik 2020-2021 nëpërmjet platformave online të përdorura i përkasin Fakulteti i Gjuhëve të Huaja me 75%, ndjekur nga Fakulteti i Inxhinierive me 73.33% (Figura 64).

Figura 65. Përfaqësimi i të anketuarve mbi lehtësirat ekonomike për studentët




Në lidhje mbi lehtësirat ekonomike për studentët (të tilla si mundësimi i shtrirjes së linjave të internetit në zona rurale, ulja e tarifave mësimore, etj.) gjatë vitit akademik 2020-2021, 60.9% e studentëve kanë pohuar se nuk ka pasur lehtësira dhe 12% tyre kanë pohuar se kanë pasur lehtësira ekonomike (Figura 65).

Figura 66 Përfaqësimi i të anketuarve mbi lehtësirat ekonomike për studentët sipas zonave.




Në lidhje mbi lehtësirat ekonomike për studentët (të tilla si mundësimi i shtrirjes së linjave të internetit në zona rurale, ulja e tarifave mësimore, etj.) gjatë vitit akademik 2020-2021, 64.29% e studentëve të cilët banojnë në zonat rurale dhe 59.81% e atyre që banojnë në zonat urbane kanë pohuar se nuk ka pasur lehtësira ekonomike (Figura 66).

Figura 67 Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor




Të pyetur në lidhje me marrjen pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin e tyre për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 -2021, 70.5% e studentëve janë përgjigjur që nuk kanë marrë pjesë dhe 19.4% që kanë marrë.

Figura 68. Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor, sipas gjinisë dhe zonës



Vetëm 17.59% e studenteve femra dhe 22.86% e studentëve meshkuj kanë marrë pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin e tyre për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 -2021. Gjithashtu dhe 16.52% e studentëve në zonat rurale dhe 20.32% e studentëve në zonat urbane (Figura 68).

Figura 69. Përfaqësimi i të anketuarve mbi marrjen pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor, sipas universiteteve dhe fakulteteve



(a)

(b)


Universiteti "Fan S. Noli", Korçë, ka përqindjen më të lartë të studentëve, 50% e tyre, të cilët kanë marrë pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin e tyre për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 -2021. Përqindjen më të ulët e ka Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë, ku asnjë student nuk ka marrë pjesë në protesta apo tubime. Ndërsa përqindjen më të lartë të studentëve sipas fakulteteve, e kanë Fakultetet e Universitetit Bujqësor, me 45.45% të studentëve të këtyre fakulteteve kanë marrë pjesë në protesta dhe tubime. Pjesëmarrjen më të ulët e kanë studentët e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, me vetëm 5% (Figura 69) (tabela 18)

Tabela 18: Përfaqësimi i studentëve sipas universiteteve dhe fakulteteve mbi pjesëmarrjen në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin tuaj për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 -2021.

Universiteti ku studioni:	A keni marrë pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin tuaj për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 - 2021?		
	Jo	Nuk e di	Po
Tjetër	77.78%	11.11%	11.11%
Universitet Privat	75.00%	7.14%	17.86%
Universiteti Bujqësor i Tiranës	78.26%	0.00%	21.74%
Universiteti i Arteve	60.00%	6.67%	33.33%
Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"	82.86%	8.57%	8.57%
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	80.00%	4.00%	16.00%
Universiteti i Sporteve, Tiranë	62.50%	12.50%	25.00%
Universiteti i Tiranës	76.52%	6.82%	16.67%
Universiteti Politeknik i Tiranës	66.67%	8.33%	25.00%
Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës	45.95%	27.03%	27.03%
Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër	56.00%	20.00%	24.00%
Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	86.21%	13.79%	0.00%
Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë	80.00%	13.33%	6.67%
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë	37.50%	12.50%	50.00%
Total	70.37%	10.19%	19.44%


A keni marrë pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor për të ngritur zërin tuaj për të drejtat e studentëve në situatën e pandemisë, gjatë vitit akademik 2020 - 2021?			
Në cilin fakultet studioni:	Jo	Nuk e di	Po
Fakultetet e Inxhinierive	73.33%	6.67%	20.00%
Fakultetet e Universitetit Bujqësor	45.45%	9.09%	45.45%
Fakulteti i Drejtësisë	76.81%	8.70%	14.49%
Fakulteti i Ekonomisë	66.67%	20.51%	12.82%
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja	90.00%	5.00%	5.00%
Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë	78.95%	0.00%	21.05%
Fakulteti i Shkencave Sociale	71.70%	3.77%	24.53%
Fakulteti i Shkencave të Natyrës	80.95%	11.11%	7.94%
Tjetër	64.55%	13.64%	21.82%
Total	70.78%	10.21%	19.00%

Figura 70. Përfaqësimi i të anketuarve mbi kufizimet për të realizuar apo marrë pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor




Të pyetur në lidhje me a kanë patur kufizimet për të realizuar apo marrë pjesë në protesta, tubime apo forma të tjera të organizimit kolektiv studentor, 58.49% e studentëve janë përgjigjur që nuk kanë patur kufizime dhe 19.51% që po kanë patur kufizime (Figura 70).

Figura 71. Përfaqësimi i të anketuarve mbi angazhimin e Qeverive Studentore për çështjet apo problemet me të cilat studentët janë ndeshur gjatë pandemisë




Në lidhje me angazhimin e Qeverive Studentore për çështjet apo problemet me të cilat studentët janë ndeshur gjatë pandemisë, vetëm 11.09% e studentëve kanë pohuar se Qeverive Studentore kanë qenë shumë aktive, 26.7% kanë pohuar se ato kanë qenë disi aktive dhe 40.05% e tyre janë përgjigjur se ato kanë qenë pasive (Figura 71).

Figura 72. Përfaqësimi i të anketuarve mbi angazhimin e Qeverive Studentore për çështjet apo problemet me të cilat studentët janë ndeshur gjatë pandemisë sipas gjinisë dhe zonave.



Ndër studentet femra, 39.5% e tyre dhe ndër studentët meshkuj 41.55% e tyre kanë pohuar se angazhimi i Qeverive Studentore për çështjet apo problemet me të cilat studentët janë ndeshur gjatë pandemisë ka qenë pasiv. Ndërsa vetëm, 10.14%% e studenteve femra dhe 12.68% e studentëve meshkuj kanë pohuar se me angazhimi ka qenë shumë aktiv. (Figura 72).

Figura 73. Përfaqësimi i të anketuarve mbi angazhimin e Qeverive Studentore për çështjet apo problemet me të cilat studentët janë ndeshur gjatë pandemisë sipas universiteteve dhe fakulteteve.



Universiteti Bujqësor i Tiranës, ka përqindjen më të lartë të studentëve, 73.91% e tyre, të cilët kanë pohuar se angazhimi i Qeverive Studentore për çështjet apo problemet me të cilat studentët janë ndeshur gjatë pandemisë ka qenë pasiv. Ndër studentët e Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, 57.89% e tyre e kanë cilësuar aktivizimin e Qeverive Studentore disi aktiv, dhe 20 % e studentëve në Fakultetet e Inxhinierive dhe Fakultetet e Universitetit Bujqësor, e kanë cilësuar shumë aktiv. (Figura 73).